

Vendimi nr.123, Date 24.10.2008**TABELA E PERMBAJTJES****I. HYRJE/ DISPOZITA TE PERGJITESHME**

- I.1 Pergjegjesite e OST
- I.2 Struktura e Kodit te Rrjetit

II. KODI I RRJETIT/ DISPOZITA TE PERGJITESHME

- II.1 Objektivi
- II.2 Implementimi dhe funksionimi i Kodit te Rrjetit
- II.3 Komisioni i Rishikimit te Kodit te Rrjetit
- II.4 Administrimi i Kodit te Rrjetit
- II.5 Pergjegjesite e Kodit te Rrjetit
- II.6 Konfidencialiteti
- II.7 Mosmarrveshjet
- II.8 Ngjarjet e Paparashikuara
- II.9 Komunikimi ndermjet OST dhe Perdoruesve
- II.10 Pavlefshmeria e Pjeseshme
- II.11 Zbatimi i Akteve te Qeverise
- II.12 Atributet dhe Kompetencat e OST
- II.13 Organizimi dhe Asetet e OST
- II.14 Kontrolli i Sistemit
- II.15 Periudhat e Emergjences
- II.16 Komunikimet

III. KODI I RRJETIT / KODI I PLANIFIKIMIT

- III.1 Hyrje
- III.2 Objektivat e Kodit te Planifikimit
- III.3 Qellimi i Kodit te Planifikimit
- III.4 Kriteret e Planifikimit
- III.5 Zhvillimi dhe Planifikimi i Sistemit Elektroenergjitik
- III.6 Bazat e Planifikimit
- III.7 Procedurat e Planifikimit
- III.8 Te Dhena te Planifikimit te Siguruara nga OST
- III.9 Te Dhenat e Sistemit te Transmetimit te OST
- III.10 Kostoja e te Dhenave
- III.11 E Drejta e OST per Mbajtjen e Informacionit
- III.12 Konfidencialiteti i te Dhenave
- III.13 Te Dhena te Planifikimit te Kerkuara nga Perdoruesit
- III.14 Kategorite e te Dhenave te Planifikimit
- III.15 Planifikimi per Permiresimin dhe Modifikimin e paisjeve Egzistuese te Sistemit Elektroenergjitik

Shtojca A – Te Dhena te Planifikimit ; Pjesa 1 – Te Dhena Standarte te Planifikimit

- A.1 Gjeneruesit
- A.2 Transmetim
- A.3 Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar

Shtojca A – Te Dhena te Planifikimit Pjesa 2 – Te Dhena te Detajuara te Planifikimit

- A.4 Impiantet e Gjenerimit
- A.5 Te Dhena te Detajuara te Sistemit te Transmetimit
- A.6 Te Dhena te Detajuara te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar
- A.7 Te Dhena per tu Paraqitur me Kerkese te OST

Shtojca A – Te Dhena te Planifikimit Pjesa 3 – Te Dhena te Tjera te Planifikimit

- A.8 Planifikimi Vjetor i Sistemit
- A.9 Te Dhena te Planifikimit 5 Vjecar te Sistemit
- A.10 Te Dhena per Punet ne Vijim
- A.11 Te Dhena Perfundimtare

Shtojca B – Kriteret e Planifikimit

- B.1 Kriteret e Planifikimit te Gjenerimit
- B.2 Kriteret e Planifikimit te Sistemit te Transmetimit
- B.3 Referencat dhe Standartet
- B.4 Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe sistemet/objektet e Konsumatoreve te Kualifikuar

Shtojca C – Te Dhena per Mbrojtjen

IV. KODI I RRJETIT / KODI I OPERIMIT DHE DICPECERIMIT

- IV.1 Hytje
- IV.2 Shkembimi i te Dhenave
- IV.3 Procedurat
- IV.4 Skedulimi dhe Koordinimi i Nderprerjeve per Mirembajtje
- IV.5 Skedulimi
- IV.6 Sherbimet ndihmese te SEE
- IV.7 Siguria Gjate Operimit
- IV.8 Plani i Mbrojtjes dhe Rivendosjes
- IV.9 Bashkepunimi me Organizatat Rajonale dhe Europiane te Energjise
- IV.10 Komisioni i Planit te Mbrojtjes dhe Rivendosjes (KPMR)
- IV.11 Pergjegjesite e Paleve per Akses Reciprok ne Pronat dhe Godinat e Respektive
- IV.12 Kontrolli, Supervizimi, Testimi
- IV.13 Koordinimi i Veprimeve Operative
- IV.14 Raportimi i Ngjarjeve

Shtojca D – Raportimi i Ngjarjeve me Incident

Shtojca E – Investigimi i Ngjarjeve me Incident

Shtojca F – Ngarkesat Prioritare ne Procesin e Rivendosjes

V. KODI I RRJETIT / KODI I LIDHJES

- V.1 Hyrje
- V.2 Procedurat e Aplikimit per Lidhje
- V.3 Kushtet e Lidhjes
- V.4 Marreveshja e Lidhjes
- V.5 Specifikimet e Lidhjes
- V.6 Pika e Lidhjes
- V.7 Karakteristikat e Rrjetit
- V.8 Implementimi

VI. KODI I RRJETIT / KODI I OPERIMIT TE TREGUT

- VI.1 Hyrje
- VI.2 Planifikimi i Burimeve
- VI.3 Tregu i Energjise Elektrike
- VI.4 Programimi
- VI.5 Sherbimi i Balancimit

Dokumentacioni Bashkengjitur

Pjesa A Termat dhe Percaktimet e Kodit te Rrjetit Shqiptar

I. HYRJE / DISPOZITA TE PERGJITHESHME

- 1.1 Sistemi Elektroenergjetik ka keto funksione kryesore: Gjenerimin, Transmetimin, Shperndarjen dhe Furnizimin e Energjise Elektrike ne territorin e Republikes se Shqiperise. Energjia Elektrike eshte nje element thelbesor per veprimtarite qe zhvillohen ne vendin tone, te tilla si industria, tregjetia, transporti, agrikultura etj.
- 1.2 Kodi i Rrjetit mbulon procedurat operuese dhe principet qeverisese te nderveprimeve ndemjet OST dhe pjesmarresve te tregut te energjise elektrike ne Shqiperi. Ne teresi ai mbulon procesin e planifikimit, te lidhjes, interkoneksioneve, operimit te tregut dhe balancimit te sistemit si ne kushte normale ashtu dhe ne kushte te vecanta. Keto procese mbulojne afate kohore te ndryshme nga planifimimi afat gjate (vite) deri ne ate ne kohe reale (sekonda/minuta) si dhe periudhat pas ndodhjes se nje ngjarje (avarie). Kodi i Rrjetit eshte i detyrueshem per te gjithë pjesmarresit e tregut.

I.1 Pergjegjesite e OST

- 1.1.1 OST vepron si operator i rrjetit te transmetimit, operator i dispecerimit te sistemit dhe operator tregu ashtu si pershkruhet ne Rregullat e Tregut
- 1.1.2 Operatori i Rrjetit te Transmetimit te OST kryen transmetimin e energjise elektrike ne Shqiperi nga njesite gjeneruese dhe interkonjeksionet, tek Perdoruesit e Rrjetit te Transmetimit.
- 1.1.3 Asetet e menaxhuar nga OST jane:
- i. Gjithe linjat 400, 220 dhe 110 kV (deri ne portalet hyrese te çdo N/stacioni 110/TM dhe N/stacionet 110 kV te Centraleve te lidhur direkt me Sistemin e Transmetimit.)
 - ii. N/stacionet 400/220/110 kV, 400/220 kV, 400/110 kV, 220/110/TM kV N/stacionet 220/TM kV.
 - iii. N/stacionet 220 kV te hidrocentraleve V.Dejes, Koman dhe Fierze, (nga portalet hyrese te lidhjes se transformatoreve te blloqeve), si dhe trakti 110 kV/150 kV perfshire daljet dhe transformatorin brenda Hidrocentralit Bistrice 1.
- 1.1.4 Operatori i Rrjetit te Transmetimit te OST eshte pergjegjes per zhvillimin dhe zgjerimin e Sistemit te Transmetimit, si dhe per menaxhimin e çdo tranzitimi te Energjise Elektrike, ndermjet sistemeve te huaja, që shfrytezojne rrjetin Shqiptar te Energjise Elektrike.

I.1.1 *Operatori i Rrjetit te Transmetimit te OST siguron*

- i. Operimin e integruar dhe funksionimin e qendrueshem te Sistemit Elektroenergjetik

- ii. Mirembajtjen e mjediseve dhe te pajisjeve te Sistemit te Transmetimit, ne perputhje me kerkesat e sigurise teknike dhe te funksionimit
- iii. Zhvillimin e Sistemit te Transmetimit, ne perputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit te sektorit te Energjise Elektrike
- iv. Mirembajtjen dhe zhvillimin e asetave ndihmese te Transmetimit
- v. Mirembajtjen e infrastrukturave se telekomunikacionit
- vi. Furnizimin me Energji Elektrike te Perdoruesve te lidhur drejtperdrejte me Sistemin e Transmetimit
- vii. Aksesin e Pjesmaresve te Tregut

I.1.2 *Operatori i Dispecerimit te OST kryen funksionet e meposhteme*

- i. Ruan qendrushmerine dhe cilesine e furnizimit
- ii. Ndhmon tregun e energjise elektrike
- iii. Siguron informacion ditor per Operatorin e tregut te OST dhe pjesemarresit
- iv. Menaxhon rrjetin e transmetimit dhe interkoneksionet
- v. Kordinimin e impiortit dhe eksportit ne perputhje me mareveshjet ne fuqi (egzistuese)
- vi. Parashikon sherbimet ndihmese dhe energjine per te mbuluar humbjet e transmetimit
- vii. Balancon kerkesen dhe furnizimin
- viii. Planifikon nderprerjet per rrjetin e transmetimit, per pjesemarresit e lidhur direkt me rrjetin e transmetimit dhe per gjeneratoret e fiksuar(lidhur) ne te.
- ix. Instalimin, mirembajtjen dhe operimin e paisjeve matese

I.1.3 *Operatori i Tregut te OST kryen funksionet e meposhteme*

- i. Organizimin dhe administrimin e pagesave ndermjet pjesemarresve te tregut per tregun e balancimit
- ii. Mban nje proces per te gjitha palet qe te zbatojne Rregullat e Tregut dhe kodet teknike shoqeruese
- iii. Mban llogarite ne intetres te paleve tregetuese per energjine ballancuese dhe sherbimet e realizuara nga OST
- iv. Menaxhon procesin e Deklarimeve
- v. Prokuron energji per sherbimet ndihmese dhe humbjet ne transmetim
- vi. Mban detyrimet financiare per sherbimet ndihmese dhe humbjet ne transmetim
- vii. Dergon pagesat per energjine ballancuese te blere nga OST
- viii. Mbledh te dhenat e marra nga matjet

- ix. Menaxhon procesin e modifikimit te Rregullave te Tregut.
- x. Siguron informacion per tregun ne perputhje me kapitullin XVI te Rregullave te Tregut

I.2 Struktura e Kodit te Rrjetit

1.2.1 Me qellim qe te perbushe te gjitha detyrimet ligjore te percaktuara Kodi i Rrjetit te OST eshte ndertuar ne pese Pjese:

Hyrje / Dispozita te Pergjitheshme

- i. **Dispozita te Kodit te Rrjetit** specifikon çeshtje te pergjithshme teknike dhe procedurjale.
- ii. **Kodi i Rrjetit – Kodi i Planifikimit** specifikon kriteret dhe procedurat qe do te zbatohen nga OST per planifikimin dhe zhvillimin e Sistemit te Transmetimit.
- iii. **Kodi i Rrjetit - Kodi i Operimit dhe Dispeçerise**, specifikon operimin per programimin dhe informimin e te gjithe pjesemarresve si dhe procedurat qe lidhen me koordinimin per daljen nga puna te programuar per mirembajtjen e njesive te veçanta te Centraleve gjenerues, elementeve te Sistemit te Transmetimit, elementeve te Shperndarjes, si dhe te elementeve te Konsumatoreve te Kualifikuar.
- iv. **Kodi i Rrjetit - Kodi i Lidhjes**, specifikon kushtet, kriteret dhe afatet kohore per pjesemarresit ne treg per tu lidhur me Sistemin e Transmetimit, ose per te modifikuar lidhjet e tyre.
- v. **Kodi i Rrjetit - Kodi i Operimit te Tregut** – specifikon periudhen nga nje vit me pare deri ne kohen reale te balancimit. Balancimi mbulon procedurat qe shoqerojne balancimin e furnizimit (gjenerim dhe import) dhe te kerkeses ne kohe reale.

II. KODI I RRJETIT / DISPOZITA TE PERGJITHSHME

II.1.1 Kodi i Rrjetit eshte nje dokument qe percakton kufijte ndermjet OST dhe Pjesmarresve te tregut dhe vendos procedurat per operimin dhe zhvillimin e Sistemit te Transmetimit ne perputhje me zhvillimin e Tregut Shqiptar dhe Rajonal te Energjise Elektrike. Ai permbledh informacionin e kerkuar dhe procedurat qeverisese te marredhenieve ndermjet OST dhe pjesmarresve te tregut.

II.1.2 Kodi i Rrjetit aplikohet per pjesmaresit e meposhtem:

- i. OST (Operator i Rrjetit te Transmetimit, Operator i Dispecerimit te Sistemit dhe Operator Tregu)
- ii. Per pjesmarresit e tregut (DSO Operatori i Sistemit te Shperndarjes, RPS Furnizuesi Publik me Pakice, WPS Furnizuesi Publik me Shumice, KESH – Gen, SPPs, IPPs, QS - Furnizuesit e Kualifikuar, dhe Tregetaret)
- iii. Zbatimi i ketij Kodi eshte ne monitorim te vazhdueshem nga Rregullatori- ERE

II.1 Objektivi

II.1.1 Objektivi i pergjitheshem i ketij Kodi eshte qe te siguroje qe seksione te ndryshme te ketij Kodi te funksionojne se bashku , me kodet e matjes dhe te shperndarjes dhe me rregullat e tregut, ne interes te operimit te tregut te energjise elektrike ne Shqiperi , per te gjithë pjesmarrsit e tregut dhe konsumatorët.

II.1.2 Kodi i Rrjetit eshte pergatitur me qellim qe te:

- i. lejoje zhvillimin, mirembajtjen dhe operimin eficient, te koordinuar dhe ekonomik te Sistemit te Transmetimit te vendit tone ne perputhje me Tregun Shqiptar dhe ate Rajonal te Energjise Elektrike.
- ii. lejoje OST te plotesoje detyrimin e tij ne lidhje me transmetimin nder-shteteror te energjise elektrike.
- iii. eliminoje diskriminimin per pjesmarresit e tregut, gjate procesit te pergatitjes dhe zbatimit te programit per mirembajtje te Sistemit te Transmetimit.

II.2 Implementimi dhe Funksionimi i Kodit te Rrjetit

II.2.1 OST eshte pergejese per implementimin e Kodit te Rrjetit

II.2.2 Te gjithë Perdoruesve u kerkohet te implementojne Kodin e Rrjetit

II.2.3 Te gjithë Perdoruesit i sigurojne OST te drejten per hyrjen ne objektet e tyre per sherbime dhe lehtesira te nevojshme ne zbatim te pergjegjesive te OST

- II.2.4 Te gjithë Perdoruesit zbatojnë urdherat dhe udhëzimet leshuar nga OST te cilat kërkojnë zbatimin e Kodit të Rrjetit
- II.2.5 Nese ndonjë Perdorues deshton në zbatimin e ndonjë klauzole të Kodit të Rrjetit, Perdoruesi informon OST pa vonese për arsyt e mospajtimit në të. Deshtimet e perseritura në zbatimin e Kodit të Rrjetit Transmetimit mund të çojnë në shkeputjen e lidhjes së Perdoruesit nga Sistemi i Transmetimit.
- II.2.6 Një Perdoruesi i cili në mënyrë të perseritur thyen Kodin e Rrjetit mban përgjegjësi dhe merr pasojat e shkeputjes së lidhjes, që përfshin pagesën e detyrimeve dhe kompensimin e pasojave të konsumatoreve fundor.
- II.2.7 Kodi i Rrjetit përmban procedurë që lejojnë menaxhimin e drejtë të situatave teknike në Sistemin Elektroenergjetik, duke marrë në konsideratë një gamë të gjërë kushtesh operacionale, në rrethana normale dhe jo normale, në kushtet e tanishme, dhe të një sistemi në të ardhmen.
- II.2.8 Kodi i Rrjetit nuk mund të parashikojë dhe adresojë të gjitha mundësitë operacionale, prandaj OST në rrethana të paparashikuara në Kod, mund të veprojë vendosmerishtë në zbatim të detyrimeve të veta.
- II.2.8 OST i kërkohej që periodikisht të rishikojë zbatimin e Kodit të Rrjetit. Për këtë krijohet një Komision i Rishikimit të Kodit pranë OST ku përfaqësohen të gjithë Perdoruesit e Sistemit të Transmetimit. Asnjë rishikim ose modifikim i Kodit të Rrjetit nuk mund të bëhet pa u diskutuar në takimin e Komisionit të Rishikimit të Kodit dhe pa u miratuar nga ERE.

II.3 Komisioni i Rishikimit të Kodit të Rrjetit (Komisioni)

II.3.1 Komisioni

II.3.1.1 Komisioni do të drejtohet nga OST dhe do të përbehet nga anëtarët e mëposhtëm:

- i. Kryetari caktohet nga OST
- ii. Sekretari caktohet nga OST
- iii. Një anëtar për Centralet Gjenerues Hidrik
- iv. Një anëtar për Centralet Gjenerues Termik
- v. Një anëtar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
- vi. Një anëtar që përfaqëson Furnizuesin Publik me Shumicë
- vii. Një anëtar që përfaqëson Furnizuesin Publik me Pakicë
- viii. Një anëtar i cili përfaqëson të gjithë Impiantet e Pavarur Gjenerues
- ix. Një anëtar i cili përfaqëson të gjithë Klientet e Kualifikuar
- x. Një anëtar i cili përfaqëson të gjithë Tregetuesit e tjere
- xi. Një anëtar që përfaqëson të gjithë Furnizuesit e Kualifikuar

II.3.1.2 Brenda 30 ditëve nga miratimi i këtij Kodi OST autorizon Kryetarin dhe Sekretarin e KRKT, të informojnë zyrtarisht të gjithë anëtarët e Komisionit për takimin e parë të Komisionit, minimumi shtatë ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen e

Komisionit te rishikimit te Kodit te Transmetimit.

- II.3.1.3 Çdo pjesemarrës në KRKT informon Sekretarin e Komisionit për emrat dhe funksionin e përfaqësuesve të tyre në KRKT jo më pak se tre ditë përpara takimit të parë të KRKT.
- II.3.1.4 Brenda 30 ditëve nga mbledhja e parë KRKT harton Rregulloren e veprimtarisë së tij. KRKT mbledhet të paktën një herë në tre muaj, ose kur kërkohet nga një prej pjesëmarrësve të KRKT.
- II.3.1.5 Vendimet e Komisionit merren me konsensus. Në rast të mos arritjes së konsensusit vendimet merren me shumicë të thjeshtë të pjesëmarrësve në takim, por me kushtin që OST të ketë të drejtën e vetos në vendimmarrje, e arsyetuar nga fakti i rëndësishëm që ka në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të energjisë.
- II.3.1.6 Në mbledhjet e Komisionit kur diskutohet për çështje të Mbrojtjes Rele, duhet të jete i pranishëm një përfaqësues i Komitetit të Planit të Mbrojtjes dhe Rivendosjes (KPMR).

II.3.2 Detyrat e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Rrjetit

- II.3.2.1 Komisioni i Rishikimit të Kodit të Rrjetit duhet:
- i. Të mbaje në një mbikqyrje të vazhdueshme Kodin e Rrjetit dhe të marrë inisiativa për rishikimin e tij
 - ii. Të analizojë çdo avari të rende në rrjet dhe mbështetur në këto analize të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme Kodin e Rrjetit
 - iii. Të marrë në konsideratë gjithë kërkesat për ndryshime të Kodit të Rrjetit, që propozohen nga Përdoruesit
 - iv. Të informojë Palet mbi rekomandimet për ndryshime të Kodit të Rrjetit së bashku me arsyet për këto ndryshime dhe çdo kundërshtim nëse ka
 - v. Të leshojë udhëzime për interpretimin dhe zbatimin e Kodit të Rrjetit
 - vi. Të shqyrtojë problemet e ngritura nga Përdoruesit

II.3.3 Takimet e Veçanta

- II.3.3.1 OST mund të mbaje takime të veçanta me Përdorues të veçantë. Gjate takimeve diskutohen kërkesat individuale të Përdoruesit apo të një grupi Përdoruesish dhe përgatit propozime për mbledhjet e Komisionit.

II.3.4 Rishikimi i Kodit

- II.3.4.1 Sekretari duhet të paraqisë gjithë propozimet për rishikim të Kodit të Rrjetit në Komision për shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre.

II.4 Administrimi i Kodit të Rrjetit

- II.4.1 OST është Administrator i Kodit të Rrjetit.
- II.4.1.1 OST në rolin e Administratorit të Kodit të Rrjetit ka të drejtë:

- i. Te informoje Perdoruesit e Sistemit te Transmetimit te kene parasysh qe shfrytezimi i rrjetit po mbikqyret nepermjet zbatimit te rregullave te Kodit te Rrjetit.
 - ii. Te ndjeke kontrollin e informacionit qe qarkullon ne perputhje me te gjitha procedurat e Kodit te Rrjetit.
 - iii. OST pergatit nje raport te detajuar vjetor ne lidhje me administrimin dhe zbatimin e Kodit te Rrjetit, i cili dergohet dergohet ne ERE brenda 30 janarit per vitin paraardhes.
- II.4.1.2 OST ne perfundim te mbledhjeve te Komisionit te Rishikimit te Kodit, brenda 7 diteve dergon ne ERE raportin me permbajtjen e meposhtme:
- i. perfundimet e dala per rishikimet e Kodit te Rrjetit.
 - ii. propozimet per rishikimin e Kodit te Rrjetit.
 - iii. prezantimet e shkruara ose kundershkrimet e ngritura nga Perdoruesit gjate rishikimit.
 - iv. paraqet propozime ne ERE per te krijuar lehtesira kur Perdoruesit kane veshtiresi ne zbatimin e Kodit te Rrjetit.

II.5 Pergjegjesite e Kodit te Rrjetit

- II.5.1 OST ne zbatimin e detyrimeve te veta sipas Kodit te Rrjetit, mbeshtetet ne informacionin qe japin Perdoruesit lidhur me kerkesat dhe qellimet e tyre. OST sh.a. nuk mban pergjegjesi per pasojat qe rrjedhin nga arsyetimi dhe veprimet e bazuara nga informacionet e dhena nga Perdoruesit ne lidhje me kerkesat dhe qellimet e tyre.

II.6 Konfidencialiteti

- II.6.1 Bazuar ne termat e Kodit, OST do te marre informacion nga Perdoruesit lidhur me qellimet e tyre duke respektuar biznesin e tyre ne gjenerim, shperndarje ose furnizim. OST nuk publikon informacionet tek te tretet, pa miratim me shkrim te zoteruesit te informacionit, pervec rasteve kur kjo kerkohet nga Kodi i Rrjetit.

II.7 Mosmarveshjet

II.7.1 Procedurat per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve

- II.7.1.1 Ne rast te ndonje Mosmarreveshjeje ndermjet Perdoruesve dhe OST, ne lidhje me interpretimin e ndonje klauzole te Kodit te Rrjetit, çeshtja do te zgjidhet duke u bazuar ne procedurat e vendosura ne Kodin e Rrjetit. Ne rast te ndonje konflikti ndermjet ndonje dispozite te Kodit te Rrjetit dhe ndonje kontrate ose Mareveshje ndermjet OST dhe Perdoruesit, klauzola e Kodit te Rrjetit mbizoteron.

II.7.2 Vazhdimesia e Funkcionimit te Paleve

- II.7.2.1 Objektivi i kesaj procedure eshte qe asnje mosmarreveshje te mos pengoje punen e perditeshme te Paleve (OST dhe Perdoruesit)
- II.7.2.2 Menjehere pas lindjes se nje mosmarreveshjeje Palet duhet te diskutojne dhe te arrijne ne nje mareveshje. Nese mareveshja nuk mund te arrihet nga Palet çeshtja referohet ne Komision.

II.7.2.3 Afati per te arritur nje marreveshje apo per te zgjidhur mosmarreveshjen e krijuar, percaktohet nga Rregullorja e Komisionit te Rishikimit te Kodit te Rrjetit.

II.7.2.4 Nese vendimi i Komisionit nuk kenaq Palet ne mosmarreveshje, çeshtja referohet ne ERE.

II.7.3 Mosmarreveshjet ne Lidhje me Interpretimin e Kodit te Rrjetit

II.7.3.1 Mareveshja e Perkoheshme ndermjet Paleve qe kane interpretime te ndryshme duhet te ndiqet deri ne daljen e nje rregulli te ri nga Komisioni i Rishikimit te Kodit te Rrjetit. Nese nje ose te dy palet nuk jane te kenaqura me rekomandimin e Komisionit, çeshtja do te referohet ne ERE, vendimi i te cilit eshte i detyrueshem per zbatim nga Palet.

II.7.4 Mosmarreveshjet per Çeshtje te Pambuluara nga Kodi i Rrjetit

II.7.4.1 Çeshtja do te diskutohet nga Palet, te cilet do te arrijne ne nje Mareveshje. Nese Mareveshja nuk mund te arrihet, Palet formulojne nje mareveshje pune te perkoheshme dhe me pas referojne çeshtjen ne Komisionin e Rishikimit te Kodit te Rrjetit edhe nese çeshtja nuk mbulohet nga Kodi i Rrjetit. Rekomandimi i dhene nga Komisioni i Rishikimit te Kodit te Rrjetit pezullon mareveshjen e perkoheshme dhe zbatohet nga te gjitha palet.

II.7.4.2 Nese ndonje pale nuk eshte e kenaqur me rekomandimin e Komisionit te Rishikimit te Kodit, çeshtja do te referohet ne ERE. Vendimi i ERE eshte i detyrueshem per zbatim nga te gjitha palet.

II.8 Ngjarje te Paparashikuara

II.8.1 Ne situata qe nuk parashikohen ne asnje klauzole te Kodit te Rrjetit, OST therret nje takim te menjehershem me te gjitha Palet qe preken nga zgjidhja dhe veprimet qe do te ndermeren ne keto rrethana

II.8.2 Nese nuk arrihet asnje mareveshje, OST percakton perkohesisht veprimet qe ndermeren, pasi te jepen aresyet per çeshtjet e shprehura nga Palet e tjera. OST sa me shpejte te jete e mundur, referon çeshtjen ne Komisionin e Rishikimit te Kodit te Rrjetit, vendimi i te cilit do te jete mbi te gjitha percaktimet e perkohshem te marre nga OST.

II.8.3 Rekomandimet e paleve ose marrja ne konsiderate e percaktimeve te OST zbatohet deri ne daljen e nje vendimi tjeter te ndryshem nga Komisioni i Rishikimit te Kodit; dhe vendimi i Komisionit eshte ne fuqi deri ne daljen e nje vendimi nga ERE. Vendimi i ERE eshte i detyrueshem per zbatim nga Palet.

II.8.4 Nese ndonje Pale apelon ne ERE, mbi vendimin e marre nga Komisioni, ERE shqyrton dhe merr vendim.

II.9 Komunikimi ndermjet OST dhe Perdoruesve

II.9.1 Gjithe komunikimet ndermjet OST dhe Perdoruesve do te behen me shkrim pervec rasteve kur kerkohet komunikim me goje, dhe ne keto raste keto komunikime do te konfirmohen me shkrim sa me shpejte.

II.10 Pavleshmeria e Pjeseshme

II.10.1 Nese ndonje klauzole ose pjese klauzole e Kodit te Rrjetit behet dhe deklarohet e pavleshme per ndonje arsye, vlefshmeria e pjeses se mbetur te klauzoles ose pjeses se saj nuk preket.

II.11 Zbatimi i Akteve te Qeverise

II.11.1 Mbas çdo akti te Qeverise per çeshtje te ndryshme qe lidhen me SEE, OST njofton menjehere ERE-n dhe te gjithe Perdoruesit per kerkesat e ketyre akteve. Perdoruesit do ti nenshtrohen pjeseve perkatese te Kodit te Rrjetit dhe do te pershtaten me aktet perkatese.

II.12 Atributet dhe Kompetencat e OST

II.12.1 Sistemi i Transmetimit drejtohet nga nje Operator i Sistemit te Transmetimit, i cili ka licence per te kryer veprimtarine e transmetimit te energjise elektrike.

Operatori i Sistemit te Transmetimit eshte pergjegjes per zhvillimin dhe zgjerimin e Sistemit te Transmetimit, si dhe per menaxhimin e çdo tranzitimi te energjise elektrike, ndermjet sistemeve te huaja, qe shfrytezojne rrjetin shqiptar te Energjise Elektrike.

II.12.2 Operatori i Rrjetit te Transmetimit siguron:

- i. Operimin e integruar dhe funksionimin e qendrueshem te Sistemit Elektroenergjetik
- ii. Mirembajtjen e mjediseve dhe te pajisjeve te Sistemit te Transmetimit, ne perputhje me kerkesat e sigurise teknike dhe te funksionimit
- iii. Zhvillimin e Sistemit te Transmetimit, ne perputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit te sektorit te Energjise Elektrike
- iv. Mirembajtjen dhe zhvillimin e asetave ndihmese te Transmetimit
- v. Mirembajtjen e infrastruktures se telekomunikacionit
- vi. Aksesin e Pjesmaresve te Tregut

II.13 Organizimi dhe Asetet e OST

II.13.1 Ne baze te ligjit Nr.9072 date 22/05/2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", I ndryshuar Sistemi i Transmetimit te Energjise Elektrike administrohet nga Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST). Asetet ne administrim te OST sh.a:

- i. Gjithe linjat 400, 220 dhe 110 kV (deri ne portalet hyrese te çdo N/stacioni 110/TM dhe N/stacionet 110 kV te Centraleve te lidhur direkt me Sistemin e Transmetimit.)
- ii. N/stacionet 400/220/110 kV, 400/220 kV, 400/110 kV, 220/110/TM kV N/stacionet 220/TM kV.

- iii. N/stacionet 220 kV te hidrocentraleve V.Dejes, Koman dhe Fierze, (nga portalet hyrese te lidhjes se transformatoreve te blloqeve), si dhe trakti 110 kV/150 kV perfshire daljet dhe transformatorin brenda Hidrocentralit Bistrica 1.

II.14 Kontrolli i Sistemit

- II.14.1 Kur nje Perdorues ka marreveshje me OST , per qellim koordinimi, komunikimi dhe funksionimi te skemave te Sistemit te Transmetimit, OST mund ta trajtojte ate nyje te Perdoruesit si pjese te Sistemit te Transmetimit, por ndermjet OST dhe Perdoruesve do te vazhdoje te trajtohet si nyje Perdoruesi.

II.15 Periudhat e Emergjences

- II.15.1 Ne periudhat e emergjences si: thatesira e tejzgatur, prurja me plota te medha, nderprerje e furnizimit me lende djegese, luftes, katastrofave natyrore si dhe situatave anormale te percaktuara, Qeveria mund te leshoje direktiva te caktuara per kufizime, kontrole dhe rregulla te tjera, dhe nese keto bien ne kontradite me klauzolat e Kodit, ato klauzola, paragrafe ose pjese te Kodit te Rrjetit do te trajtohen si perkohesisht te pezulluara per aq kohe sa zgjat emergjenca.

II.16 Komunikimet

- II.16.1 Komunikimet egzistuese deri ne daten e marrjes se miratimit te Kodit, jane kerkesat minimale te komunikimit dhe ruhen nga Palet ne kushte te mira funksionimi.
- II.16.2 Per te siguruar menaxhimin dhe kontrollin e instalimeve nga OST, instalimet per komunikimin ndermjet Perdoruesve dhe OST duhet te zbatojne normat ne fuqi.
- II.16.3 Hollesite e lidhjes me sistemin e telekomunikacionit percaktohen ne marreveshje kur miratohet lidhja me Sistemin e Transmetimit. OST siguron, zhvillon dhe kryen punime per instalimin e Sistemit te Kontrollit dhe Perftimit te te Dhenave (SKADA). Keto sisteme i perkasin OST.
- II.16.4 Perdoruesit jane te detyruar te lejojne hyrjen ne pikat lidhese me Sistemin e Transmetimit per matjen e tensionit, rrymes, frekuences, fuqise aktive dhe reaktive, dhe japin informacion lidhur me paisjet e takim-stakimit, te cilat tregojne kushtet e instalimeve dhe te sinjaleve te alarmit me qellim kalimin e ketyre informacioneve ne SCADA. Instalimet e kontrollit dhe te marrjes se te dhenave, si sisteme nderfaqesuese ndermjet Perdoruesit dhe OST, percaktohen ne momentin kur jepet miratimi teknik per lidhjen.

III. KODI I RRJETIT / KODI I PLANIFIKIMIT

III.1 Hyrje

3.1.1 Kodi i Planifikimit specifikon kushtet, kriteret dhe afatet kohore per pjesemarresit ne treg per tu lidhur me Sistemin e Transmetimit, ose per te modifikuar lidhjet e tyre.

3.1.2 Perdoruesit e Sistemit te Transmetimit duhet te marrin ne konsiderate Kodin e Planifikimit kur planifikojne zhvillimin e sistemeve/objekteve te tyre.

III.1.1 Zgjerimi i Sistemit te Transmetimit

III.1.1.1 Kerkesa per fuqizimin ose zgjerimin e Sistemit te Transmetimit mund te linde per disa arsye, nje pjese e te cilave jepen me poshte:

- i. Zhvillimi i Sistemit/Objektit te Perdoruesit qe eshte i lidhur me Sistemin e Transmetimit si rezultat i zhvillimit te Perdoruesit;
- ii. Futja ne Sistemin e Transmetimit e nje Pikelidhje te Re te sistemit/objektit te Perdoruesit;
- iii. Nevoja per rritjen e kapacitetit te Sistemit te Transmetimit dhe ruajtjen e standarteve te sigurise, ne pershtatje me rritjen e parashikuar te kerkeses ne transmetim;

III.1.2 Tipet e Zgjerimit te Sistemit te Transmetimit

III.1.2.1 Fuqizimet ose zgjerimet e Sistemit te Transmetimit mund te perfshijne:

- i. Pikat e Lidhjes ndermjet Sistemit te Transmetimit dhe Sistemit/objektit te Perdoruesit;
- ii. Linjat e transmetimit ose paisjet, te cilat bashkojne Pikat e Lidhjes me pjesen e tjeter te Sistemit te Transmetimit;
- iii. Linjat e transmetimit ose paisjet, brenda vete Sistemit te Transmetimit;
- iv. Nenstacionet e Rrjetit te Transmetimit

III.1.3 Nevoja per nje Planifikim Paraprires te Sistemit te Transmetimit

III.1.3.1 Sistemi i Transmetimit duhet te planifikohet paraprakisht ne nje kohe te mjaftushme paraprirese, ne menyre qe te lejoje Perdoruesit e ketij Sistemi, te bejne planifikimet per zgjerimin e sistemeve/objekteve te tyre.
Prandaj Kodi i Planifikimit paraqet periudhat kohore per shkembimin e informacionit midis OST dhe Perdoruesve.

III.1.4 Objektivat e Kodit te Planifikimit

III.1.4.1 Standartet dhe Procedurat brenda ketij Kodi Planifikimi kane per qellim te bejne te mundur konsultimin e OST me Perdoruesit, per te patur nje SistemTransmetimi eficient, te kordinuar, te sigurt dhe ekonomik, me qellim qe te plotesoje kerkesat ne te ardhmen.

III.2 Objektivat e Kodit te Planifikimit

3.2.1 Objektivat e Kodit te Planifikimit jane:

- i. Te percaktoje Procedurat per shkembimin e informacionit ndermjet OST dhe Perdoruesve, duke respektuar çdo propozim te Perdoruesve per zhvillimin e Sistemeve/objekteve te tyre, qe mund te kete ndikim ne sjelljen e Sistemit te Transmetimit;
- ii. Te detajoje informacionin, te cilin OST do te beje te gatshem per Perdoruesit, me qellim qe te lehtesoje identifikimin dhe vleresimin e mundesive per perdorim ose Lidhjen ne Sistemin e Transmetimit;
- iii. Te detajoje informacionin qe OST kerkon nga Perdoruesit, me qellim qe OST te planifikojte zhvillimin e Sistemit te Transmetimit, per te ndihmuar zhvillimet e propozuara te Perdoruesve;
- iv. Te specifikojte Standartet dhe Procedurat per planifikimin dhe projektimin, te cilet do te zbatohen nga OST ne planifikimin dhe zhvillimin e Sistemit te Transmetimit

III.3 Qellimi i Kodit te Planifikimit

III.3.1 Zbatuesit e Kodit te Planifikimit

III.3.1.1 Kodi i Planifikimit duhet te zbatohet nga OST dhe Perdoruesit, qe jane:

- i. Gjeneratorët qe lidhen direkt ne Sistemin e Transmetimit.
- ii. Operatori i Sistemit te Shperndarjes.
- iii. Konsumatorët e Kualifikuar.
- iv. Furnizuesit
- v. Konsumatorët e lidhur ne Sistemin e Transmetimit

III.3.2 Zbatimi i Kodit te Planifikimit nga Perdoruesit e Perspektives

III.3.2.1 Subjektet, veprimtaria e te cileve ne perspektive, do ti vendose ata ne ndonje nga kategorite e Perdoruesve te mesiperm, do te merren ne konsiderate si reference ne rolin e tyre ne perspektive, ashtu sikur edhe Perdoruesit aktuale qe jane te lidhur.

III.4 Kriteret e Planifikimit

III.4.0.1 OST dhe Perdoruesit qe perdorin Sistemin e Transmetimit zbatojne kriteret e planifikimit ne teresi per planifikimin dhe zhvillimin e sistemeve/objekteve, siç detajohet ne **Shtojcen - B.**

III.5 Planifikimi dhe Zhvillimi i Sistemit Elektroenergjetik

III.5.1 Plani i Perspektives

- III.5.1.1 OST harton Planin e Perspektives, qe perben bazat per gjithë planifikimet e detajuara te metejshme ne Sektorin e Energjise Elektrike ne Shqiperi. Gjithe planifikimi i gjenerimit, shperndarjes dhe konsumatoreve te kualifikuar do te behen duke u bazuar ne Planin e Perspektives.
- III.5.1.2 Plani i Perspektives do te mbuloje nje periudhe 15 vjeçare. Ky plan perfshin parashikimet per nevojat per energji elektrike, pikun e fuqise, kapacitetet shtese per energji elektrike, kapacitetet transmetuese, humbjet dhe parametrat e tjere te rendesishem te SEE.
- III.5.1.3 Plani i Perspektives permban planin e veprimeve te Sistemit te Transmetimit dhe te Perdoruesve lidhur me importet, eksportet dhe kufizimet.
- III.5.1.4 OST do te vleresoje nevojat per energji elektrike bazuar ne te dhenat e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Perdoruesve te Kualifikuar. Megjithate OST kryen analiza te pjeseshme te percaktimit te nevojave dhe ngarkesave per kategorite e meposhteme te konsumatoreve fundore:
- i. Familjare
 - ii. Industriale
 - iii. Sherbime Publike
 - iv. Agrikulture
- III.5.1.5 Operatori i Sistemit te Shperndarjes do te analizojne ne menyre te detajuar ngarkesat per te gjithë kategorite e konsumatoreve te vet. Ne menyre te ngjashme te gjithë konsumatoret e kualifikuar te fuqise do te paraqesin nevojat e tyre per zgjerim dhe ngarkese ne OST.
- III.5.1.6 OST do te perpunoje te gjitha te dhenat dhe do te pergatise nje plan te hollesishem.
- III.5.1.7 OST ne planifikimin e vet do te vleresoje humbjet ne perqindje dhe ne vlere, per Sistemin e Transmetimit ne teresi dhe elemente te veçante te tij, me ndihmen e menyrave te meposhtme:
- i. Duke u bazuar ne vleresimin e humbjeve te fuqise ne pikun e ngarkeses ne Sistemin e Transmetimit, qe percaktohen nga studimet e Shperndarjes se Flukseve me ndihmen e programeve kompjuterike.
 - ii. Duke kryer studime pilot ne elemente te veçante, me anen e matjes se energjise elektrike ne te dy anet e elementit perkates.

III.6 Bazat e Planifikimit

III.6.1 Planifikimi i Gjenerimit

- III.6.1.1 Baze per planifikimin e Gjenerimit do te jete Plani i Perspektives i hartuar nga OST, i cili modifikohet here pas here per t'iu pershtatur rrethanave ne optimizimin e Sistemit Elektroenergjetik.

- III.6.1.2 Gjeneruesi i Pavarur duhet te hartoje e paraqese nje Plan 5 vjeçar per zhvillimin e sistemit/objektit te tij sikurse eshte specifikuar ne Kodin e Planifikimit.
- III.6.1.3 Çdo zhvillim i planifikuar nga nje Gjenerues i Pavarur duhet te rezultoje ne rritje te efciences dhe kapacitetit te tij dhe perfshin veprimet e meposhtme:
- i. Shtese te njesive te reja
 - ii. Heqje te njesive te vjetra
 - iii. Rinovim dhe modernizim i njesive egzistuese.

III.6.2 Planifikimi i Sistemit te Transmetimit

- III.6.2.1 Baze e planifikimit dhe zhvillimit te Sistemit te Transmetimit do te jete Plani i Perspektives i hartuar nga OST, i cili modifikohet here pas here per t'iu pershtatur rrethanave ne optimizimin e Sistemit Elektroenergjetik.
- III.6.2.2 OST harton Planin e Perspektives se Sistemit te Transmetimit bazuar ne:
- i. Studimet per Shperndarjen e Flukseve
 - ii. Studimet per Lidhjet e Shkurtera
 - iii. Studimet per Qendrushmerine Statike dhe Dinamike
 - iv. Studimet mbi Energjine e Mosfurnizuar
- Gjate kryerjes se studimeve te mesiperme, OST do te marre ne konsiderate edhe zhvillimet ne Sistemet/objektet e Perdoruesve.
- III.6.2.3 OST do te pergatise nje plan 5 vjeçar per zhvillimin e skemave te Sistemit te Transmetimit.

III.6.3 Planifikimi i Sistemit te Shperndarjes

- III.6.3.1 Baze per planifikimin e Shperndarjes do te jete Plani i Perspektives i hartuar nga OST, i cili modifikohet here pas here per t'iu pershtatur rrethanave ne optimizimin e Sistemit Elektroenergjetik.
- III.6.3.2 Operatori i Sistemit te Shperndarjes ne menyre te pavarur do te formulojne planin e Perspektives dhe do ta paraqesin ne OST.
- III.6.3.2 OST do te shikoje vlefshmerine dhe do te modifikojte planet, nese eshte e nevojeshme, pas studimit te metodologjise dhe krahasimit me te dhenat historike. Me pas OST do te konsolidoje Planin e Perspektives per te gjithe strukturen dhe do ta perdore ate per formulimin e Planit te Perspektives se Sistemit te Transmetimit.

III.7 Procedurat e Planifikimit

III.7.1 Njesia Kordinuese

- III.7.1.1 OST do te kordinoje Planifikimin e Perdoruesve te lidhur me Sistemin e Transmetimit, bazuar ne te dhenat e planifikimit ne menyren e pershkruar ne Kod.

III.7.2 Informacioni qe jepet ne OST

III.7.2.1 Perdoruesit e lidhur dhe ata qe kerkojne te lidhen ne Sistemin e Transmetimit do te japin informacion dhe te dhena ne OST sh.a. bazuar ne specifikimet e Kodit te Planifikimit.

III.8 Te Dhenat e Planifikimit qe do te jepen nga OST**III.8.1 Te Pergjithshme**

III.8.1.1 OST me kerkese te Perdoruesit jep informacione dhe te dhena ne lidhje me nje pjese te Sistemit te Transmetimit, qe t'iu krijone atyre mundesi per lidhjen dhe perdorimin e Sistemit te Transmetimit.
Informacione dhe te dhena te tilla jane subjekt i rezervuar siç permendet ne Kodin e Rrjetit.

III.8.2 Te Dhena qe jepen nga OST me Kerkese te Perdoruesve

III.8.2.1 OST do te furnizojë me çdo informacion tjetër që mund të kërkohej në mënyrë të arsyetuar për t'i bërë të mundur Perdoruesit të identifikojë dhe vlerësojë mundësitë për tu lidhur dhe përdorur një pjesë të Sistemit të Transmetimit, të specifikuar në kërkesë. Nëse kërkohej, OST gjithashtu do të ofrojë pikepamjet e veta mbi gjendjen e pjesës së sistemit të specifikuar në kërkesë.

III.9 Te dhenat e Sistemit te Transmetimit te OST

III.9.1 Te dhenat e Sistemit te Transmetimit konsistojne ne paraqitjen e Sistemit te Transmetimit egzistues dhe Sistemit te Transmetimit ne te ardhmen ashtu si pershkruhet ne Planin e Perspektives. Te dhena te tilla perfshijne:

- i. Harten e Shtetit qe tregon elementet egzistues te Sistemit te Transmetimit dhe ato te perspektives (te treguara me pika).
- ii. Skemen nje fazore te Sistemit te Transmetimit qe tregon elementet egzistues dhe ato te perspektives (te treguara me pika) si dhe pikat ku lidhen Centralet Gjenerues.

III.9.2 Te dhenat e Sistemit te Shperndarjes do te kufizohen ne Nenstacionet 110/TM kV te Rrjetit duke treguar per to daljet e linjave dhe te transformatoreve.

III.9.3 OST do te publikojë një listë të pikave të preferuara për lidhje në Sistemin e Transmetimit.

III.9.4 OST gjithashtu do të furnizojë Perdoruesit me të dhënat specifike të kerkuara nga ata.

III.10 Kostoja e te dhenave

III.10.1 OST do te kete te drejte t'u kerkoje Perdoruesve pagese per çdo te dhene te Sistemit te Transmetimit, dhe do te informoje Perdoruesin per gjithë koston brenda 15 diteve, pas marjes se kerkeses specifike. Te dhenat e Sistemit te Transmetimit do te jepen brenda dy muajve pas kerkeses se Perdoruesit, ne varesi te natyres dhe kompleksitetit te te dhenave te kerkuara.

III.11 E drejta e OST per mbajtjen e Informacionit

III.11.1 OST do te kete te drejte te mbaje te fshehte çdo te dhene te Sistemit te Transmetimit, nese ne opinionin e arsyetuar nga OST, nxjerrja e ketyre informacioneve do te ndikojë seriozisht ne interesin komercial te OST. Megjithate OST do te jape nje minimum te dhenash kur eshte e qarte, qe Perdoruesit nuk mund te kryejne biznesin e tyre pa keto te dhena.

III.12 Konfidencialiteti i te Dhenave

III.12.1 Gjithë te dhenat qe merr OST nga Perdoruesi dhe anasjelltas do te trajtohen si konfidenciale dhe nuk do te behen te njohura tek palet e treta. Te dhenat do te perdoren vetem per qellimin qe ato jepen.

III.13 Te Dhenat e Planifikimit te Kerkuara nga Perdoruesit**III.13.1 Sistemimi i te dhenave qe jepen nga Perdoruesit ne OST**

III.13.1.1 Çdo Perdorues duhet ti jape OST te dhenat qe kane te bejne me sistemin/objektin e tij:

- i. te azhornoje bazen e te dhenave qe nevojiten per kryerjen e studimeve dhe planifikimin e Sistemit te Transmetimit
- ii. te hartojë te plote planin vjetor per sistemin/objektin e tij brenda planit 5 vjeçar te OST
- iii. te rishikojë progresin e projekteve te reja dhe zhvillimet e aprovuara me perpara, brenda planit 5 vjeçar;
- iv. te konfirmojë pershtatshmerine me kerkesat sipas Licenses se tij dhe sipas Kodit te Rrjetit.

III.13.1.2 Te dhenat qe do te perftohen nga OST direkt nga Gjeneruesit do te jene ne formatet e percaktuara ne Kodin e Planifikimit.

III.14 Kategorite e te Dhenave te Planifikimit

III.14.0.1 Per te plotesuar kerkesat e permendura me lart, te dhenat e planifikimit nga Perdoruesit do te kategorizohen ne dy grupe si me poshte:

- i. Te Dhena Fillestare te Projektit te Planifikuar
- ii. Te Dhena te Detyruara te Projektit te Planifikuar

III.14.0.2 Secili grup permban:

- i. Te Dhena Standarte te Planifikimit

- ii. Te Dhena te Detajuara te Planifikimit
- iii. Te Dhena Vjetore te Planifikimit te Sistemit
- iv. Te Dhena te Planifikimit 5 vjecar te Sistemit
- v. Te Dhena per Punet ne Progres
- i. Te Dhena Perfundimtare

III.14.0.2 Çdo Perdorues do te paraqese keto te dhena ne OST sh.a. deri ne 30 shtator te cdo viti, per vitin/vitet pasardhes.

III.14.1 Te Dhena Specifike Shtese dhe Konfidenciale

III.14.1.1 Ne shtese te specifikimeve te mesiperme, OST mund te ndjek vertetesine e te Dhenave duke kerkuar qartesime dhe/ose informacione shtese nga Perdoruesit per te dhenat e marra.

III.14.1.2 Deri ne kohen qe hyn ne Fuqi Marreveshja e Lidhjes ndermjet OST dhe Perdoruesit, te Dhenat do te trajtohen si konfidenciale dhe nuk do te hapen per palet e treta.

III.14.2 Te Dhenat Fillestare te Projektit te Planifikuar

III.14.2.1 Te dhenat e parashtruara ne kohen e aplikimit per Lidhje dhe Perdorim te Sistemit te Transmetimit, do te quhen si Te Dhena Fillestare te Projektit te Planifikuar.

III.14.2.2 Te dhenat fillestare te Projektit te Planifikuar do te permbajne normalisht vetem te Dhenat Standarte te Planifikimit, derisa te kerkohen ne menyre specifike te Dhena te Detajuara te Planifikimit nga OST.

III.14.3 Te Dhenat e Detyruara te Projektit te Planifikuar

III.14.3.1 Pas ofertes per nje Mareveshje Lidhje te pranuar nga Perdoruesi, te Dhenat e parashtruara me pare dhe me pas te marra nga OST duke u bazuar ne Kodin e Planifikimit, do te quhen Te Dhenat e Detyruara te Projektit te Planifikuar.

III.14.3.2 Keto te dhena do te formojne bazen per Planifikimin e Sistemit te Transmetimit.

III.14.3.3 Te Dhenat e Detyruara te Projektit te Planifikuar nuk do te trajtohen konfidenciale ne menyre qe:

- i. OST te mund te perfshije keto te dhena ne sistemin e tij te te Dhenave ne pajtueshmeri me paragrafet e **Kodit te Planifikimit**.

III.14.3.4 Te Dhenat e Detyruara te Projektit te Planifikuar normalisht do te perfshijne te dy llojet e te dhenave: Te Dhenat Standarte te Planifikimit dhe Te Dhenat e Detajuara te Planifikimit.

III.14.4 Te Dhenat Standarte te Planifikimit

III.14.4.1 Gjeneruesit

- i. Te dhenat e kerkuara listohen ne paragrafin perkates **A.1, Pjesa-1,Shtojca-A**

- ii. Te dhenat parashtrohen gjate aplikimit per Lidhje te Re, per shtim te nje njesie Gjeneruese, per çdo modifikim te impianteve dhe paisjeve te cilat ndikojne ne sjelljen e Sistemit te Transmetimit
- iii. Te dhenat duhet te paraqiten nga Perdoruesit e lidhur ne Sistemin e Transmetimit ne pajtueshmeri me paragrafet perkates

III.14.4.1 **Transmetimi**

- i. Te dhenat e kerkuara listohen ne **paragrafin A.2 ,Pjesa-1,**

III.14.4.1 **Shperndarja**

- i. Te dhenat e Shperndarjes listohen si ne **paragrafin A.3, Pjesa-1, Shtojca-A.**
- i. Te dhenat duhet te paraqiten me aplikimin per lidhje te reja, per shtese te linjave te reja dhe nenstacioneve, per çdo modifikim te linjave dhe paisjeve, te cilat mund te ndikojne materjalisht ne sjelljen e Sistemit te Transmetimit

III.14.4.1 **Klientet e Kualifikuar**

- i. Te dhenat e Klienteve te Kualifikuar listohen si ne **paragrafin A.3, Pjesa-1, Shtojca-A.**
- i. Te dhenat duhet te paraqiten me aplikimin per lidhje te reja, per shtese te linjave te reja dhe nenstacioneve, per çdo modifikim te linjave dhe paisjeve, te cilat mund te ndikojne materjalisht ne sjelljen e Sistemit te Transmetimit.

III.14.4.1 **Formatet**

- i. Ne te gjitha rastet te dhenat paraqiten ne formatet e pershkruar ne Shtojca te ketij Kodi, dhe ne rast se nuk jane ne Shtojca te shoqerohen me nje shenim qe mbulon termat qe nuk perfshihen ne Shtojca.

III.14.5 **Te Dhenat e Detajuara te Planifikimit**

III.14.5.1 **Formatet**

Te dhenat e kerkuara listohen ne Paragrafet: **A.4; A.5; A.6; A.7; A.8; A.9; A.10; A.11; Pjesa-2 Shtojca-A.**

III.14.5.2 **Te Dhena te Perdoruesve Egzistus**

Perdoruesit tashme te lidhur ne Sistemin e Transmetimit, do te dergojne te dhenat deri ne 30 Shtator per vitin/vitet pasardhes.

III.14.5.3 **Te Dhena te Perdoruesve te Perspektives**

Te dhenat duhet te paraqiten nga te gjitha Perdoruesit qe kerkojne te lidhen ne Sistemin e Transmetimit.

III.14.6 **Te Dhenat Vjetore te Planifikimit**

Jepen nga te gjitha Perdoruesit.

III.14.6.1 **Formatet**

Te dhenat e kerkuara listohen ne **paragrafin A, Pjesa-3. Shtojca -A.**

III.14.6.2 **Afati Kohor**

Te gjithë perdoruesit e lidhur ne Sistemin e Transmetimit, do te dergojne te dhenat deri me 30 Shtator per vitin pasardhes.

III.14.7 Te Dhenat te Planifikimit 5 Vjecar

Jepen nga te gjithë Perdoruesit.

III.14.7.1 *Formati*

Te dhenat e kerkuara listohen **ne paragrafin B, Pjesa-3. Shtojca – A.**

III.14.7.2 *Afati Kohor*

Te gjithë perdoruesit e lidhur ne Sistemin e Transmetimit, do te dergojne te dhenat deri me 30 shtator, per 5 vitet pasardhes.

III.14.8 Te Dhena per Punet ne Progres

Jepen nga te gjithë Perdoruesit.

III.14.8.1 *Formati*

Te dhenat e kerkuara listohen ne paragrafin **C, Pjesa-3. Shtojca - A.**

III.14.8.2 *Afati Kohor*

Te gjithë perdoruesit e lidhur ne Sistemin e Transmetimit, deri me 31 Mars, do te paraqesin keto te dhena.

III.14.9 Te Dhenat Perfundimtare

III.14.9.1 *Formati*

Te Dhenat e kerkuara listohen ne paragrafin **D, Pjesa-3, Shtojca –A.**

III.14.9.2 *Afati Kohor*

Te gjithë perdoruesit e lidhur ne Sistemin e Transmetimit, do te dergojne te dhenat ne kohen e perfundimit te punimeve dhe kur ata jane te gatshem per t'u lidhur me Sistemin e Transmetimit.

III.14.10 Te Dhena Shtese

Nese per kryerjen e planifikimit ose per kryerjen e funksioneve te tjera te nje Pale, nje Pale kerkon nga nje Pale tjetere, te dhena shtese perveç atyre te pershkruara ne Kodin e Planifikimit dhe Shtojcat e tij, te dhena te tilla mund te shkembihen me nje miratim reciprok ne çdo kohe ndermjet subjekteve te autorizuar sipas kushteve te pergjithshme dhe perkufizimeve te permendura ne kete Kod Planifikimi.

III.14.11 Mosmarja parasysh e te Dhenave

Pjese te caktuara te te dhenave te pershkruara ne kete Kod mund te mos merren parasysh ne ndonje kohe me ane te nje deklarate te shkruar nga Pala marrese me kerkese te Pales dhenese.

III.15 Planifikimi per Permiresimin dhe Modifikimin e Paisjeve te Sistemit Elektroenergjetik egzistues

III.15.1 Hyrje

III.15.1.1 Ky paragraf shqyrton planifikimin per permiresimin e sjelljes se Sistemit Elektroenergjetik egzistues dhe paisjeve te tij. Ky proces mund te perfshije modifikimin dhe/ ose zevendesimin total te paisjeve duke kryer nje seri punimesh por pa nderhyre ne paisjen kryesore. Modifikime te vogla dhe riparime te paisjeve kryen vetem per qellimin e pershkruar ne kete paragraf. Gjithe Palet identifikojne zonat ku do te kryhen punet modifikuese duke kryer investime te cilat do te permiresojne cilesine dhe/ose sasine e perfitimeve dhe do te zhvillojne planet per permiresimin e sjelljes se sistemeve/objekteve te tyre. OST do te nxise dhe kordinoje programet e Perdoruesve ne zhvillimin e planeve per modifikimin dhe permiresimin e sistemeve/objekteve te tyre.

III.15.2 Objektivat

III.15.2.1 Synimet e Planeve te tilla, qe perfshijne investime te vogla, jane: permiresimi i sjelljes se paisjeve, i cilesise se furnizimit me energji elektrike, i qendrueshmerise se rrjetit, i sigurise, i kriterit ekonomik, i reduktimit te humbjeve te energjise elektrike dhe i permiresimit te standarteve te sigurise se jetes dhe paisjeve.

III.15.3 Sistemi i Transmetimit

IV.4.3.1 Te gjitha Perdoruesit do te parashtojne ne OST te dhenat fillestare te stakimit te impianteve ose elementeve te tyre per vitin pasardhes deri ne 30 Tetor.

IV.4.3.2 Gjeneruesit japin ne OST historikun e realizimit te mirembajtjeve per tre vitet e meparshme si dhe tabelen e difekteve te paparashikuara dhe kohezgjatjen e ketyre defekteve.

IV.4.3.3 Plani i koordinuar dhe i pranuar nga Palet do te jete perfundimtar deri ne 15 dhjetor.

IV.4.4 Metodologjia

IV.4.4.1 Objekti i ketij paragrafi eshte te percaktoje metoden e perdorur per te ndihmuar Qendren Dispeçer per perгатitjen e nje programi te kordinuar te nderprerjeve (stakimeve) te gjenerimit duke marre ne konsiderate gjitha burimet e mundeshme dhe duke marre parasysh detyrimet ne Sistemin e Transmetimit.

IV.4.4.2 Metodologjia qe perdoret nga OST ne formulimin e planifikimit te nderprerjeve te gjenerimit eshte si me poshte:

- i. Per te rritur mundesite e gjenerimit nga njesite Termike merret ne konsiderate sjellja e njesise termike e tre viteve te meparshem
- ii. Per te rritur mundesite e gjenerimit nga njesite Hidrike merret ne konsiderate mesatarja e prurjeve te ujit ne rezervuar per 10 vitet e fundit.

IV.4.5 Bashkeveprimi dhe Pergjegjesite

IV.4.5.1 OST do te koordinoje bashkeveprimin me te gjitha Perdoruesit.

IV.4.6 Balanca Ngarkese - Gjenerim

IV.4.6.1 OST do te perгатise propozimet per kombinimin e balances Ngarkese- Gjenerim per vitin pasardhes, bazuar ne planin e gjenerimit te paraqitur nga Gjeneruesit.

IV.4.6.2 Balanca e propozuar Ngarkese-Gjenerim do te tregojte mundesine e sigurimit te Fuqise dhe Energjise.

IV.4.6.3 Ne rishikimin e bere nga OST dhe ne verifikimin e metejsheem te programeve mujore nga OST, plani i propozuar i balances Ngarkese-Gjenerim i perгатitur nga OST do te studjohet dhe me pas ky plan do te jepet per zbatim.

IV.4.6.4 OST ne menyre periodike do te rishikojë dhe pergatise propozime per korigjimin e Planit te Gjenerimit, qe te optimizojë perdorimin e burimeve te mundeshme ne koordinim me nderprerjet e Sistemit te Transmetimit.

IV.4.7 Procesi i Nderprerjeve te Gjenerimit per Mirembajtje

IV.4.7.1 Viti Pasardhes

IV.4.7.1.1 OST do te perdore te dhenat e marra nga te gjithë Gjeneruesit per pergatitjen e planit te nderprerjeve te Gjenerimit per vitin pasardhes.

IV.4.7.1.2 OST do te percaktojë mundesine e sigurimit te fuqise dhe energjise nga çdo njesi Gjenerimi per çdo muaj, e kombinuar kjo me disponibilitetin e linjave te interkonjeksionit.

IV.4.7.1.3 OST do te perpilojë tabelat qe pershkruajnë mundesine e sigurimit mujor te fuqise dhe energjise kundrejt kerkeses per fuqi dhe energji, bashke me kushtet e njesive gjeneruese.

IV.4.7.1.4 Tabelat tregojnë periudhat gjate te cilave egziston mundesia per rritjen apo reduktimin e gjenerimit si dhe deficitet apo tepricat.

IV.4.7.1.5 Nese ekzistojnë te dyja: teprica dhe deficioni, gjate periudhes se planifikuar Qendra Dispeçer do te japë propozime per kordinim te qendrueshem dhe shkallezim te periudhes se nderprerjes se gjenerimit per te eliminuar ose reduktuar deficionin.

IV.4.7.1.6 Nese ka vetem deficion gjate gjithë periudhes se planifikuar, Qendra Dispeçer do te perpiqet te ule deficionin e larte duke levizur periudhat e nderprerjes. Gjithashtu do te perpiqet te reduktojë deficionin mesatar nepermjet importit.

IV.4.7.1.7 OST pasi te bindet qe eshte realizuar maksimumi i permiresimeve, do te pergatise nje draft plan te gjenerimit dhe e qarkullon ate tek Gjeneruesit duke kerkuar sugjerime.

IV.4.7.1.8 OST do te shqyrtojë dhe do te aprovojë pas konsultimeve dhe me partneret rajonal, planin e nderprerjeve per vitin pasardhes te elementeve te interkoneksionit.

IV.4.7.1.9 Asnje nderprerje nuk do te planifikohet per njesite hidrike gjate muajve me prurje te medha ose mbingarkim te rezervuareve.

IV.4.7.2 Amendamentet e Nderprerjeve te Planifikuara

IV.4.7.2.1 Ne rast te nje nderprerje te planifikuar ne te cilen OST do te pelqente te levizte:

- i. Pertej periudhes ose
- ii. Brenda periudhes

IV.4.7.2.2 OST mbi te gjitha duhet ti japë nje njoftim me shkrim Gjeneruesve, ku i kerkon qe data e fillimit ose koha e nderprerjes, qe eshte dhene me perpara, te shtyje afatin.

IV.4.7.2.3 Nese gjeneruesi bie dakort ose OST dhe Gjeneruesi bien dakort per ndonje periudhe/date tjeter, Gjeneruesi do ta bejë nderprerjen ne perputhje me marreveshjen.

IV.4.7.2.3 Nje Gjenerues, me njoftim me shkrim te parashtruar ne OST ne çdo kohe gjate gjithë vitit, mund te kerkojë qe nje njesi gjeneruese te zevendesohet me nje njesi tjeter te

krahasushme ne Centralin e tij, qe ka te njejtin kapacitet kontraktues zevendesues. OST nuk do te refuzoje ne menyre te pa arsyetuar miratimin e tij per nje zevendesim te tille. Nese OST e miraton, programi final i nderprerjeve do te rregullohet ne menyre te pershtateshme.

IV.4.8 Proçesi i Nderprerjeve per Mirembajtje ne Sistemin e Transmetimit, Operatorin e Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar

- IV.4.8.0.1 Nderprerja (stakimi) e elementeve te Sistemit te Transmetimit fillimisht duhet te koordinohet me nderprerjet e njesive Gjeneruese dhe me pas me nderprerjet e elementeve te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar.
- IV.4.8.0.2 Programi i nderprerjeve i elementeve te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar per vitin pasardhes duhet te raportohet nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar ne OST deri 30 Tetor.
- IV.4.8.0.3 Qendra Dispeçer do te pergatise nje Plan Paraprak te Nderprerjeve te Sistemit te Transmetimit, te kordinuar me Planin e Nderprerjeve te Gjenerimit, me Planin e Nderprerjeve te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar.
- IV.4.8.0.4 OST do te modifikoje programin e nderprerjeve te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe te Konsumatoreve te Kualifikuar duke ndjekur rregullin e prioriteteve, p.sh. nderprerjet e elementeve te Transmetimit duhet te koordinohen me planin e nderprerjeve te Gjenerimit dhe nderprerjet e elementeve te Shperndarjes dhe te Konsumatoreve te Kualifikuar duhet te pershtaten per koordinim me nderprerjet e Transmetimit.
- IV.4.8.0.5 Planifikimi i nderprerjeve te Transmetimit do te behet per elementet e meposhtem:
- i. Linjat e Transmetimit 400 kV dhe Transformoret e Autotransformatoret 400/220 kV, 400/110 kV.
 - ii. Linjat e Transmetimit 220 kV dhe Transformoret e Autotransformatoret 220/110 kV.
 - iii. Linjat kritike te identifikuara te SEE, te cilat do te ndikojne ne Sistemin e Transmetimit dhe funksionimin e SEE.
 - iv. Linjat Radiale 110 kV qe ushqejne Sistemet e Shperndarjes dhe konsumatoret 110 kV. (Keto do te planifikohen te ndara ne konsultim me kompanine e shperndarjes dhe konsumatoret 110 kV).
- IV.4.8.0.6 Planet e nderprerjeve te Sistemit te Shperndarjes dhe te Konsumatoreve te Kualifikuar te rishikuara nga OST gjithashtu do te komunikohen ne Operatorin e Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar deri ne 15 Dhjetor.
- IV.4.8.0.7 OST mund te therrase mbledhje per koordinimin e planit te nderprerjeve te elementeve te Transmetimit.

IV.4.8.0.8 Qendra Dispeçer do të rishikojë planin e nderprerjeve të Sistemit të Shperndarjes dhe të Konsumatoreve të Kualifikuar për ta koordinuar atë me planin e nderprerjeve të elementeve të Sistemit të Transmetimit. Pasi ka marrë në konsideratë vendimet dhe rekomandimet mbi këto baze do të përgatisë Draft Planin e Nderprerjeve të Transmetimit. Draft Plani i komunikohet të gjithë përdoruesve deri më 15 Dhjetor.

IV.4.8.1 **Nderprerja e Transformatoreve të Fuqisë, tensioni i anës së ulët dhe të cilëve është 35kV, 20kV, 10 kV**

Për transformatorët që zotërohen nga OST plani i nderprerjeve të këtyre transformatoreve do të harmonizohet me nderprerjet e elementeve të Shperndarjes. Kompania shperndarese do të komunikojnë planin e nderprerjeve të sistemeve të tyre shperndares që ushqehen nga këta transformatore në OST përpara 30 Nëntorit.

IV.4.8.2 **Plani Perfundimtar i verifikuar i nderprerjeve**

OST do të nxjerrë planin final të nderprerjeve që përfshin nderprerjet e njësive gjeneruese, elementeve të Transmetimit, elementeve të Shperndarjes dhe Konsumatoreve të Kualifikuar deri në 20 Dhjetor dhe do të komunikojë Planin në të gjithë Gjeneruesit, Operatorin e Sistemit të Shperndarjes dhe Konsumatorët e Kualifikuar. Plani Final i Përgjithshëm i Nderprerjeve siç është rënë dakort nga gjithë Palet, nxirret deri në 31 Dhjetor.

IV.4.8.3 **Shtyrja e Nderprerjeve**

IV.4.8.3.1 Qendra Dispeçer është e autorizuar për shtyrjen e çdo nderprerje të planifikuar, kur ngjarjet e mëposhtme ndikojnë në funksionimin e SEE:

- i. Avari të mëdha të SEE;
- ii. Renje (black-out) totale ose e pjesëshme të SEE;
- iii. Izolim i territ të SEE ose pjesëve të tij nga Sistemet fqinje;
- iv. Mbingarkesa të mëdha të elementeve të Sistemit të Transmetimit

IV.4.8.3.1 Pavarësisht nga rezervat në çdo plan nderprerjesh të aprovuar, asnjë linjë interkoneksioni ose njësi e një gjeneruesi nuk do të levizet nga shërbimi pa leje specifike nga Qendra Dispeçer. Kjo klauzole do të jetë e zbatueshme dhe për Gjeneruesit e Pavarur nëse është parashikuar në kontratë me ta.

IV.4.8.3.1 Ndonjëherë pasi një nderprerje për mirëmbajtje ka filluar, dhe nëse procesi i mirëmbajtjes është vonuar, Qendra Dispeçer ose Përdoruesit përkatës do të informojnë menjëherë Palet për kohën e venjes në punë.

IV.5 **Programimi**

IV.5.1 **Programi Dispeçer**

IV.5.1.1 Ky paragraf specifikon procedurat që përdoren për programimin dhe dispeçerimin e njësive gjeneruese për të plotësuar kërkesën për fuqi si dhe mbajtjen e niveleve të tensionit dhe frekuencës brenda kufijve të pranueshëm, si dhe përcaktonte kontributin e Përdoruesve në ndihmë të arritjes të këtyre qëllimeve.

IV.5.2 *Objektivi*

IV.5.2.1 Objekti i ketij paragrafi eshte te detajoje veprimet dhe pergjegjesite e Qendres Dispeçer ne pergatitjen dhe nxjerrjen e nje planifikimi ditor te gjenerimit dhe pergjegjesite e Perdoruesve per te furnizuar me te dhenat e nevojeshme, si dhe te pershtatet me kete Planifikim. Ai gjithashtu specifikon pergjegjesite e Qendres Dispeçer dhe Perdoruesve ne menaxhimin e niveleve te tensionit dhe frekuences.

IV.5.3 **Programimi i Gjenerimit**

IV.5.3.1 OST nxjerr urdhera operative dhe udhezime, qe te informoje dhe te detyroje Gjeneruesit te mbajne ne pune njesite gjeneruese te programuara per ditën pasuese.

IV.5.3.2 Per kete OST do te perdore kerkesen per MW/MVAr si baze per pergatitjen e urdherave operative dhe udhezimeve, duke marre gjithashtu ne konsiderate planin e nderprerjeve per mirembajtje.

IV.5.3.3 Ne mungese te urdherave operative gjithë gjeneruesit do te garantojne mundesine e mbulimit te kerkeses per çdo ore MW/MVAr (00.00-24.00 ore) per te gjitha njesite gjeneruese te disponushme, bazuar ne planin e dites aktuale dhe e dergojne ne Qendren Dispeçer per ditën pasuese.

IV.5.3.4 Mundesia e pjesemarrjes ne mbulimin e kerkeses MW/MVAr, nga Centralet hidrike, realizohet duke marre ne konsiderate prurjet e priteshme, nivelet e rezervuareve te tyre, si dhe ndonje kufizim tjeter qe raportohet ne Qendren Dispeçer.

IV.5.3.5 Mundesia e pjesemarrjes ne mbulimin e kerkeses MW/MVAr, nga Centralet termik realizohet duke marre ne konsiderate rezervat e lendes djegese si dhe ndonje kufizim tjeter qe raportohet ne Qendren Dispeçer.

IV.5.3.6 Qendra Dispeçer pergatit programin e gjenerimit / programin e importit.

IV.5.3.7 Qendra Dispeçer perpunon nje dite me perpara programin e gjenerimit te ndare ne ore, pas konsolidimit te te dhenave te siguruara nga Gjeneruesit dhe kordinon importin e Energjise Elektrike ne baze te kontratave. Ajo merr ne konsiderate vleresimet orare per kerkesen MW/MVAr.

IV.5.3.8 Ne pergatitjen e programit Qendra Dispeçer merr ne konsiderate qe gjenerimi te jete ne kufijte maksimal per Centralet Hidrik, kur ka prurje dhe nivele te larta uji ne rezervuaret e tyre.

IV.5.3.9 Nese gjate dites se zbatimit te programit Gjeneruesit raportojne ne Qendren Dispeçer per ndonje suate, e cila ndikon ne zbatimin e programit, atehere Qendra Dispeçer ne menyre te shpejte ben riprogramimin e nevojshem, i cili i behet i ditur gjithë Gjeneruesve qe ndikohen nga ky veprim.

IV.5.3.10 Qendra Dispeçer u kerkon Gjeneruesve te gjenerojne sipas kerkeses se saj MVAr brenda mundesise se kufijve te tyre respektive, per mbajtjen e niveleve te kerkuara te tensionit ne zbara.

IV.5.3.11 Qendra Dispeçer urdheron Gjeneruesit te mbajne kapacitetin rezerve te nevojshem, siç percaktohet ne kete Kod. Nese gjate programimit nuk plotesohet kerkesa MW, MVAr, Qendra Dispeçer i kerkon Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar te organizojne kufizime racionale.

IV.5.3.12 Qendra Dispeçer do te pergatise programin e gjenerimit duke u bazuar ne:

- i. Detyrimet e Sistemit te Transmetimit
- ii. Kerkesen MW/MVAr orare vleresuar nga Qendra Dispeçer
- iii. Nevojen per sigurimin e rezervave per operimin ekonomik per SEE, Sistemin e Transmetimit dhe detyrimet qe lindin nga pjesemarrja ne organizmat rajonal dhe Europian (UCTE, ETSO, SETSO, etj).

IV.5.4 Zbatimi i Programit Dispeçer nga Gjeneruesit

IV.5.4.1 Gjeneruesit do te programojne njesite e tyre gjeneruese duke u bazuar ne programin ditor te gjenerimit urdheruar nga Qendra Dispeçer.

IV.5.4.2 Njesite Gjeneruese te cilat nuk jane direkt te lidhura me Sistemin e Transmetimit, nuk do te jene subjekt i urdherave operative te Dispeçerise Qendrore, por do te raportojne per gjendjen e njesive te tyre ne Qendren Dispeçer.

IV.5.4.3 Qendra Dispeçer drejton nepermjet urdherave operative gjenerimin dhe importet, duke u bazuar ne programin orar te gjenerimit te dites, te rene dakord nje dite me pare, perveç rasteve kur kerkohet riprogramimi per rrethana te paparashikuara.

IV.5.4.4 Urdherat Operative te Dispeçerise do te jene ne format standart.

IV.5.4.5 Urdherat Operative te Dispeçerise perfshijne veprimet e meposhtme por dhe veprime te tjera qe pershkruhen ne urdherat respektiv:

- i. Futjen ne pune ose nxjerrjen jashte pune te njesive gjeneruese per te cilen urdherohen.
- ii. Njesite gjeneruese ne gadishmeri (stand by).
- iii. Detajet e meposhteme:
- iv. Fuqine MW qe injekton njesia gjeneruese.
- v. Fuqine MVAr qe injekton njesia gjeneruese.
- vi. Nivelin e tensionit te kerkuar ne zbaren ku lidhet njesia gjeneruese.
- vii. Nivelin e rezerves perkatese te njesise gjeneruese.

IV.5.5 Komunikimi me Gjeneruesit

IV.5.5.1 Urdherat Operative te Qendres Dispeçer do te jepen me telefon, fonograme, Faks, E-Mail dhe konfirmohen nga operatoret dergues dhe marres.

IV.5.5.2 Çdo Urdher gojor me telefon perpilohet menjehere dhe regjistrohen me shkrim ne librin operativ te Paleve.

IV.5.5.3 Kur te rriten aftesite e Qendres Dispecer nepermjet SCADA urdherat operative jepen me mesazhe kompjuterike.

IV.5.6 Veprime qe kryhen nga Gjeneruesit

IV.5.6.1 Gjeneruesit do te sigurojne injektimin çdo ore nga njesite gjeneruese (MW dhe MVAR) ne kohe reale.

IV.5.6.2 Gjeneruesit zbatojne menjehere urdherat operative te nxjerra nga Qendra Dispecer pervec rasteve kur ky veprim mund te kompromentoje sigurine e personelit ose impiantit.

IV.5.6.3 Gjeneruesit do te njoftojne menjehere Qendren Dispecer ne rast te ndonje veshtiresie te paparashikuar ne zbatimin e urdherit.

IV.5.6.4 Gjeneruesit do te informojne menjehere Qendren Dispecer me telefon per ndonje humbje ose ndryshim te mundesive operacionale te ndonje Njesie Gjenerimi, e cila eshte e sinkronizuar ne SEE ose eshte programuar per te mbajtur rezerven e SEE.

IV.5.6.5 Me marjen e Urdherit per sinkronizim nga Qendra Dispecer, Gjeneruesit do te sinkronizojne njesine gjeneruese perkatese ne rrjet brenda kohes normale referuar kesaj njesie. Ne pamundesi per ta bere kete do te njoftohet menjehere ne Qendren Dispecer pa humbje kohe.

IV.5.6.6 Gjeneruesit nuk do te de-sinkronizojne Njesite Gjeneruese, pa urdher nga Qendra Dispecer, me perjashtim te rasteve te sigurise se personelit ose Centralit, per te cilin raportohet menjehere ne Qendren Dispecer.

IV.5.6.7 Gjithe Njesite Gjeneruese do te kene rregullator shpejtesie ne sherbim qe te jete ne gjendje te rrise ose te ule ne menyre automatike injektimin e fuqise MW, MVAR brenda nivelit normal te deklaruar.

IV.5.6.8 Te gjithe Njesite Gjeneruese do te kene Rregullator Automatik Tensioni ne sherbim, qe te jete ne gjendje te rregulloje nivelin e tensionit brenda nivelit normal te deklaruar.

IV.5.6.9 Gjeneruesit do te informojne Qendren Dispecer per çdo heqje te RAT dhe /ose te RASH nga sherbimi si dhe arsyet.

IV.5.6.10 Gjeneruesit do te raportojne ne Qendren Dispecer çdo parameter te njesise ore per ore, qe lidhet me funksionimin e Njesive Gjeneruese

IV.5.7 Permiresimi i Procedurave te Programimit dhe Dispecerise

IV.5.7.1 Procedurat e Programimit dhe Dispecerise do te permiresohen ne menyre te qendrueshme per te plotesuar nevojat qe do te dalin.

IV.6 Sherbimet Ndhimese ne SEE

IV.6.1 Hyrje

IV.6.1.1 Sherbimet Ndhimese ne SEE kane si objektiv sigurimin e kushteve per operimin e SEE dhe per rivendosjen e shpejte te punes normale ne rastin e çrregullimeve te medha.

IV.6.1.2 Sherbimet ndihmese perbejne nje kategori te veçante te sherbimeve, nga te cilet perfitojne te gjithe Perdoruesit e Sistemit te Transmetimit. Sherbimet ndihmese jane ndare ne dy kategori:

- i. Operative
- ii. Teknologjike

IV.6.1.3 Sherbimet Ndhimese Operative

Sherbimet ndihmese operative te SEE pembajne sherbime per planifikimin dhe drejtimin operativ, si dhe aktivitetet e tjera te kryera nga Qendra Dispeçer, ne menyre qe te plotesohet furnizimi i sigurte dhe pa rreziqe, me kosto minimale i konsumatoreve te Energjise Elektrike.

IV.6.1.3 Sherbimet Ndhimese Teknologjike

Sherbimet Ndhimese Teknologjike kryhen nga Perdoruesit e Sistemit te Transmetimit dhe nga OST dhe kane si qellim:

- i. Mbajtjen e Qendrushmerise Statike dhe Dinamike te SEE.
- ii. Mbajtjen e niveleve te tensionit brenda niveleve te lejuar.
- iii. Rivendosjen e SEE kur ka renie te pjeseshme ose te plote, ne rastin e avarive te medha.

IV.6.1.4 Sherbimet Ndhimese te ofruara nga Perdoruesit paguhen nga OST.

IV.6.1.5 Sherbimet per sigurimin e shkembimeve te Energjise Elektrike me vendet fqinje, ofrohen nga OST dhe paguhen nga OST.

IV.6.1.5 Sherbimet Ndhimese Teknologjike Realizohen duke u plotesuar:

- i. Sigurimi i Rezerves se Rregullimit Primar te frekuences,
- ii. Sigurimi i Rezerves se Rregullimit Sekondar te frekuence/fuqi aktive,
- iii. Sigurimi i Rezerves se Rregullimit te fuqise aktive,
- iv. Sigurimi i fuqise reaktive dhe rregullimin e niveleve te tensionit,

IV.7 Siguria gjate Shfrytezimit

IV.7.0.1 Rrjeti i Transmetimit projektohet per tu shfrytezuar ne mynyre te tille qe te plotesohen kriteri i sigurise (n-1), kriteri i qendrushmerise statike dhe kushtet e qendrushmerise dinamike.

IV.7.1 Sherbimet Ndhimese qe Sigurojne Rregullimin e Frekuences

- IV.7.1.1 Qendra Dispeçer është e detyruar të koordinojë veprimet që kanë si qëllim mbajtjen e frekuencës brenda kufijëve të përcaktuar, në përputhje me standardet përkatëse të këtij Kodi Rrjeti.
- IV.7.1.2 Qendra Dispeçer bën të mundur përdorimin e rezervës egzistuese të fuqisë në SEE dhe mobilizimin e saj në kohën e duhur për të mbajtur balancën gjenerim – ngarkesë, si në rastin e disbalancave me kohë të gjatë (p.sh. për shkak të devijimit të kurbes së ngarkesës të lidhur me parashikimin), ashtu edhe në rastin e disbalancave të mëdha të shfaqura papritur (p.sh. në rastin e shkeputjes së njësisë gjeneruese ose heqjes së ngarkesës).
- IV.7.1.3 Rezerva e fuqisë në varesi të kohës dhe mënyrës (manuale ose automatike) në të cilën ajo vihet në dispozicion, klasifikohet:
- i. **Rezerva e Rregullimit Primar**
 - ii. **Rezerva e Rregullimit Sekondar**
 - iii. **Rezerva Rrotulluese (spinning)**
 - iv. **Rezerva e Rregullimit Terciar**

IV.7.2 Devijimet e Frekuencës

- IV.7.2.1 Devijimi i Frekuencës Δf është diferenca $f_n - f$ e frekuencës nominale të SEE f_n nga frekuenca aktuale e SEE f , si rezultat i çrregullimeve dhe avarive në SEE.
- IV.7.2.1 **Frekuenca Nominale është 50 Hz**

IV.7.3 Frekuenca minimale dhe maksimale e çastit

- IV.7.3.1 Frekuenca minimale e çastit nuk duhet të jetë poshtë 49.2 Hz, që i korrespondon një Devijimi – 800 mHz, i cili është devijimi maksimal i lejuar i frekuencës nga frekuenca nominale.
- IV.7.3.2 Frekuenca Maksimale e çastit nuk duhet të jetë mbi 50.8 Hz, që i korrespondon një Devijimi + 800 mHz, i cili është devijimi maksimal i lejuar i frekuencës nga frekuenca nominale.

IV.7.4 Rezerva e Rregullimit Primar të Frekuencës

- IV.7.4.1 Rezerva e Rregullimit Primar të frekuencës është rezerva që me devijimin e frekuencës nga vlera kufi (e lejuar) mund të vihet në levizje automatikisht për 30 sekonda dhe të jetë në gjendje të vazhdojë të operojë për një kohë të pakten prej 15 minutash, që realizohet nga rregullatorët automatikë të shpejtësisë (RASH), të cilët mbahen vazhdimisht në shërbim. Rregullimi primar i frekuencës aktivizohet nëse devijimi i frekuencës i kalon ± 20 mHz.
- IV.7.4.2 Sigurimi i rezervës së rregullimit primar sipas kërkesës së Qendres Dispeçer do të jetë një detyrim për të gjithë Gjeneruesit e Energjisë Elektrike brenda vendit.

- IV.7.4.3 Qendra Dispeçer urdheron madhesine e nevojshme te Rezerves se Rregullimit Primar sipas:
- i. Kushtit te operimit ne paralel te Sistemit te Transmetimit me vendet fqinje. Rezerva e Rregullimit Primar miratohet reciprokisht nga Operatoret e te gjithë Sistemeve te Transmetimit te interkonektuar dhe udhezimeve te UCTE.
 - ii. Kushtit te operimit te izoluar te Sistemit te Transmetimit, ku Rezerva minimale e Rregullimit Primar programohet ne baze te nje analize qe merr ne konsiderate mundesite teknike, ekonomike, duke ruajtur rreth 5% nga fuqia totale e gjeneruar.
- IV.7.4.4 Rezerva e Rregullimit Primar duhet te shperndahet ne te gjithë Gjeneruesit e lidhur direkt me Rrjetin e Transmetimit, ne menyre sa me uniforme dhe propocionale qe te jete e mundur.
- IV.7.4.5 OST brenda veprimtarise se programimit mbi kriterin ekonomik te njesive gjeneruese, programon Rezerven e Rregullimit Primar mbi bazen e ofertave te Gjeneruesve ne madhesine e kerkuar.
- IV.7.4.6 Ofertat e gjeneratoreve duhet te marrin parasysh detyrimin e mbajtjes ne dispozicion te Rezerves se Rregullimit Primar, ne pershtatje me sjelljet teknike te çdo njesie gjeneruese.

IV.7.5 Rezerva e Rregullimit Sekondar te Frekuence/Fuqi aktive

- IV.7.5.1 Rezerva e Rregullimit Sekondar frekuence/fuqi aktive eshte rezerve, e cila me devijimin e frekuences dhe/ose te balances se kembimit te fuqise nga vlera e lejuar dhe e programuar, mund te vihet ne pune automatikisht brenda nje intervali jo me shume se 15 minuta.
- IV.7.5.2 Rezerva e Rregullimit Sekondar frekuence/fuqi aktive mbivendoset mbi rezerven e Rregullimit Primar.
- IV.7.5.3 Qendra Dispeçer brenda aktivitetit te programimit mbi kriterin ekonomik te njesive gjeneruese programon rezerven e Rregullimit Sekondar frekuence/fuqi aktive ne madhesine e kerkuar, bazuar ne ofertat e gjeneruesve.
Gjeneruesit sigurojne rezerven e Rregullimit Sekondar frekuence/fuqi aktive ne pershtatje me programin dhe kerkesen e OST.

IV.7.6 Rezerva Rrotulluese

- IV.7.6.1 Rezerva Rrotulluese mbivendoset mbi rezerven e Rregullimit Primar dhe Sekondar dhe vendosjes se balances ne rastin e devijimit te shfaqur nga programi.
- IV.7.6.2 Rezerva rrotulluese sigurohet nga Gjeneruesit me urdher te Qendres Dispeçer, dhe ajo duhet te mbetet per periudhen e kohes se kerkuar nga Qendra Dispeçer.

IV.7.7 Rezerva e Rregullimit Terciar

- IV.7.7.1 Rezerva e Rregullimit Terciar i mbivendoset rezerves se Rregullimit Primar, Sekondar asaj Rrotulluse, per te vendosur balancen ne rastin e devijimeve te shfaqura nga programi i krijuar.
- IV.7.7.2 Rezerva e Rregullimit Terciar sigurohet nga Gjeneruesit, me urdher te Qendres Dispeçer, per periudhen e kohes se kerkuar.

IV.7.8 Sherbimet Ndhimese qe sigurojne mbajtjen e niveleve te tensionit

- IV.7.8.1 Mbajtja e niveleve te tensionit eshte nje komponent i rendesishem per operimin normal, per te cilen eshte pergjegjese Qendra Dispeçer.
- IV.7.8.2 Qendra Dispeçer eshte e detyruar te siguroje nivele te tilla tensioni per te ruajtur paisjet e Sistemit te Transmetimit.
- IV.7.8.3 OST operon instalimet e veta per ballancimin e fuqise reaktive ne Rrjetin e Transmetimit.
- IV.7.8.4 Gjeneruesi duhet te siguroje qe gjenerimi/absorbimi i fuqise reaktive duhet te garantohet nga njesite gjeneruese me kerkesen e Qendres Dispeçer ne perputhje me kushtet e lidhjes me Rrjetin e Transmetimit.
- IV.7.8.5 Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar te lidhur me Rrjetin e Transmetimit, duhet te kompensojne, sipas normave per konsumin/gjenerimin e fuqise reaktive nga vete sistemet e tyre.
- IV.7.8.6 Shkembimet e fuqise reaktive mund te lejohen ndermjet OST dhe Shperndarjes ose konsumatoreve te kualifikuar te lidhur me Rrjetin e Transmetimit, nese nuk cenohet operimi i sigurte i SEE.
- IV.7.8.7 Shkembimet ndermjet Rrjetit te Transmetimit dhe Rrjetit te Shperndarjes ose Konsumatoreve te Kualifikuar te lidhur me Rrjetin e Transmetimit, te cilet ndikojne ne operimin ekonomik te partnereve, te paguhen mbi bazen e rregullave te percaktuara nga Palet.

IV.7.9 Administrimi dhe Monitorimi i Frekuences

- IV.7.9.1 Qendra Dispeçer do te monitoroje frekuencen e SEE dhe do te ndermarre veprime per te siguruar qe ajo te jete brenda kufijve te lejuar.
- IV.7.9.2 Veprimet korigjuese behen menjehere kur frekuenca devijon nga vlera nominale.
- IV.7.9.3 Per sa kohe qe frekuenca tenton te bjere nen 50.00 Hz Qendra Dispeçer do te rrise terheqjet nga Centrallet Gjeneruese, dhe nga linjat e interkoneksionit ndershtetor sipas marreveshjeve ne fuqi.
- IV.7.9.4 Qendra Dispeçer do te jape urdhera per Operatorin e Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar per uljen e ngarkeses ne nje perqindje te dhene per ulje te ndryshme te frekuences.

- IV.7.9.5 Ne rast se Frekuenca tenton te bjere poshte 49.5 Hz terheqja nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar kufizohet.
- IV.7.9.6 Kur frekuenca bie nen 49.00 Hz nje kufizim i nevojshem organizohet nga Qendra Dispeçer per Operatorin e Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar.

IV.7.10 Menaxhimi i Tensionit

- IV.7.10.1 OST do te kryeje studime per shperndarjen e flukseve kohe pas kohe per te parashikuar ku mund te ndeshen problemet e tensionit dhe te identifikojë masat perkatese siç jane: ndryshimi i pozicionit te rregullatorit te tensionit ne transformator, ose ndryshimi i pozicionit te rregullatorit te tensionit ne paisjet kompensuese per te siguruar qe tensioni te mbetet brenda kufijve te percaktuar.
- IV.7.10.2 Ne baze te ketyre studimeve Qendra Dispeçer udhezon Gjeneruesit te mbajne nivele tensioni te specifikuara ne pikat e lidhjes se tyre me Sistemin e Transmetimit dhe te percaktoje nivelet e tensionit ne pikat e Lidhjes me Operatorin e Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar.
- IV.7.10.3 Qendra Dispeçer ne menyre konstante do te monitoroje nivelet e tensionit 400, 220, 110kV ne nenstacionet dhe do te komunikojë vlerat e niveleve te tensionit ne Operatorin e Sistemit te Transmetimit te vendeve fqinje.
- IV.7.10.4 Gjeneruesit dergojne ne Qendren Dispeçer Kurbat e Mundesise se prodhimit te azhornuara per gjithë njesite Gjeneruese, siç detajohet ne kete Kod, duke treguar çdo kufizim, per te lejuar studime te perpikta dhe funksionim efektiv te Sistemit te Transmetimit. Ne menyre te ngjashme do te japin mundesine per prodhimin neto te fuqise reaktive qe do te jete ne gjendje te injektoje/absorboje nga Sistemi i Transmetimit.
- IV.7.10.5 Gjate operimit ne kohe reale Gjeneruesit do te informojne me shpejtesi Qendren Dispeçer, per mundesine e rezerves se tyre reaktive, kur kjo kerkohet nga ajo.
- IV.7.10.6 Qendra Dispeçer urdheron Njesite Gjeneruese per te rregulluar gjenerimin MVAr brenda parametrave te tyre te deklaruar dhe i kerkon OST fqinje te respektojne marreveshjet perkatese ndermjet tyre.
- IV.7.10.7 Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar do te marrin pjese ne menaxhimin e tensionit duke rregulluar thithjet e tyre dhe duke vene ne dispozicion totalisht paisjet kompesuese kur u kerkohet nga Qendra Dispeçer.
- IV.7.10.8 Nese me keto masa nuk arrihet te mbahen nivele te pranueshme tensioni, Qendra Dispeçer do te marre masat e mundeshme ne Sistemin e Transmetimit me qellim plotesimin e kriterëve te kerkuara te tensionit dhe nese keto masa nuk jane te mjaftushme Perdoruesit do te pranojne situaten.

IV.7.11 Pagesa per Sherbimet Ndhimese ne SEE

- IV.7.11.1 Shpenzimet per rezervat e gjenerimit ne lidhje me ruajtjen e standarteve te percaktuara te sigurise, qendrueshmerise dhe cilesise ku perfshihet kompesimi reaktiv nga Gjeneruesit, kontrolli fuqi-frekuence, nivelet e tensionit, mirembajtja dhe leshimi

i shpejte i disa njesive dhe kapaciteteve rezerve, si dhe sherbime te tjera te ketij lloji perfshihen ne Tarifat e Sherbimeve Ndhimese.

IV.7.11.1 Tarifa e Sherbimeve Ndhimese llogaritet sipas metodologjise se llogaritjes se tarifes se Sherbimeve Ndhimese te miratuar nga ERE.

IV.7.12 Mbulimi i humbjeve teknike te energjise elektrike ne Rrjetin e Transmetimit

IV.7.12.1 Shpenzimet per mbulimin e humbjeve teknike te energjise elektrike ne Rrjetin e Transmetimit perfshihen ne tarifen e Transmetimit. Tarifa e Transmetimit llogaritet sipas metodologjise se llogaritjes se tarifes se Transmetimit te miratuar nga ERE.

IV.7.13 Kerkimi i te Dhenave

IV.7.13.1 Perdoruesit do te paraqesin ne Qendren Dispeçer te dhena siç specifikohet ne kete Kod Rrjeti.

IV.8. Plani i Mbrojtjes dhe Rivendosjes

IV.8.1 Hyrje

IV.8.1.1 Ky paragraf pershkruan veprimet qe zbatohen nga OST dhe Perdoruesit per te realizuar sigurine, nepermjet planit te mbrojtjes dhe te rivendosjes se SEE.

IV.8.2 Objekti

IV.8.2.1 Objekti i ketij paragrafi eshte percaktimi i pergjegjesive te Perdoruesve per te parandaluar nje renie te pjeseshme ose te plote te SEE, ne rast te ndonje çrregullimi te madh, si dhe te percaktoje planin e rivendosjes se shpejte te SEE.

IV.8.2.2 Plani i Mbrojtjes dhe i Rivendosjes se SEE kerkon nje drejtim te koordinuar dhe pjesemarrjen e Paleve, per te parandaluar ngjarjet dhe kthimin ne kohe te furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve.

IV.8.2.3 Çdo pjesemaresi i kerkohet te ndjeke procedurat, me qellim qe te ndihmojne ne kthimin ne kohe te furnizimit me energji elektrike ne te gjithe rrjetin.

IV.8.3 Plani i Mbrojtjes

IV.8.3.1 Plani i Mbrojtjes hartohet dhe miratohet nga te gjitha Palet (OST dhe Perdoruesit) dhe pas miratimit eshte i detyrueshem te zbatohet nga te gjitha Palet. Plani i mbrojtjes perbehet nga:

- i. Struktura e Tarimeve te Mbrojtjes Rele ne gjithe elementet e Sistemit te Transmetimit.
- ii. Struktura e Tarimeve te Mbrojtjes Rele ne njesite Gjeneruese.

- iii. Struktura e Tarimeve te Mbrojtjes Rele ne sistemet/objektet e Kompanise Shperndarese dhe Konsumatoret e Kualifikuar.
 - iv. Automatika kunder avari ku perfshihen:
 - a) Shkarkimi Automatik i Ngarkesave nga Ulja e Frekuences (SHAF).
 - b) Shkarkimi Automatik i Njesive Gjeneruese nga Rritja e Frekuences (SHAG).
 - c) Shkarkimi Automatik nga Mbingarkesa ne elementet kryesor te Sistemit te Transmetimit.
 - d) Shkarkimi Automatik i Ngarkesave nga Ulja e Tensionit ne nyje te veçanta te Sistemit te Transmetimit.
 - e) Automatika e Ndarjes nga Ulja e Frekuences ne Sistemin e Transmetimit.
 - f) Automatika e Ndarjes nga Ulja e Frekuences ne linjat e interkonjeksionit
- IV.8.3.2 OST ne bashkepunim me Perdoruesit pergatit tabelen e Mbrojtjes Rele. Kjo strukture miratohet nga Komiteti i Mbrojtjes dhe Rivendosjes (KPMR):
- a) Ne kushtet e renies se frekuences si pasoje e **Deficitit te Fuqise Aktive** vepron SHAF i instaluar ne SEE ne koordinim te plote me kerkesat e vendeve te Rajonit. Per kete qellim eshte e zbatueshme struktura e SHAF me dy tipe sipas tabelës te paraqitur me poshte. Dy shkallet e para te SHAF-it tip-1 jane pa mbajtje kohe per veprim. Koha prej 0.2 sekonda perfaqeson kohen e nevojshme per veprimin e çelsit dhe te rele. Ne dy shkallet e tjera qe jane me mbajtje kohe, koha prej 0.5 sekonda perfshin edhe kohen e veprimit te çelsit.

Struktura e tarimit te SHAF

1) SHAF – 1			
Shkalla	2) Frekuenca	% e ngarkeses se stakuar	3) Koha e Veprimit
1	49.0 Hz	10%	0.2 sekonda
2	48.8 Hz	15%	0.2 sekonda
3	48.2 Hz	15%	0.5 sekonda
3	47.8 Hz	15%	0.5 sekonda

4) SHAF – 2						
Tipi i I Hz	Gradianti (Hz/sek.)	49.0 Hz	48.8 Hz	48.2 Hz	47.8 Hz	% e ngarkeses Total
		5) Sasia e Ngarkeses te Stakuar %				
49.0	-0.8	17.77%	7.17%	-	-	2.85
49.0	-1.0	22.65%	10.43%	15.93%	-	6.22
49.0	-1.7	-	12.80%	16.97%	25.90%	8.35
49.0	-2.0	-	10.43%	25.69%	39.70%	11.37
6) Total	-	40.42%	40.83%	58.60%	65.60%	28.8

Operatori i Sistemit te Shperndarjes, Konsumatoret e Kualifikuar detyrohen te instalojne ne sistemet/objektet e tyre rele frekuence dhe do te percaktojne sakte vleren e mundeshme te fuqise qe shkarkohet. Tarimet e releve te frekuences miratohen ne KPMR. OST do te instaloje per llogari te vete rele frekuence ne N/stacionet ne nivelin 110 kV

- b) Ne kushtet e Suficitit te Fuqise Aktive vepron Shkarkimi Automatik nga rritja e Frekuences (SHAG). Per kete arsye ne njesite gjeneruese vendosen rele frekuence. Tarimi i tyre perpilohet dhe miratohet nga KPMR. Per futjen ne pune sipas regjimit ditor dhe ngjarjes qe parashikohet, Qendra Dispecer urdheron njesite gjeneruese te vene ne pune SHAG e tyre. Gjeneruesit zbatojne kete urdher menjehere. Suficitet e fuqise aktive jane karakteristike e regjimeve me eksport te energjise elektrike. Ne HEC-et e Kaskades se Drinit duhet te instalohen paisje te Shkarkimit Automatik te Gjeneratoreve (SHAG) qe stakojne njesite gjeneruese ne rastet e rritjes se frekuences. SHAG vendoset ne pune vetem ne regjim eksporti, dhe vepron me kohen $t_v = 0.5$ sekonda sipas frekuencave te taruara, qe jepen me poshte.

Ne Vaun e Dejes SHAG duhet te instalohet ne tre shkalle me keto frekuenca veprimi:

Shkalla e pare $f = 52.0$ Hz

Shkalla e dyte $f = 52.2$ Hz

Shkalla e trete $f = 53.0 \text{ Hz}$

Ne Koman agregatet mund te vendosen ne SHAG ne shkallen e dyte dhe te trete (52.5 dhe 53 Hz).

Ne Fierze agregatet mund te vendosen ne SHAG vetem ne shkallen e dyte (52.5 Hz).

Ne regjime te tilla eksporti fuqia e vendosur per tu shkarkuar nga SHAG te jete sa me afer fuqise se llogaritur nga formula:

$$P_{SHAG} = 1.1 P_{E\text{exp.}} - 0.1 P_{S\text{ist.}}$$

- c) Ne kushtet kur elementet e Sistemit te Transmetimit mbingarkohen mbi nivelin normal te lejuar vepron Automatika e Shkarkimit te Mbingarkeses (SHAM). Objekti i automatikes se SHAM-it eshte stabilizimi i regjimit pas avari te Sistemi te Transmetimit. Duke pasur parasysh qe eshte e veshtire te percaktohet shkalla e amortizimit te linjave, transformatoreve, autotransformatoreve te Sistemit te Transmetimit, kjo automatike tenton qe ato te lehtesohen nga mbingarkesa e pa lejuara.
Per autotransformatoret dhe transformatoret pas veprimit te automatikes mund te lejohet nje nivel mbingarkimi deri ne 10% te fuqise nominale te tyre per nje kohe te caktuar. Per linjat e transmetimit pas veprimit te kesaj automatike lejohet nje mbingarkim deri ne 15 % te vleres se lejuar per nje kohe te caktuar. Koha e punes se elementeve ne mbingarkese percaktohet element per element nga KPMR. KPMR pergatit dhe miraton tabelen e vlerave te lejuara te linjave per sezonin dimer/vere. Pas veprimit te kesaj automatike Qendra Dispecer merr masat operative te mundeshme si: ndryshim te regjimit te skemave dhe synon ta zvogeloje sa me shpejt kete mbingarkese. Ne rast pamundesie te zvogelimit te mbingarkimeve te tyre me ndryshimin e skemave, Qendra Dispecer urdheron Perdoruesit per kufizime per uljen e ngarkesave te tyre.
- d) Ne kushtet e uljes se tensionit ne nyje te veçanta te Sistemit te Transmetimit vepron Automatika e Shkarkimit te Ngarkesave nga Ulja e Tensionit ne nyje te veçanta te Sistemit Transmetimit (SHAT). Objekti i kesaj automatike eshte stabilizimi i regjimit te SEE kur konstatohet ulje e konsiderueshme e nivelit te tensionit ne pikat e lidhjes me Perdoruesit. Per kete Kompania Shperndarese dhe Konsumatoret e Kualifikuar detyrohen te instalojne rele te tensionit minimal dhe te vendosin ne te gati per shkarkim ngarkesen e llogaritur. Pikat e vendosjes se SHAT, tarimet dhe sasia e fuqise qe shkarkohet hartohen dhe miratohen nga KPMR.
- e) Ne kushtet e renjes se frekuences ne zona te veçanta te SEE si rezultat i prishjes se balances se fuqise ngarkese-gjenerim vepron Automatika e Ndarjes nga Ulja e Frekuences ne Sistemin e Transmetimit. Objekti i kesaj automatike eshte ndarja nga SEE e zonave te veçanta ku prishet balanca ngarkese-gjenerim dhe frekuenca bie nen nje nivel te lejuar. Struktura e kesaj automatike, tarimet e saj dhe zonat ku do te instalohet hartohet dhe miratohet nga KPMR
- f) Ne kushtet kur frekuenca bie nen vleren e taruar ne relete e frekuences ne linjat e interkonjeksionit vepron Automatika e Ndarjes nga Ulja e Frekuences ne Linjat e Interkonjeksionit. Objekti i kesaj automatike eshte ndarja e SEE Shqiptar nga sistemet e vendeve fqinje me te cilet eshte i lidhur ne paralel per te mos lejuar perhapjen e çrregullimeve ne keto sisteme dhe anasjelltas.

Ndarja nga Interkoneksioni do te jete per frekuence $f = 48.7$ Hz dhe kohe veprimi $t = 0.5$ sekonda.

Ky tarim do te vendoset ne linjat e interkoneksionit ne marreveshje me vendet fqinje

IV.8.4 Plani i Rivendosjes

IV.8.4.1 Plani i Rivendosjes hartohet dhe miratohet nga KPMR.

IV.8.4.2 Plani i rivendosjes i SEE per renie te pjeseshme ose te plote te SEE zbatohet nga OST dhe gjithe Perdoruesit.

- IV.8.4.3 Qendra Dispeçer është përgjegjëse për ndjekjen në kohë të procedurave sipas planit të rivendosjes për rënie të pjesëshme ose totale të SEE. Kjo procedura dhe urdhera dokumentohen në librin dispeçer dhe pasqyrohen në një procesverbal.
- IV.8.4.4 OST në përgatitjen e Planit të Rivendosjes kërkon koordinimin e integruar edhe të Perdoruesve. Është veçanërisht e rëndësishme që kjo procedurë të pranojë nevojën për rivendosje në mënyrë të organizuar dhe efektive pa konsideruar problemet e mundshme të Gjeneruesve dhe pa konsideruar detyrimet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Konsumatorëve të Kualifikuar për zonat ku këta shërbejnë.
- IV.8.4.5 OST të jete përgjegjëse për stafin e Qendres Dispeçer që ai të jete i përgatitur në mënyrë të mjaftueshme dhe i trainuar për rivendosjen e SEE në përputhje me procedurat.
- IV.8.4.6 Perdoruesit do të jete përgjegjës për stafin e tyre që ai të jete i përgatitur në mënyrë të mjaftueshme dhe i trainuar për të zbatuar procedurat. Stafet operative të Perdoruesve ndjekin urdherat sipas procedurave të rivendosjes së urdheruara nga Qendra Dispeçer.
- IV.8.4.7 Qendra Dispeçer është përgjegjëse për drejtimin e përgjithshëm të procesit të rivendosjes në SEE përmes koordinimit me të gjithë Perdoruesit dhe Qendrat Dispeçer të Rajonit.
- IV.8.4.8 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Konsumatorët e Kualifikuar janë përgjegjës për sektorializimin e sistemeve të tyre në pjesë të veçanta dhe ndjekin urdherat e Qendres Dispeçer për sasine në MW që sinkronizojnë.
- IV.8.4.9 Gjeneruesit janë përgjegjës për nisjen e procedurave të tyre të planifikuara të startimit (black start) dhe me urdher nga Qendra Dispeçer realizojnë sinkronizimin e njesive të tyre gjeneruese.
- IV.8.4.10 Centralet Hidrike mbajnë Grupe Diesel në kushte të mira, në mënyrë që njesitë gjeneruese hidrike të startohen pa fuqi të jashtme nga Sistemi i Transmetimit.

IV.8.5 Procedurat e Ristartimit

- IV.8.5.1 Gjendja ekzistuese e ngjarjes, p.sh. disponibiliteti i njesive gjeneruese, linjave të transmetimit dhe nënstacioneve, i ngarkesës në teresi, përcaktojnë procesin që do të zbatohet në rast të një rënie të plote ose të pjesëshme të SEE.
- IV.8.5.1 Qendra Dispeçer Nacionale me Qendrat Dispeçer Rajonale koordinojnë veprimet për të përcaktuar shtrirjen e ngjarjes, pra për të përcaktuar llojin e rënies së sistemit (i pjesshem dhe në ç'pjesë, apo i plote).
- IV.8.5.1 Qendra Dispeçer Nacionale udhëzon të gjithë Perdoruesit për situatën dhe ndjek strategjinë e përshkruar me poshtë, bazuar në gjendjen pas ngjarjes.
- IV.8.5.1 Perdoruesit ndjekin e zbatojnë udhëzimet dhe urdherat e Qendres Dispeçer. Urdherat japën nepermjet kanaleve të komunikimit të kufizuara vetëm për veprimet operative.

IV.8.5.1 Renia e Plote SEE

- IV.8.5.1.1 Renia e plote e SEE mund te vije nga ngjarje te paparashikuara brenda ketij sistemi ose si pasoje e ngjarjeve te paparashikuara te Rajonit.
- IV.8.5.1.2 Qendra Dispeçer Nacionale percakton shkakun e renies se SEE: i brendshem apo i jashtem (nga sistemet e tjere).
- IV.8.5.1.3 Nese renia e plote vjen nga nje ngjarje e jashtme, Qendra Dispeçer Nacionale kryen procedurat e Ristartimit i ndare nga sistemet fqinje.
- IV.8.5.1.4 Nese renia ka shkak nje ngjarje te brendshme, Qendra Dispeçer Nacionale ne procesin e Rivendosjes, mund te marre ndihme edhe nga sistemet fqinje.
- IV.8.5.1.5 Qendra Dispeçer Nacionale urdheron te gjithë Perdoruesit perkates qe kane njesi gjeneruese me mundesi ristartimi te pavarur, te fillojne procedurat paraprake te leshimit te njesive gjeneruese (ne gjendje stand by).
- IV.8.5.1.6 Qendra Dispeçer Nacionale pergatit Sistemin e Transmetimit per rivendosje duke:
- i. Stakuar te gjitha ngarkesat vete dhe/ose ne koordimin me Kompanine Shperndarese dhe Konsumatoret e Kualifikuar;
 - ii. Krijuar ishuj fuqie pa interkoneksion ne transmetim;
 - iii. Marre informacion per njesite gjeneruese te gateshme per t'u sinkronizuar dhe per te marre ngarkese.
- IV.8.5.1.7 Qendra Dispeçer Nacionale ben sinkronizimin e njesive gjeneruese ne Rrjetin e Transmetimit duke ruajtur gjithmone balancen gjenerim-ngarkese ne ishuj te veçante fuqie.
- IV.8.5.1.8 Me pas Qendra Dispeçer Nacionale zgjeron ishujt e fuqise duke shtuar njesi gjeneruese dhe njekohesisht ngarkese, qe te mbaje gjithmone balancen gjenerim-ngarkese. Me pas behet sinkronizimi i ishujve te krijuar nga Qendra Dispeçer Nacionale, duke shtrire gradualisht sinkronizimin deri ne rivendosje te plote.
- IV.8.5.1.9 Me pas Qendra Dispeçer Nacionale ne koordimin me Qendrat Dispeçer Rajonale, ben sinkronizimin me vendet fqinje duke sinkronizuar linjat e interkoneksionit nje nga nje.

IV.8.5.2 Renia e Pjeseshme e SEE

- IV.8.5.2.1 Renia e pjeseshme e SEE eshte atehere kur nje pjese ose disa pjese te tij ndahen elektrikisht midis tyre dhe/ose konsumatoret ne nje pjese te veçante te sistemit nuk furnizohen me energji elektrike
- IV.8.5.2.2 Qendra Dispeçer Nacionale kontrollon e garanton sigurine e pjeses se shendoshe te SEE.
- IV.8.5.2.3 Qendra Dispeçer Nacionale vlereson ngjarjen dhe disponibilitetin e njesive gjeneruese, te linjave dhe nenstacioneve te Transmetimit.

IV.8.5.2.4 Qendra Dispeçer Nacionale zgjeron gradualisht sistemin e shendoshe duke startuar njësi gjeneruese dhe kyçur ngarkese, dhe duke ruajtur balancen gjenerim-ngarkese, ne koordimin me Perdoruesit.

IV.8.5.3 **Konsiderata Speciale**

IV.8.5.3.1 Gjate ndjekjes se procesit te rivendosjes, ne kushtet e renies se SEE, nuk duhen kerkuar standartet per frekuencen dhe nivelet e tensionit.

IV.8.5.3.2 Gjate procesit te rivendosjes prioritet i jepet ngarkesave te rendesishme per sektorin jetik, te cilat do te duhet te jene te identifikuara nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoret e Kualifikuar. Ngarkesat e tjera do te marrin energji elektrike, kur SEE te jete kthyer gradualisht ne gjendje normale.

IV.8.5.3.3 Pavaresisht nga urgjenca e situates, pasi te rivendoset gjendja, Qendra Dispeçer Nacionale dhe gjithë Perdoruesit, pergatisin nje dokument mbi urdherat dhe veprimet operative te kryera, per te ndihmuar investigimin pasues te ngjarjes, si dhe efikasitetin e procesit te rivendosjes.

IV.8.5.3.4 Diten tjeter pas ngjarjes, perpilohet nje raport i plote mbi ngjarjen dhe procesin e rivendosjes dhe u vihet ne dispozicion Komisionit te Rishikimit te Kodit dhe KPMR.

IV.9 **Bashkepunimi me Organizmat Rajonale dhe Europiane te Energjise Elektrike**

IV.9.1 Drejtori i OST do te perfaqesoje OST ne te gjitha çeshtjet qe kane lidhje me Sistemin e Transmetimit ne Shqiperi.

IV.9.2 OST koordinon me Vendet e Rajonit per:

- i. Planifikimin e nderprerjeve te linjave te interkoneksionit per permiresimin e funksionimit te Sistemit te Transmetimit ne koordimin me sistemet fqinje
- ii. Programet e Planifikimit te Sistemit te Transmetimit
- iii. Bashkeveprimin me Qendrat Dispeçer Rajonale, ne situata emergjente
- iv. Koordinimin e iniciativave midis Operatoreve te Sistemeve te Transmetimit te Rajonit.

IV.10 **Komiteti i Planit te Mbrojtjes dhe Rivendosjes (KPMR)**

IV.10.1 KPMR perbehet si me poshte:

- i. Kryetari caktohet nga OST
- ii. Sekretari caktohet nga OST
- iii. Nje specialist i Mbrojtjes Rele per Centralet Gjenerues Hidrik
- iv. Nje specialist i Mbrojtjes Rele per Centralet Gjenerues Termik
- v. Nje specialist i Mbrojtjes Rele nga Kompania Shperndarese

- vi. Nje specialist i Mbrojtjes Rele, i cili perfaqeson te gjithë Impiantet e Pavarur Gjenerues
- vii. Nje specialist i Mbrojtjes Rele, i cili perfaqeson te gjithë Klientet e Kualifikuar
- viii. Nje specialist i Mbrojtjes Rele, i cili perfaqeson te gjithë Furnizuesit
- IV.10.2 KPMR do te mbaje takime te zakonshme te pakten nje here ne tre muaj dhe gjithashtu pas çdo ngjarje te madhe ne SEE.
- IV.10.3 **Gjate takimeve te zakonshme** te punes analizohen e diskutohen shkaqet dhe masat per permiresimin e Planit te Mbrojtjes dhe Rivendosjes nepermjet modifikimit te skemave dhe tarimeve te Mbrojtjes dhe te Automatikes Kunder Avari.
- IV.10.4 **Gjate takimeve te veçanta** mbas nje ngjarje te madhe, KPMR analizon e diskuton shkaqet dhe masat per permiresimin e Planit te Mbrojtjes dhe Rivendosjes nepermjet modifikimit te skemave dhe tarimeve te Mbrojtjes dhe te Automatikes Kunder Avari, vetem per ngjarjen.
- IV.10.5 KPMR mund te propozoje mbas çdo takimi rishikimin e mundshem te Kodit te Rrjetit dhe kete propozim bashke me rekomandimet, ja paraqet Komisionit te Rishikimit te Kodit te Rrjetit.
- IV.10.6 Vendimet e KPMR merren me konsensus. Ne rast te mos arritjes se konsensusit vendimet merren me shumice te thjeshte te pjesemaresve ne takim, por me kushtin qe OST te kete te drejten e vetos ne vendimmarrje, e aresyetuar nga fakti i rendesise qe ka ne tregun kombetar dhe nderkombetar te energjise elektrike.
- IV.10.7 KPMR mblidhet me perfaqesuesit e mesiperem, por mund te kerkoje perfaqesues e konsulente te tjere te sektoreve perkates, per te marre pjese ne takime pa te drejte vote.
- IV.10.8 Kryetari i KPMR merr pjese ne te gjitha takimet e Komisionit te Rishikimit te Kodit, nese diskutohen çeshtje te Planit te Mbrojtjes Rele dhe Rivendosjes.
- IV.11 Pergjegjesite e Paleve per Lejimin Reciprok ne Pronesite Perkatese**
- IV.11.1 Hyrje**
- IV.11.1.1 Ky paragraf paraqet pergjegjesite e OST dhe Perdoruesve per lejimin reciprok ne pronesite perkatese. Ai formulon procedurat kur kerkohet te punohet ne paisjet elektrike te instaluar ne pronesine e Paleve reciproke.
- IV.11.1.2 Ky paragraf ka lidhje me nga faktin qe midis OST dhe Perdoruesve ekzistojne nderfaqesime te tilla, qe paisjet elektrike te njeres Pale jane te instaluar ne pronesine e Pales tjeter. (p.s.h. paisjet e matjes, e telekomunikacionit, SCADA, e kablllove te fuqise, etj.

IV.11.2 Objekti

IV.11.2.1 Objekti i ketij paragrafi eshte te arrije nje marreveshje ne perputhje me principet e sigurise dhe Rregullat e Sigurimit Teknik, si dhe te punes reciproke pertej kufirit pronesor te OST dhe Perdoruesve.

IV.11.3 Procedurat**IV.11.3.1 Te Pergjitheshme**

IV.11.3.1.1 OST dhe Perdoruesit percaktojne me marreveshje te vecanta nje liste te paisjeve elektrike pronesi e njeres Pale, te instaluar ne pronesine e Pales tjetere. Ne kete marreveshje bashkangjiten planimetritet e pronesise sipas pershkrimimit ne Kodin e Lidhjes, se bashku me rruget e kalimit.

IV.11.3.1.2 OST dhe Perdoruesit percaktojne nje liste personash te autorizuar per te hyre dhe kryer punime ne pronesite reciproke.

IV.11.3.1.3 Perdoruesit jane pergjegjes per sigurine dhe Sigurimin Teknik te punes normale ne pronesite e tyre, deri ne plotesimin e kushteve per kryerjen e punimeve.

IV.11.3.1.4 OST dhe Perdoruesit bien dakord qe çdo punim ne pronesine tjetere te autorizohet nepermjet nje urdhri pune te firmosur nga titullaret. Urdhri i punes do te permbaje paisjen/grup paisjesh, mbi te cilat do te kryhen punime, personat e autorizuar, kohezgjatjen, si dhe ne se shoqerohet me nderprerje te konsumatoreve. Te percaktohet kufizimi i furnizimit me energji elektrike.

IV.11.3.1.5 Puna e kryer mbi paisjet/grup paisjesh konsiderohet e mbaruar, kur sherbimet e kryera mbi te dhe masat e sigurise jane konform normave dhe rregullave ne fuqi. Vetem mbas kesaj keto paisje/grup paisjesh vihen ne pune.

IV.11.3.1.6 Me perfundimin e punimeve mbahet nje proces-verbal i firmosur nga personat e autorizuar, duke pershkruar punimin e bere, kohezgjatjen, masat e sigurise te marra dhe perfundimin e punimeve, si dhe çdo verejtje qe kane Palet perkatese.

IV.11.3.1.6 OST jep urdherin e punes pas miratimit ne Qendren Dispeçer Nacionale. Perdoruesit kerkojne miratimin nga OST, e cila nga ana e vet merr miratim nga Qendra Dispeçer Nacionale.

IV.11.3.2 Respektimi i Rregullave te Sigurimit Teknik ne Vendin e Punes

IV.11.3.2.1 Palet detyrohen te zbatojne Rregullat e Sigurimit Teknik ne vendin e punes dhe sigurojne kushte reciproke ne zbatim te Rregullores se Sigurimit Teknik.

IV.12 Kontrolli, Mbikqyrja, Testimi**IV.12.1 Hyrje**

IV.12.1.1 Aktivitetet e kontrollit, mbikqyrjes dhe testimit, duhet te kryhen ne perputhje me procedurat per:

- i. Kontrollin dhe mbikqyrjen e te gjithë Perdoruesve (Njesite Gjeneruese, Operatorin e Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatorët e Kualifikuar), per te verifikuar parametrat e operimit.
- ii. Testimin e njesive gjeneruese per te verifikuar perpuethshmerine e parametrave dhe sistemeve teknologjike te tyre ne perputhje me deklaratat e tyre.
- iii. Testimin e sistemeve/objekteve te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar, per te verifikuar perpuethshmerine e parametrave dhe sistemeve teknologjike te tyre ne perputhje me deklaratat e tyre.

IV.12.2 Qellimi dhe Zona e Aplikimit

IV.12.2.1 Qellimi i ketij paragrafi eshte te shqyrtoje nese:

- i. Njesite gjeneruese te Gjeneruesit operojne ne perputhje me parametrat teknike te deklaruar, si dhe te gadishmerise se tyre.
- ii. Sistemet/objektet e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar operojne ne perputhje me parametrat teknike te deklaruar, si dhe te gadishmerise se tyre.

IV.12.3 Arsyet

IV.12.3.1 Veprimet e kontrollit, mbikqyrjes dhe testimit kryhen nga OST kur:

- i. Njesite Gjeneruese gjate operimit operojne me parametra jashte atyre te deklaruar.
- ii. Sistemet/objektet e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Konsumatoreve te Kualifikuar gjate operimit operojne me parametra jashte atyre te deklaruar.
- iii. Nje Perdorues i Rrjetit te Transmetimit nuk ndjek udhezimet e Qendres Dispeçer Nacionale, ose deshton ne zbatimin e urdherave te saj.

IV.12.4 Testimi i Aftesive per t'ju pergjigjur kerkesave te OST

IV.12.4.1 Testimi i kapacitetit te gjenerimit dhe absorbimit te fuqise reaktive

IV.12.4.1.1 OST mund te kerkoje testimin e Njesive Gjeneruese nje here ne vit, me qellim qe te evidentojte nese Njesia Gjeneruese respekton aftesine gjenerim/absorbim te fuqise reaktive.

IV.12.4.1.2 Testimi kerkohet nga OST dhe periudha e realizimit te tij miratohet nga Qendra Dispeçer Nacionale.

IV.12.4.1.3 OST duhet te njoftoje Gjeneruesin per qellimin e testimit, 48 ore perpara.

IV.12.4.1.4 Neqoftese nga testi i Njesise Gjeneruese rezulton qe parametrat e testuar nuk i pergjigjen parametrave te deklaruar, atehere Gjeneruesi duhet te pergatise per OST brenda 5 diteve, nje raport te detajuar, duke specifikuar arsytet dhe masat qe duhen marre.

IV.12.4.1.5 Nese devijimet jane te medha dhe te pakorigjueshme, propozohet rishikimi i marreveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

IV.12.4.2 Testimi i aftesise per Rezeven Primare dhe Sekondare

- IV.12.4.2.1 Testimi i aftesise per te vene ne dispozicion Rezerven Primare dhe Sekondare kryhet ne menyre te detyrueshme nga OST.
- IV.12.4.2.2 Ky testim kryhet ne menyre periodike nga Qendra Dispeçer Nacionale nepermjet SCADA, ne korrelacion me veprimtarine e kontrollit dhe mbikqyrjes per operimin e Njesive Gjeneruese.
- IV.12.4.2.3 OST duhet te njoftoje Gjeneruesin per qelimin e testimit 48 ore perpara.
- IV.12.4.2.4 Neqoftese nga testi i Njesise Gjeneruese rezulton qe parametrat e testuar nuk i pergjigjen parametrave te deklaruar, atehere Gjeneruesi duhet te pergatise per OST brenda 5 diteve, nje raport te detajuar, duke specifikuar aresyet dhe masat qe duhen marre.
- IV.12.4.2.5 Nese devijimet jane te medha dhe te pakorigjueshme, propozohet rishikimi i marreveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

IV.12.5 Testimi i Aftesive te Startimit te Njesise Gjeneruese

- IV.12.5.1 Testimi i aftesise se startimit te Njesive Gjeneruese behet ne menyre te detyrueshme nje here ne vit, per çdo njesi gjeneruese te Gjeneruesit, me qellim qe te evidentoje nese Njesia Gjeneruese respekton aftesine e startimit te shpejte sipas parametrave te deklaruar.
- IV.12.5.1 Testimi kerkohet nga OST pas miratimit nga Qendra Dispeçer Nacionale, vetem gjate kohes ne te cilen Njesia Gjeneruese eshte deklaruar ne gjendje gadishmerie.
- IV.12.5.1 OST duhet te njoftoje Gjeneruesin per qelimin e testimit, 48 ore perpara.
- IV.12.5.1 Neqoftese nga testi i Njesise Gjeneruese rezulton qe parametrat e testuar nuk i pergjigjen parametrave te deklaruar, atehere Gjeneruesi duhet te pergatise per OST brenda 5 diteve, nje raport te detajuar, duke specifikuar aresyet dhe masat qe duhen marre.
- IV.12.5.1 Nese devijimet jane te medha dhe te pakorigjueshme, propozohet rishikimi i marreveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

IV.12.6 Testimi i Aftesive per Pjesemarrje ne Rivendosjen e SEE

- IV.12.6.1 OST i kerkon testim Njesive Gjeneruese listuar ne Planin e Rivendosjes se SEE, pas nje avarie. Testimi behet nje here ne vit me qellim evidentimin e faktit nese Njesia Gjeneruese ka mundesine e startimit konform kerkesave te Planit te Rivendosjes se SEE.
- IV.12.6.2 Testimi mund te kryhet ne nje nga mundesite e meposhtme:
 - i. Startimin e njesive gjeneruese nga nje burim i pavarur ne central (p.sh. Grup Diesel)
 - ii. Startimin e njesive gjeneruese nga nevojat vetiake te centralit.
- IV.12.6.3 OST duhet te njoftoje Gjeneruesin per qelimin e testimit, 7 dite perpara.
- IV.12.6.4 Neqoftese nga testi i Njesise Gjeneruese rezulton qe parametrat e testuar nuk i pergjigjen parametrave te deklaruar, atehere Gjeneruesi duhet te pergatise per OST

brenda 5 diteve, nje raport te detajuar, duke specifikuar aresyet dhe masat qe duhen marre.

IV.12.6.5 Nese devijimet jane te medha dhe te pakorigjueshme, propozohet rishikimi i marreveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

IV.12.7 Testimi i Gadishmerise se Deklaruar

IV.12.7.1 Me kerkesen e OST Njesite Gjeneruese duhet te testohen per gadishmerine konform kerkesave te ketij Kodi Rrjeti.

IV.12.8 Testimi i Parametrave te Deklaruar

IV.12.8.1 OST mund te kerkoje çdo vit testimin e Njesive Gjeneruese me qellim qe te evidentohet nese Njesia Gjeneruese ka ne te vertet karakteristikat teknike te deklaruar.

IV.12.8.2 Testimi kerkohet nga OST pas miratimit nga Qendra Dispeçer Nacionale, vetem gjate kohes ne te cilen Njesia Gjeneruese eshte deklaruar ne gjendje gadishmerie.

IV.12.8.3 OST duhet te njoftoje Gjeneruesin per qellimin e testimit, 48 ore perpara.

IV.12.8.4 Neqoftese nga testi i Njesise Gjeneruese rezulton qe parametrat e testuar nuk i pergjigjen parametrave te deklaruar, atehere Gjeneruesi duhet te pergatise per OST brenda 5 diteve, nje raport te detajuar, duke specifikuar aresyet dhe masat qe duhen marre.

IV.12.8.5 Nese devijimet jane te medha dhe te pakorigjueshme, propozohet rishikimi i marreveshjes midis OST dhe Gjeneruesit.

IV.13. Koordinimi i Veprimeve Operative

IV.13.1 Hyrje

IV.13.1.1 Koordinimi i Veprimeve Operative eshte i nevojshem per shkembimin e informacionit ne lidhje me veprimet operative dhe/ose ngjarjet ne te gjithe SEE qe kane ndikim ne funksionimin e:

- i. Sistemit te Transmetimit ne rast se veprimet operative dhe/ose ngjarja ndodhin ne nje sistem/objekt te Perdoruesit
- ii. Nje sistem/objekt te Perdoruesit ne rast se veprimet operative dhe/ose ngjarja ndodhin ne Sistemin e Transmetimit.

IV.13.2 Objekti

IV.13.2.1 Objekti i ketij paragrafi eshte specifikimi i informacionit qe do te shkembet ndermjet Qendres Dispeçer Nacionale dhe Perdoruesit per te identifikuar ndikimet reciproke nga veprimet operative dhe/ose ngjarjet, te vleresuara te mundeshme per rrezik.

IV.13.3 Percaktimet

- IV.13.3.1 **Veprim Operativ** do te thote çdo veprim i programuar qe ndikon ne lidhje me funksionimin e SEE.
- IV.13.3.2 **Ngjarje** do te thote nje ndodhi e paplanifikuar ne SEE ku futen defektet, incidentet dhe reniet e SEE.
- IV.13.3.3 **Ndikim i Veprimit Operativ** do te kuptojme çdo ndikim ne funksionimin e SEE pas nje veprimi operativ, i cili mund te shkaktoje qe Sistemi i Transmetimit ose sistemi/objektet e Perdoruesit te funksionojne ndryshe nga funksionimi i tyre ne mungese te ketij veprimi operativ.

IV.13.4 Njoftimi i Veprimeve Operative

- IV.13.4.1 Njoftimet e Qendres Dispeçer Nacionale te OST dhe Perdoruesve behen si me poshte:
- i. **Qendra Dispeçer Nacionale e OST:** Ne rast se ndonje veprim operativ ose ngjarje e paplanifikuar ne Sistemin e Transmetimit mund te kete ndikim ne punen e nje sistem/objekt te Perdoruesit, Qendra Dispeçer njofton Perdoruesit nese ne gjykimin e Qendres Dispeçer veprimi ka ndikim sipas specifikimeve te ketij paragrafi.
 - ii. **Perdoruesi:** Ne rast se ndonje veprim operativ ose ngjarje e paplanifikuar ne sistem/objektin e Perdoruesit mund te kete ndikim ne punen e Sistemit te Transmetimit, Perdoruesi njofton Qendren Dispeçer te OST, e cila nga ana e saj njofton Perdoruesit e tjere nese ne gjykimin e Qendres Dispeçer veprimi ka ndikim sipas specifikimeve te ketij paragrafi.

IV.13.5 Natyra e Njoftimit te Veprimeve Operative

- IV.13.5.1 Njoftimi per veprimet operative duhet te permbaje qellimin dhe detajet e mjaftueshme per te pershkruar veprimin operativ.
- IV.13.5.2 Disa shembuj ilustrues te situatave kur kerkohet nje njoftim i nje veprimi operativ dhe ndikimet e ketij veprimi operativ janesi me poshte:
- i. Impianti dhe/ose aparaturat jane duke funksionuar jashte mundesive te tyre ose mund te paraqesin rrezik per personelin;
 - ii. Stakim te impiantit dhe/ose aparaturave manuale ose automatike;
 - iii. Nivelet e tensionit jane jashte standarteve;
 - iv. Nivelet e frekuences jane jashte standarteve;
 - v. Lekundje te pastabilizuara ne SEE te elementeve te tij;
 - vi. Aktivizimi i ndonje alarmi ose treguesi te ndonje kushti funksionimi jonormal;

- vii. Nese nga eksperiencia vihen re ose parashikohen kushte te pafavoreshme, difekte ne paisjet e kontrollit, komunikimit ose te matjes;
- viii. Rritja e rreziqeve te veprimeve te mbrojtjes rele;
- ix. Mosfunksionimi i paisjeve komutuese;
- x. Rrezik nga zjarri, etj

Keto shembuj jane ilustrues, por nuk kufizohen vetem ne to

IV.14 Raportimi i Ngjarjes

IV.14.1 Hyrje

- IV.14.1.1 Ky paragraf pershkruan kerkesat per raportimin me shkrim te ngjarjeve, te cilat fillimisht ishin raportuar me goje, midis OST dhe Perdoruesve.
- IV.14.1.2 Ngjarja mund te pasohet me incident, ne rastin kur ndikimi i ngjarjes mbi Sistemin e Transmetimit apo mbi sistem/objektet e Perdoruesve eshte me pasoja jo te desherueshme.
- IV.14.1.3 Ngjarjet qe ndodhin ne nje sistem/objekt te Perdoruesit raportohen ne OST dhe ne Perdoruesit e tjere te ndikuar. Ngjarjet qe ndodhin ne Sistemin e Transmetimit raportohen nga OST tek Perdoruesit e ndikuar.

IV.14.2 Objekti

- IV.14.2.1 Objekti i ketij paragrafi eshte te percaktoje ngjarjet qe duhen raportuar, rruget e raportimit qe do te ndiqen dhe informacioni qe do te jepet.

IV.14.3 Ngjarjet qe Raportohen

- IV.14.3.1 Shembuj tipik te ngjarjeve me incident qe raportohen jepen me poshte:
 - i. Ngritje ose ulje te konsiderueshme te frekuences dhe nivelit te tensionit ne SEE.
 - ii. Probleme me rrezik ne paisjet kryesore si: linja, transformatore, paisje komutimi, zbara.
 - iii. Ngjarje me incident me renie zjarri.
 - iv. Shkelje e standarteve te sigurise dhe rregullave te Sigurimit Teknik, etj.Keto shembuj jane ilustrues, por nuk kufizohen vetem ne to.

IV.14.4 Procedura e Raportimit

- IV.14.4.1 Te gjitha ngjarjet qe shoqerohen me incident ne Sistemin e Transmetimit ose sistem/objektin e Perdoruesit raportohen.

- IV.14.4.2 Raportimi operativ behet gjithmone midis stafit operativ te Qendres Dispeçer Nacionale dhe stafit operativ te Perdoruesit ne kohen qe ndodh ngjarja. Keto raporte dokumentohen ne librat operative.
- IV.14.4.3 Nese ngjarja me incident e raportuar klasifikohet jo e vogel, stafi operativ i Qendres Dispeçer Nacionale si dhe stafi operativ i Perdoruesit, lene raport me shkrim ne fund te turnit te tyre.
- IV.14.4.4 OST dhe Perdoruesit per ngjarje me incidente te tilla pergatisin raport te hollesishem brenda 5 diteve.

IV.14.5 Forma e Raportimit

- IV.14.5.1 Forma standarte e raportimit jepet ne Shtojcen D.
- IV.14.5.1 Forma e raportimit eshte objekt i rishikimit nga komisioni i Rishikimit te Kodit. OST dhe Perdoruesit bashkepunojne per te analizuar dhe investiguar shkakun e ngjarjes, ngjarjen dhe pasojat pas ngjarjes. Investigimi tek Perdoruesit behet nga OST. OST ka te drejte te inspektoje çdo paisje te Perdoruesit sipas procedurave te treguara ne Shtojcen E.

IV.14.6 Raportimi i Aksidentit

- IV.14.6.1 Nese ngjarja shoqerohet me aksidente, raportimi i aksidentit behet sipas Legjislacionit ne fuqi.
- IV.14.6.2 Ky raportim behet ne te dy rastet: kur eshte fatal ose jo fatal me demtime serioze. Raporti dergohet edhe ne inspektoriatin ose organet perkatese konform ligjistacionit ne fuqi.

Shtojca D – Raportimi i Ngjarjes me Incident

NUMRI I RAPORTIMIT.....

Vendi

Data.....

Ora.....

Data dhe ora e ngjarjes me incident:.....

Vendi i ngjarjes me incident:.....

Tipi i ngjarjes me incident:.....

Parametrat e SEE para ngjarjes me Incident:.....

Parametrat e SEE pas ngjarjes me incident:.....

Parametrat dhe Konfiguracioni i Rrjetit para ngjarjes me incident:.....

Tregimet e Mbrojtjeve Rele dhe sjellja e tyre:.....

Paisjet e demtuara:.....

Veprimet operative riparuese te marra:.....

Nderprerja e Furnizimit dhe kohezgjatja:.....

Shkaku i ngjarjes me incident:.....

Rekomandimet per permiresime ne te ardhmen, ne rast perseritje te

ngjarjes me incident:.....

Emrat dhe Firmat e Stafit Pergjegjes Operues***(.....)***

Shtojca E - Investigimi i Ngjarjes me Incident

Qellimi i nje investigimi eshte ti beje te mundur OST te perftoje informacionin ne lidhje me paisjet dhe procedurat operative.

OST per te arsyetuar dhe dhene konkluzion mbi incidentin, dergon perfaqesues tek Perdoruesi, per te investiguar procedurat operative te perdorura, duke perfshire por pa u kufizuar ne investigimin e:

- i. Zbatimit te urdherave te leshuara nga Qendra Dispeçer Nacionale
- ii. Pajtuemshmerise se veprimeve operative te Perdoruesit me urdherat operative te leshuara nga Qendra Dispeçer Nacionale.

Investigimi mund te mbeshtetet vetem ne çeshtjet operative te SEE, por nese eshte e nevojshme dhe e domosdoshme, investigimi mund te shtrihet ne kohe dhe analize duke pare edhe elemente te tjere, nepermjet shfrytezimit te paisjeve regjistruese.

Perdoruesit duhet te lejojne perfaqesuesit e OST dhe duhet te furnizojne ata me te gjitha dokumentat e perkatese.

Procedura e investigimit percaktohet nga OST, e cila vepron ne menyre te arsyeshme dhe perfaqesuesit te saj te kene dijeni te plote mbi Perdoruesit.

Shtojca F - Ngarkesat me Prioritet ne Procesin e Rivendosjes

Tipi i Ngarkeses

Ngarkesa (MW)

Emri i Nenstacionit

Tipet e ngarkesave jane:

1. Minierat
2. Stacionet Hekurudhor
3. Portet dhe Ngarkesat Industriale te Rendesishme
4. Qytetet e Rendesishme
5. Spitalet, Ujesjellesat, Stacionet TV dhe Radiot
6. Industrite me proces teknologjik panderprere
7. Institucionet e Mbrojtjes

Megjithate, lista e prioriteve te procesit te rivendosjes, do te percaktohet edhe nga marreveshja e OSSH me OST.

V. KODI I RRJETIT – KODI I LIDHJES**V.1 Hyrje**

V.1.0.1 **Kodi i Lidhjes** specifikon kushtet, kriteret dhe afatet kohore qe duhet te plotesojne Perdoruesit per tu lidhur me Sistemin e Transmetimit, ose per te modifikuar lidhjet e tyre ekzistuese.

V.2 Procedura e Aplikimit per Lidhje

V.2.0.1 Çdo Perdorues qe kerkon te vendose marreveshje te reja ose te modifikoje marreveshjet egzistuese, te Lidhjes ne dhe/ose perdorimin e Sistemit te Transmetimit, duhet te ndjeke procedurat e vendosura ne kete Kod Rrjeti.

V.2.0.2 OST do te ndjeke procedurat dhe kufijte e kohes te specifikuara ne kete Kod ne procesin e aplikimit, modifikimit, pranimit ose mos pranimit te nje kerkese.

V.2.1 Vendi Optimal i Lidhjes

V.2.1.1 OST do te miratoje çdo vend lidhje qe teknikisht eshte optimal ku Perdoruesit mund te lidhin sistemet/objektet e tyre me Sistemin e Transmetimit.

V.2.2 Te Dhena nga OST

V.2.2.1 Çdo Perdorues i perspektives ose egzistues qe deshiron te ndryshoje kapacitetin e tij, pas studimeve te planifikimit te publikuar nga OST mund t'i kerkoje OST me shume informacion.

V.2.2.2 OST do te jap te dhenat e kerkuara brenda 30 diteve pas kerkeses.

V.2.2.3 OST mund te refuzoje te jape te dhena nese i konsideron ato konfidenciale/te panevojshme dhe nuk kerkohen per ushrimin e aktivitetit te Perdoruesve.

V.2.2.4 OST vendos tarifa te arsyeshme per koston e dhenies se te dhenave.

V.2.3 Aplikimi per Lidhje

V.2.3.1 Çdo Perdorues qe kerkon te perdore Sistemin e Transmetimit mund te parashtroje nje Aplikim per Lidhje ne OST ne formatin e hartuar nga OST.

V.2.4 Pranimi ose Refuzimi i Aplikimit per Lidhje

V.2.4.1 OST pranon ose refuzon Aplikimin brenda 60 diteve nga data e Aplikimit. Nese refuzohet, OST komunikon arsyet.

V.2.4.2 Nese OST kerkon te dhena shtese nga Aplikanti, data e fundit per pranim ose refuzim mund te shtyhet edhe 30 dite te tjera nga data e paraqitjes te te dhenave shtese.

V.2.4.2 Te dhenat shtese i jepen OST brenda 20 diteve nga dita e kerkeses. Nese informacioni shtese nuk merret nga OST brenda 20 diteve, OST mund te refuzoje kerkesen per Lidhje.

V.2.5 Shkembimi i te Dhenave

V.2.5.1 Shkembimi i te dhenave ndermjet OST dhe Perdoruesve duhet te jete ne pajtueshmeri me klauzolat e Kodit te Rrjetit.

V.2.6 Ofertat e Papranuara

V.2.6.1 Ne rast se oferte nuk pranohet nga Perdoruesi brenda periudhes se vlefshmerise, asnje veprim i metejshem nuk do te merret nga OST ne Aplikimet per Lidhje.

V.2.6.1 Periudha e vlefshmerise percaktohet ne studimin tekniko-ekonomik te paraqitur nga Perdoruesi dhe te miratuar ne Marreveshjen e Lidhjes.

V.3 Kushtet e Lidhjes

IV.3.1 Hyrje

V.3.1.1 Ky paragraf paraqet kushtet qe duhet te plotesohen nga Perdoruesit qe te mund te shfrytetoje Rrjetin e Transmetimit.

V.3.2 Objektivi

V.3.2.1 Qellimi i ketij paragrafi eshte qe te permbushe objektivat e meposhtme:

- i. Gjithe Perdoruesit ekzistues ose ata te Perspektives trajtohen ne menyre te barabarte.
- ii. Çdo Lidhje e Re nuk duhet te shkaktoje ndonje efekt negativ ne Perdoruesit egzistues, ose nje Lidhje e Re nuk duhet te ndikohet nga efektet negative te Perdoruesve egzistues.
- iii. Te ndihmoje Perdoruesit qe te zbatojne detyrimet e Licensave dhe te sigurojne operim dhe mirembajtje me cilesi te larte te sistemit/objektit te tyre.
- iv. Te specifikojte qarte dhe ne nje format standart, detyrimet dhe pergjegjesite per te gjithë sistemet/objektet, per çdo vend ku behet/modifikohet nje Lidhje.

V.3.2.2 OST ka detyrim te siguroje akses te rregulluar per te gjithë Perdoruesit e Rrjetit te Transmetimit.

V.3.2.3 Aplikuesi qe kerkon marrjen e lejes duhet te siguroje kete informacion:

- i. Te dhena per fushen e tij te aktivitetit dhe adresen (emri, adresa, telefoni, fakti, e-mail),

- ii. Te jepet Sistemi/Objekti qe do te lidhet, (njesi gjenerimi e energjise elektrike, sistem/objekt i shperndarjes, sistem/objekte qe lidhin konsumatore te ndryshem), duke perfshire edhe vendin e Lidhjes,
- iii. Deklarate e shkruar mbi gadishmerine per te zbatuar Kodin e Rrjetit
- iv. Listen e dokumenteve, bashkangjitur me aplikimin per Lidhje te Re.

V.3.3 Dokumentacioni i cili duhet ti bashkangjitet Aplikimit per Lidhje

V.3.3.1 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- i. Studimin e Lidhjes se Njesive Gjeneruese:Te dhenat per planifikim te parashtruara ne Kod.
- ii. Studimin e Lidhjes se Operatorit te Sistemit te Shperndarjese qe do te bejne lidhjen e sistemit/objektit te tyre: Te dhenat per planifikim te parashtruara ne Kod.
- iii. Studimin e Lidhjes se sistemit/objektit te Konsumatorit te Kualifikuar: Te dhena per planifikim te parashtruara ne Kod.
- iv. Te dhena per pajisjet qe gjenerojne/observojne fuqi reaktive.
- v. Propozimi i dhene me fazat perkatese sipas studimit tekniko-ekonomik per realizimin e treguesve te projektit: (projektimi, implementimi, testimi dhe komisionimi).

V.3.3.2 Per miratimin e Lejes se Pranueshmerise Teknike per Lidhje, OST analizon:

- i. OST kontrollon te dhenat teknike per te gjitha llojet e instalimeve kur kerkesa per Lidhje e aplikuesve eshte protokolluar.
- ii. Mundesine per shfrytezimin e Kapacitetit te Transmetimit.
- iii. Nese nuk ekziston kjo mundesi, Aplikanti detyrohet te marre masa teknike e financiare deri ne mbulimin e plote te investimit brenda kushteve teknike te sigurise te specifikuara ne kete Kod,
- iv. Mundesite teknike per Lidhje,
- v. Zgjedhjen e Lidhjes se Re ne vendin perkates, duke e analizuar nga keto pikepamje:
 - (a) Nivelin e sigurise se furnizimit,
 - (b) Qendrushmerise statike dhe dinamike te SEE,
 - (c) Nivelin e rrymes se lidhjes se shkurter,
 - (d) Efektin e humbjeve teknike per rastin e Lidhjes se Vjeter dhe te Re ne Rrjetin e Transmetimit,
 - (e) Furnizimin me energji elektrike per nevojat vetiake, sidomos per rastet kur kemi lidhjen e nje njesie gjeneruese,
- vi. Vleresimin e menyres se Lidhjes ne skemen ekzistuese te Rrjetit te Transmetimit,
- vii. Vleresimin e kosos se Lidhjes per OST sipas variantit te Lidhjes te propozuar nga ana e Aplikantit,
- viii. Plotesimin e kushteve teknike te Lidhjes,
- ix. Plotesimin e paragrafeve perkates te Kodit te Rrjetit

V.3.3.3 Ne qofte se pas analizes rezulton se Lidhja do te jete me mire me tension nen 110 kV, qe i perket Operatorit te Sistemit te Shperndarjes, atehere kerkesa respektive duhet ti dergohet OSSH. Pranimi teknik i Lidhjes, qe jepet nga OST permban:

- i. Termat dhe kushtet e pergjithshme per treguesit sipas Lidhjes se Re te kerkuar,
- ii. Pershkrimin e zgjedhjes per Lidhjen e Re qe perfshin aktivitetet qe kryhen per zgjerimin dhe perforcimin e Rrjetit te Transmetimit,
- iii. Kushtet specifike per Lidhje,
- iv. Pajtueshmeria me Kodin e Rrjetit,
- v. Kerkesat per monitorimin dhe kontrollin, qe percakton kushtet e Lidhjes ne SCADA dhe Sistemin e Telekomunikacionit,
- vi. Te dhenat e rregjistruara, te cilat kane nevojte per verifikim gjate shfrytezimit,
- vii. Vleresimin e kostos jashte pergjegjesise se OST e cila duhet te paguhet nga aplikuesi,
- viii. Nivelin e sigurise se Rrjetit te Transmetimit ne piken e Lidhjes,
- ix. Detyrimet e Aplikuesit qe te marre pjese ne Planin e Mbrojtjes dhe Planin e Zgjerimit te SEE,
- x. Kerkesat lidhur me mbrojtjen dhe automatiken per Lidhjen e Re dhe bashkerendimin e saj me mbrojtjet ekzistuese,
- xi. Parametrat per furnizim te Energjise Elektrike,
- xii. Kushtet sipas te cilave Perdoruesi mund te shkeputet nga Rrjeti i Transmetimit,
- xiii. Kerkesat lidhur me standartet qe duhet te plotesojne pajisjet e lidhjes, matjes, kontrollit, automatizimit, telekomunikacionit etj.

V.3.3.3 Dokumenti i Pranueshmerise Teknike te Lidhjes duhet te leshohet brenda 90 diteve kalendarike, qe nga dita qe OST ka marre kerkesen e Aplikantit ne forme te shkruar si dhe te gjitha dokumentet e listuara me siper.

4.2.4 V.3.4 Kerkesat Teknike per Paisjet e Lidhjes me Rrjetin e Transmetimit

V.3.4.1 Kerkesat teknike te paisjeve per lidhjet specifike jane:

- i. Kushtet teknike te siguruara nga OST ne pikat e Lidhjes duhet te jene ne konformitet me normat dhe Standartet Kombetare dhe Nderkombetare.
- ii. Kushtet teknike te Lidhjes duhet te jene te ngjashme per te gjitha perdoruesit sipas kategorive perkatese.
- iii. Pajisjet dhe aparatet ne pikat e Lidhjes ndermjet Rrjetit te Transmetimit dhe Perdoruesit duhet te jene ne perputhje me standartet teknike qe jane ne fuqi.
- iv. Lidhjet ndermjet instalimeve te Perdoruesve dhe OST duhet te realizohen nepermjet çelsave te afte per t'u shkeputur me shpejtesi maksimale, kur parametrat e SEE jane jashte vlerave te kufirit te lejuar.
- v. Zgjedhja dhe percaktimi i aftesive çkyçese dhe qendrushmerise ndaj rrymave te lidhjeve te shkurtra, duhet te jete brenda standarteve te percaktuar per secilen Pike Lidhje.
- vi. Mbrojtjet e instalimeve ne pikat e Lidhjes ndermjet Rrjetit te Transmetimit dhe Perdoruesve duhet te plotesojne kerkesat e normave teknike ne fuqi, per te reduktuar ne minimum ndikimin negativ tek Perdoruesit e tjere.

V.4 Marreveshja e Lidhjes

V.4.0.1 Nese Aplikantit i pranohet kerkesa, OST dhe Perdoruesi duhet te procedojne te finalizojne nje Mareveshje Lidhje.

Nje Mareveshje Lidhje duhet te hartohet qe te specifikojte kushtet e pergjithshme te Lidhjes dhe çdo kusht specifik, teknik dhe financiar, te aplikuara ne ate Lidhje.

V.5 Specifikimet e Lidhjes

V.5.0.1 Aplikanti do te paraqese ne OST me kerkesen per Lidhje dhe dokumentacionin e meposhtem:

- i. Vendndodhjen e Lidhjes (Nenstacionin e Perdoruesit)
- ii. Skemen njefazore te nenstacionit.
- iii. Planimetrine e nenstacionit.
- iv. Parametrat e te gjithe elementeve te nenstacionit (hyrjet dhe daljet e linjave, kabllot, çelsa, thika, zbara, izolatore, shkarkues, transformator rryme, transformatore tensioni, transformatore fuqie, etj.)
- v. Skemen e Kontrollit dhe Mbrojtjes Rele.
- vi. SCADA dhe Telekomunikimin.
- vii. Aparaturat matese te energjise elektrike.
- viii. Relete e frekuences.

V.5.0.2 Aplikanti duhet te paraqese per Lidhjen edhe:

- i. Pergjegjesite per kontrollin dhe mirembajtjen e paisjeve;
- ii. Pergjegjesite per operimin e paisjeve;
- iii. Pergjegjesite per sigurine e personelit dhe Sigurimit Teknik

Shenim: Tarimi i Releve do te do te vendoset ne fazen e operimit.

V.6 Pika e Lidhjes

V.6.1 Gjeneruesi

V.6.1.1 Pika e Lidhjes e Njesise Gjeneruese do te jete ne nivelin e tensioneve 400 kV, 220 kV dhe 110 kV.

V.6.2 Operatori i Sistemit i Shperndarjes

V.6.2.1 Pika e Lidhjes e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes do te jete ne nivelin e tensionit 110 kV.

V.6.3 Konsumatoret e Kualifikuar

V.6.3.1 Pika e Lidhjes e Konsumatoreve te Kualifikuar do te jete ne nivelin e tensioneve 220 kV dhe 110 kV.

V.7 Karakteristikat e Rrjetit**V.7.1 Hyrje**

V.7.1.1 Ky paragraf specifikon parametrat e SEE, te cilet ndikojne ne sjelljen e sistemit/objektit te Perdoruesit ekzistues dhe Perdoruesit te Perspektives.

V.7.2 Objekti

V.7.2.1 Objekti i ketij paragrafi eshte:

- i. Te siguroje qe sjellja e SEE te plotesoje standartet qe jane thelbesore per sistemin/objektin e Perdoruesit.
- ii. Ti beje te mundur Perdoruesve te projektojne sistemet/objektet e tyre ne baze te standarteve.

V.7.3 Nivelet e Tensionit

V.7.3.1 Nivelet e tensionit te lejueshem maksimal dhe minimal detajohen me poshte:

Tensioni i Sistemit	Maksimal	Minimal
400 kV	420 kV	360 kV
220 kV	245 kV	198 kV
150 kV	242.5 kV	162 kV
110 kV	123 kV	99 kV

V.7.3.2 Disbalanca e Tensioneve

V.7.3.2.1 Disbalanca e tensioneve percaktohet si:

- i. Diference e amplitudave te tensioneve fazore.
- ii. Diference e kendeve midis fazave nga vlera 120°.

V.7.3.2.2 Tensionet fazore duhet te jene me amplitude te barabarte dhe te sfazuar me 120°. Çdo devijim ndikon ne keqfunksionimin e paisjeve rrotulluese, ulje te efijences, vibrime, mbinxehje, etj.

V.7.3.2.3 Kufijte e disbalancimit te tensionit jane:

- i. Per 400 kV dhe 220 kV: 2%
- ii. Per 154 kV dhe 110 kV: 3%

V.7.4 Frekuenca

V.7.4.0.1 Frekuenca e SEE duhet te mbahet brenda nje niveli te pranueshem qe te siguroje funksionimin e pershtatshem te SEE. OST duhet te permbushe detyrimet per mbajtjen e frekuences brenda niveleve te lejuar.

V.7.4.1 Deformimi nga Harmonikat

V.7.4.1.1 Disa tipe paisjesh dhe dukurish mund te prodhojne tensione dhe rryma ne frekuenca qe jane shumefish i frekuences se SEE. Keto komponente te frekuencave te larta quhen harmonika dhe raporti i tyre me frekuencen e SEE quhet rendi harmonik.

V.7.4.1.2 Harmonikat grupohen ne tre grupe: harmonika teke, harmonika teke-trefishe dhe harmonika çifte.

V.7.4.1.3 Harmonikat kane efekte negative ne SEE dhe ngarkesat e lidhura ne SEE, keshtu qe ato duhen kufizuar ne maksimum.

V.7.4.1.2 Treguesit e cilesise ne lidhje me harmonikat jane ne table.

Deformimi total nga harmonikat	Niveli i tensionit nen 110 kV	Niveli i tensionit mbi 110 kV
		8%

V.7.5 Luhajtjet e Tensionit

V.7.5.1 Luhajtjet e tensionit shkaktojne probleme ne ngarkesat elektrike. Nese luhajtja eshte me amplitude dhe frekuence te perceptueshme nga syri i njeriut, ajo perben dridhje te tensionit. Dridhjet e tensionit zakonisht nuk prodhohen nga SEE por nga ngarkesat e Perdoruesve siç jane furrat me hark, kompresoret, leshimi i motorreve te medhenj, repartet e saldimit, etj. Derisa luhajtja e tensionit te SEE ndikon ne Perdoruesit e tjere OST do te duhet te kontrolloje dhe monitoroje kete fenomen ne zbarat e tensionit 100 kV dhe TM.

V.7.5.2 Kufijte e luhatjeve dhe procedurat e kontrollit dhe matjes bazohen ne standartet perkatese.

V.7.6 Faktori i Fuqise ($\cos\phi$)

V.7.6.1 Eshte e deshirueshme qe ngarkesat ne SEE te kene faktor fuqie ($\cos\phi$) sa me afer njesise (njeshit), pasi vetem keshtu Sistemi i Transmetimit operohet ne menyre optimale dhe me humbje sa me te vogla.

Çdo ngarkese me faktor fuqie me te ulet se 0.9 imponon nje rendiment te padrejte te Sistemit te Transmetimit dhe te Perdoruesve te tjere. Prandaj Perdoruesit duhet te respektojne kufirin e faktorit te fuqise per ngarkesat e tyre.

V.7.6.2 **Faktori minimal i lejuar i fuqise eshte 0.9 ($\cos\phi = 0.9$).**

- i. Matja e faktorit te fuqise behet ne menyre te vazhdueshme ne nderthurje me matjen e tensionit. Ngarkesat me faktor fuqie te ulet duhet menjehere te vendosin kondensatore per korigjimin e problemit.

- ii. Nje Perdoruesi me faktor fuqie me te vogel se 0.9, mund ti refuzohet Lidhja ne Rrjetin e Transmetimit, por Perdoruesve ekzistues u kerkohet te vendosin kompensatore per permiresimin e cosφ.

V.7.7 Kerkesat e Mbrojtjes Rele dhe Koordinimi

V.7.7.0.1 Paisjet elektrike te Perdoruesve nuk do te lidhen dhe te vazhdojne te mbeten te lidhur me Sistemin e Transmetimit, nese ato nuk jane te paisur me mbrojtjet rele te nevojshme, me parimet perkatese te sigurise, selektivitetit, shpejtesise, diferencimit dhe ndjeshmerise.

V.7.7.0.2 Ne kete paragraf pershkruhen kerkesat e mbrojtjes rele, pasi mbrojtja rele kerkon gjithmone koordinim dhe bashkeveprim midis Sistemit te Transmetimit dhe Perdoruesve. Sistemi i Transmetimit dhe Perdoruesit bashkeveprojne ne tarimin e mbrojtjes rele dhe permiresimin e teknologjise se mbrojtjes rele. Mbrojtja rele e sistemeve/objekteve te Perdoruesve nuk duhet te tarohet pa u konsultuar me OST dhe pa u diskutuar dhe miratuar ne KPMR.

V.7.7.0.3 KPMR do te jete pergjegjese per organizimin e takimeve periodike per te diskutuar mbi koordinimin e Mbrojtjes Rele te Sistemit te Transmetimit dhe Perdoruesve. KPMR do te investigoje çdo keq funksionim, mos funksionim ose vonim funksionimi te Mbrojtjes Rele ose sjellje te papranueshme te saj.

V.7.7.0.4 OST do te jete pergjegjes per tarimin e releve ne gjithe Sistemin e Transmetimit 400kV, 220kV, 150kV, 110kV. OST miraton Sistemin e Mbrojtjes Rele te linjave 110kV dhe vendos tarimet e tyre ne koordinim me Perdoruesit. Perdoruesit jane pergjegjes per tarimin e Mbrojtjes Rele ne sistemet / objektet e tyre, dhe koordinojne tarimet e Mbrojtjes Rele ne kufijte me Sistemin e Transmetimit.

V.7.7.1 Kohet e Tarimit te Mbrojtjes Rele

V.7.7.1.1 Duke marre ne konsiderate qendrushmerine e SEE si dhe analizat e here pas hereshme te Sistemit te Mbrojtjes Rele dhe paisjeve primare, eshte pergatitur tabela e meposhteme e veprimit te Mbrojtjes Rele.

V.7.7.1.1 Kufijte e Kohes

Niveli i Tensionit	Koha Totale e Funksionimit te relese + Kohen e Hapjes se Çelsit
400 kV	80 msek
220 kV	110 msek
150kV, 110 kV	120 msek

V.7.7.2 Kerkesat per Mbrojtjen Rele

V.7.7.2.1 Kerkesat e Gjenerimit

V.7.7.2.1.1 Te gjitha Njesite Gjeneruese te lidhura me Sistemin e Transmetimit do te mbrohen nga nje sistem mbrojtje i plote dhe i pershtatshem, keshtu qe Sistemi i Transmetimit nuk do te vuaje nga ndonje avari me origjine nga Njesite Gjeneruese.

V.7.7.2.1.2 Mbrojtjet e kerkuara te Njesive Gjeneraruese, (Blloku Transformator–Gjenerator) jane:

Gjeneroret

1. Mbrojtje Diferenciale e Bllokut
2. Mbrojtje Diferenciale e Gjeneratorit
3. Mbrojtje Maksimale me Bllokim Tensioni Minimal
4. Mbrojtje nga Mbingarkesa
5. Mbrojtje nga Lidhja e Shkurter Josimetrike dhe Simetrike
6. Mbrojtje nga Lidhja me Token ne Stator
7. Mbrojtje nga Lidhja me Token ne Rotor
8. Mbrojtje nga Mbitensioni
9. Mbrojtje nga Humbja e Eksitimit
10. Mbrojtje Nulare e Bllokut
11. Mbrojtje Renditjes Kundert

Transformoret e Gjenerimit

1. Mbrojtja Maksimale me/pa Bllokim Tensioni Minimal
2. Mbrojtje Nulare

V.7.7.2.1.3 Transformoret qe jane te lidhur ne bllok (gjenerator-transformator) tarohen se bashku me gjeneratorin ne bllok.

Transformoret e nevojave vetiake

1. Mbrojtja Maksimale

(Shenim: Perjashtim mund te behet per njesite e vogla gjeneruese per disa nga mbrojtjet).

V.7.7.2.1.4 Ne kete paragraf jane paraqitur vetem ato mbrojtje te cilat kane ndikim direkt ne Rrjetin e Transmetimit. Mbrojtje te tjera te Gjeneratoreve dhe Transformoreve dhe mbrojtjet per Turbinat, Boileret dhe Sistemet Ndhimese, jane konsideruar ceshtje te brendshme te Gjeneruesve dhe prandaj nuk detajohen ketu.

V.7.7.2.2 Kerkesat e Mbrojtjes Rele per Sistemin e Transmetimit

- i. Linjat e tensionit te larte 400kV, 220kV, 150kV dhe 110kV, do te kene: Mbrojtje Distancionale dhe Mbrojtje Rezerve (Back-Up).
- ii. Te gjithë linjat 400 kV, 220 kV, do te kene dy skema mbrojtje: Distancionale Kryesore me operim te shpejte, dhe nje Mbrojtje Rezerve.

- iii. Eshte e preferueshme qe mbrojtjet kryesore te ushqehen nga burime te ndryshme per tension dhe rryme.
- iv. Tensioni mund te sigurohet veç e veç nga transformatoret e tensionit ne zbara dhe transformatoret e tensionit ne linje.
- v. Rryma mund te sigurohet nga transformatoret e rrymes se linjave nga dy bobina te ndryshme te tij.
- vi. Me zgjedhje Sistemi i Transmetimit siguron mbrojtje rezerve shtese.

Linjat 400 kV:

- i. Kane dy Mbrojtje Distancionale dhe Mbrojtje Rezerve (Back-Up). Mbrojtja Distancionale ne linjat 400kV mund te jete statike ose numerike dhe te kete minimumi 3 zona me veprim te shpejte.
- ii. Mbrojtjet Kryesore 1 dhe 2 kane te njejten shpejtesi veprimi dhe preferohen me principe te ndryshme funksionimi.
- iii. Kohet e tarimit te zonave duhet te perfshijne dhe kohet e veprimit te çelsave.
- iv. Koha e veprimit te zones se pare (bashke me veprimin e çelsit) 80 milisekonda
- v. Koha e veprimit te zones se dyte (bashke me veprimin e çelsit) 400 mili sekonda
- vi. Kohet e zonave te tjera percaktohen sipas zones se mbulimit dhe konfiguracionit te Sistemit te Transmetimit. Mbrojtjet e linjave 400kV pajisen me Automatiken e Kyçjes se Perseritur (AKP) nje fazore).
- vii. Ne varesi te arsytimit te OST Mbrojtjet Rele kryesore 1 dhe kryesore 2 mund te kene furnizim DC nga bateri te ndryshme.

Linjat 220 kV:

- i. Kane dy Mbrojtje Distancionale dhe Mbrojtje Rezerve (Back-Up). Mbrojtja Distancionale ne linjat 220kV mund te jete statike ose numerike dhe te kete minimumi 3 zona me veprim te shpejte.
- ii. Mbrojtjet Kryesore 1 dhe 2 kane te njejten shpejtesi veprimi dhe preferohen me principe te ndryshme funksionimi.
- iii. Kohet e tarimit te zonave duhet te perfshijne dhe kohet e veprimit te çelesave.
- iv. Koha e veprimit te zones se pare (bashke me veprimin e çelsit) 110 mili sekonda.
- v. Koha e veprimit te zones se dyte (bashke me veprimin e çelsit) 400 mili sekonda.
- vi. Kohet e zonave te tjera percaktohen sipas zones se mbulimit dhe konfiguracionit te Sistemit te Transmetimit. Mbrojtjet e linjave 220kV pajisen me Automatiken e Kyçjes se Perseritur (AKP) nje fazore .
- vii. Ne varesi te arsytimit te OST Mbrojtje Rele kryesore 1 dhe kryesore 2 mund te kene furnizim DC nga bateri te ndryshme.

Linjat 150 kV, 110 kV:

- i. Kane Mbrojtje Distancionale dhe Mbrojtje Rezerve (Back-Up). Mbrojtja Distancionale ne linjat 150 kV, 110kV mund te jete statike ose numerike dhe te kete minimumi 3 zona me veprim te shpejte.
- ii. Kohet e tarimit te zonave duhet te perfshijne dhe kohet e veprimit te çelesave.
- iii. Koha e veprimit te zones se pare (bashke me veprimin e çelsit) 120 mili sekonda.
- iv. Koha e veprimit te zones se dyte (bashke me veprimin e çelsit) 400 mili sekonda.
- v. Kohet e zonave te tjera percaktohen sipas zones se mbulimit dhe konfiguracionit te Sistemit te Transmetimit. Mbrojtjet e linjave 150 kV, 110kV paisen me Automatiken e Kyçjes se Perseritur (AKP) tre fazore.

V.7.7.2.3 Tokezimi

V.7.7.2.3.1 Per te rritur eficencen dhe selektivitetin e Mbrojtjes Rele ne Sistemin e Transmetimit, rendesi te veçante ka tokezimi i transformatoreve te fuqise me tension 400kV, 220kV, 150kV, 110kV. Sistemi i tokezimit studiohet, analizohet dhe percaktohet nga OST. Struktura e tokezimit eshte e detyrueshme te respektohet nga Perdoruesit ne sistemet/objektet e tyre.

V.7.7.2.4 Kerkesat e Mbrojtjes Rele per Linjat e Tensionit te Mesem 35kV, 20kV, 10kV

V.7.7.2.4.1 Linjat e tensionit te mesem 35 kV, 20 kV, 10kV, mbrohen me Mbrojtje te Rrymes Maksimale, Mbrojtje Çasti dhe Mbrojtje te Difekteve me Token me drejtim. Tarimet e Releve ne linjat e tensionit te mesem te Perdoruesve do te percaktohen nga Perdoruesit ne marreveshje me OST.

V.7.7.2.5 Kerkesat e Mbrojtjes Rele per Transformatoret

V.7.7.2.5.1 Autotransformatoret dhe transformaret e fuqise mbrohen nga Mbrojtje Diferenciale. Pervec kesaj, ata mbrohen edhe me Mbrojtje nga Mbingarkesat, Mbrojtje nga Rryma Maksimale, Mbrojtje Nulare.

V.7.7.2.5.2 Si shtese do te kete Mbrojtje nga Difektet me Token. Per funksionimin paralel Mbrojtja Rezerve duhet te jete e tipit te drejtuar. Per Mbrojtje kunder Lidhjeve te Shkurtra te renda, ne shtese te mbrojtjeve elektrike, duhen siguruar edhe relete gazore, Mbrojtje nga Temperatura e Peshtjellave, Mbrojtje nga Temperatura e Vajit dhe Mbrojtje nga Zjarri.

V.7.7.2.5.3 Ne sistemet/objektet e Perdoruesve transformaret e fuqise ≥ 10 MVA, paisen me Mbrojtje Diferenciale, Mbrojtje e Rrymes Maksimale e Drejtuar dhe Rele per Difektet me Token.

V.7.7.2.5.4 Per transformaret e Nivelit 110kV/35kV/20kV ne sistemet/objektet e Perdoruesve do te sigurohet Mbrojtje Diferenciale per 10 MVA e larte me Mbrojtje Rezerve, Mbi Rryme me mbajtje kohe dhe Mbrojtje nga Difektet me Token (me tip te drejtuar per funksionimin paralel).

V.7.7.2.5.5 Sa me poshte, do te jene normat e aprovuara te mbrojtjes per transformaret e niveleve te ndryshme te tensionit dhe fuqise nominale.

V.7.7.2.6 Kerkesat e Mbrojtjes se Zbarave te Nenstacioneve

V.7.7.2.6.1 Zbarat e nenstacioneve te nivelit te tensionit 400 kV, 220 kV, 150kV, 110kV, mbrohen me mbrojtje Diferenciale. Zbarat pajisen gjithashtu me Mbrojtje nga Refuzimi i Veprimit te Çelesit.

V.7.7.3 Mbrojtje nga Zjarri

V.7.7.3.1 Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe rregullat e zbatimit te tij, duhet te jene ne perputhje me Specifikimet e Standarteve dhe Ligjeve ne fuqi.

V.7.8 Te Dhenat e Kerkuara nga OST

V.7.8.1 Tipet dhe tarimet e te gjitha releve dhe sistemeve te mbrojtjes te instaluar ne Njesine Gjeneruese, (bllokun Transformator–Gjenerator, Transformoret e nevojave vetiake si dhe paisjet ndihmese).

V.7.8.2 Tipet dhe tarimet e te gjitha releve te instaluara ne gjithe transformoret 110kV/TMkV te Perdoriesve.

V.7.8.3 Tipet dhe tarimet e releve te mbrojtjeve te instaluara ne gjithe linjat 110kV.

V.7.8.4 Te dhenat e kerkuara per percaktimin e rrymave te lidhjeve te shkurtra ne çdo pike lidhje si dhe aftesite çkyçese te lidhjeve te shkurtra te paisjeve komutuese ne kufijte me Sistemin e Transmetimit.

V.7.9 Parametrat e Projektimit te Njesive te Reja te Gjenerimit

V.7.9.1 Per Njesite e Reja zbatohen kerkesat e ketij Kodi. Ndersa per njesite egzistuese eshte e domozdoshme te behet rehabilitimi dhe modernizimi per te respektuar kerkesat e ketij Kodi Rrjeti.

V.7.9.2 Si shtese, OST mund t'i kerkoje Gjeneruesve te pershtaten me specifikimet e tjera, ne nje mareveshje bilaterale, perpara se te pranohet Aplikimi per Lidhje, me qellim qe te siguroje sjelljen e kerkuar te Sistemit te Transmetimit dhe te gjithe SEE.

- i. Njesite Gjeneruese do te jene ne gjendje te furnizojne prodhimin nominal te fuqise aktive me nje vlere te faktorit te fuqise nga 0.85 deri ne 0.95.
- ii. Njesite Gjeneruese te jene te paisur me kurben e mundesise.
- iii. Koficenti (Kc) Lidhjes se Shkurter te njesive Gjeneruese nuk do te jete me i vogel se 0.5.
- iv. Njesite Gjeneruese duhet te jene ne gjendje te furnizojne me fuqi aktive edhe kur frekuenca e sistemit eshte ne kufijte 49.5 Hz ne 50.5 Hz.

V.7.9.3 Njesite e Reja Gjeneruese duhet te kene Rregullatore Automatik Shpejtesie dhe Regullator Automatik Tensioni. Mundesia e tarimit te statizmit te RASH te jete nga 3 deri ne 6%. Njesite gjeneruese duhet te jene ne gjendje te rrisin prodhimin ne menyre te menjehereshme me raportin 5% per 5 minuta kur frekuenca e SEE eshte ne renie.

V.7.9.4 Njesite Gjeneruese duhet te kene peshtjellen e statorit te lidhur ne yll dhe te gatshme per tokezim. Tokezimi i pikes se yllit percaktohet nga Sistemi i Transmetimit ne menyre te tille qe Faktori i lidhjes me token te jete 1.4 ose me i vogel.

- V.7.9.5 Njesite e Gjenerimit Termik duhet te jene aftesi Leshimi relativisht te shpejte, keshtu qe Qendra Dispecer Nacionale mund ta perdore ate per Rezerve te Rregullimit Terciar.
- V.7.9.6 Njesite Gjeneruese Hidrike duhet te jene te afta te vazhdojne funksionim te qendrueshem per çdo ngarkese ndermjet 35% dhe 105% te kapacitetit.
- V.7.9.7 Njesite Gjeneruese dhe Centrali ne teresi paisen me SCADA. Gjeneruesi i siguron OST nepermjet SCADA te instaluar ne sistemin/objektin e tij parametrat e funksionimit qe do te kerkohen nga OST.
- V.7.9.8 Çdo Njesi Gjeneruese minimumi duhet te kete aftesite e meposhteme:
- i. Te gjeneroje dhe te operoje me parametra normal per frekuenca te Sistemit te Transmetimit ne diapazonin 49.5 Hz – 50.5 Hz.
 - ii. Te mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit per frekuenca ne Sistemin e Transmetimit ne diapazonet 47.5 Hz – 49.5 Hz dhe
 - i. 50.5 Hz – 52.5 Hz per nje kohe prej 60 minutash.
 - iii. Te mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit per frekuenca ne Sistemin e Transmetimit ne diapazonet 47.0 Hz – 47.5 Hz per nje kohe prej 20 sekonda. Kjo kerkohet per çdo here qe frekuenca eshte nen 47.5 Hz.
 - iv. Te mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit per frekuenca ne Sistemin e Transmetimit ne diapazonet 52.5 Hz – 53 Hz per nje kohe prej 5 sekonda. Kjo kerkohet per çdo here qe frekuenca eshte mbi 52.5 Hz.
 - v. Te mbetet e sinkronizuar me Sistemin e Transmetimit gjate ndryshimit te frekuences ne Sistemin e Transmetimit ne vlera me te medha dhe te barabarta me 0.5 Hz per sekond.
 - vi. Te vazhdoje operimin ne minimumin e specifikuar te Gjenerimit brenda vlerave 49.8 Hz – 51.0 Hz.
 - vii. Te mbetet e sinkronizuar gjate ndryshimit te nivelit te tensionit ne Sistemin e Transmetimit ne vlera me te medha dhe te barabarta me 10%.
 - viii. Te vazhdoje operimin ne perputhje me Kurben e Aftesise Reaktive siç kerkohet nga Sistemi i Transmetimit per mbajtjen e niveleve te Tensionit.
 - ix. Te vazhdoje te mbetet i sinkronizuar gjate prishjes se balances
 - ii. gjenerim – ngarkese sipas standarteve IEC 60034-1.
 - x. Vlera e rrymes se Lidhjes se Shkurter duhet te jete sipas standarteve IEC 60034-1.
 - xi. Gjenerimi Minimal jo me i madh se 35% e Kapacitetit Nominal.

- xii. Aftesia per Rritjen e Gjenerimit jo me i vogel se 1.5% e kapacitetit nominal per minute, kur njesia eshte ne kushte normale operimi.
- xiii. Aftesia per Uljen e Gjenerimit jo me i vogel se 1.5% e kapacitetit nominal per minute, kur njesia eshte ne kushte normale operimi.

V.7.9.8 Njesite Gjeneruese duhet te vazhdojne te operojne dhe kur profilet e tensionit ne Sistemin e Transmetimit jane ne nivelet e paraqitura ne tabelen e meposhteme:

Niveli i Tensionit	Lidhur ne:	Ne Kapacitet Maksimal $\cos\phi$	Ne 35% te Kapacitetit Maksimal $\cos\phi$
99kV – 123kV	110 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
90kV – 100kV		0.85	0.7 – 0.4
140kV – 163kV	150 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
125kV - 140kV		0.85	0.7 – 0.4
198kV – 242kV	220 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
190kV – 200kV		0.85	0.7 – 0.4
360kV – 420kV	400 kV	0.93 – 0.85	0.7 – 0.4
350kV- 360kV		0.85	0.7 – 0.4

Cdo njesi gjeneruese duhet minimalisht te jete e afte te japin fuqine aktive nominale per faktore te fuqise($\cos\phi$) ne kufijte nga 0,85 ne dhenie(injektim) ne 0,95 ne marrje(absorbim) tek terminallet e njesise gjeneruese.

V.7.9.9 Per te gjitha rastet e implementimit te teknologjive te reja, te cilat nuk jane parashikuar ne kete Kod, OST do ta trajtoje ceshtjen ne Komisionin e Rishikimit te Kodit dhe do te paraqesin per miratim ne ERE ndryshimet apo shtesat perkatese.

VI. KODI I RRJETIT – KODI I OPERIMIT TE TREGUT

VI.1 Hyrje

VI.1.1 Pjesa e Kodit te Operimit te Rrjetit mbulon operinin ne kohe reale, proceset dhe procedurat qe Operatori i Tregut te OST do te perdore per te balancuar sistemin.

VI.2 Planifikimi i Burimeve

VI.2.1 Planifikimi Vjetor

VI.2.1.1 Çdo vit OST-ja do të kryejë një studim të operimit të pritshëm të SEE për vitin në avancë . Studimi do të bazohet në informacionin e siguruar nga pjesëmarrësit e tregut dhe duhet të përmbajë:

- i. Parashikimet e kërkesës totale për energji elektrike sipas muajve dhe viteve bazuar në informacionin e Furnizuesve Publikë me Shumicë dhe Furnizuesve të Kualifikuar dhe/ose Klientëve të Kualifikuar.
- ii. Parashikimet e kufizimit të ngarkesës për çdo muaj dhe vit sipas programeve të përgatitura nga Furnizuesit Publikë me Shumicë dhe Furnizuesit e Kualifikuar dhe/ose Klientët e Kualifikuar.
- iii. Parashikimet e ngarkesës pik të transmetimit në çdo pikë livrimi për çdo muaj, bazuar në informacionin e OSSH dhe Klientëve të Kualifikuar dhe ngarkesat pik të parashikuara nga OSSH për çdo pikë livrimi dhe pik (ngarkese) koinçidues.
- iv. Parashikimet e kurbes se perafert të ngarkeses bazuar në profilizimin e perafert te ngarkeses per çdo pikë livrimi, për çdo muaj.
- v. Programimin e gjenerimit te energjise elektrike ne te gjithë sistemin bazuar në informacionin nga KESH – Gjen, PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar dhe Tregtaret.
- vi. Duke marrë parasysh rëndesinë e gjenerimit nga kaskadat e lumit Drin, OST-ja do të verifikojë informacionin nga KESH - Gjen mbi gjenerimin nga kjo kaskade duke programuar dhe verifikuar liqenin e Fierzes çdo muaj të vitit dhe duke e krahasuar vazhdimisht me ate te KESH – Gjen.
- vii. Parashikimet dhe programet e importeve dhe eksporteve të energjise elektrike bazuar në informacionin e pjesemarrësve te tregut.
- viii. Parashikimet e humbjeve të energjise elektrike ne rrjetin e transmetimit.
- ix. Parashikimet dhe analizat e shërbimeve ndihmese të kerkuara gjatë vitit në avance lidhur me kërkesen që gjeneratorët të ofrojnë rezervat e duhura.
- x. Parashikimet e nevojave për energji elektrike balancuese për të mbuluar devijimet e mundshme gjate çdo muaji të vitit.
- xi. Draft planin për marrjen e gjithë shërbimeve ndihmese gjatë vitit në avance.
- xii. Vleresimin e operimeve ne terma te sigurise dhe qëndrueshmerise.

- xiii. Vlerësimin e masave paraprake që duhen ndermarre gjatë vitit për te respektuar dhe arritur qëndrueshmërie e duhur dhe nivelet e sigurise per Sistemin Elektroenergetik Shqiptar sipas Udhezuesit te UCTE.
- xiv. Vlerësimin dhe parashikimin e pjesëmarrjes në kompensimin e tranzitimeve mes OST dhe OST te Rajonit dhe parashikimin e fondit të duhur për të mbuluar kete sherbim.
- xv. Vlerësimin dhe parashikimin e kapacitetit të interkonjeksionit sipas një vlerësimi paraprak nga pjesëmarrësit e tregut.

VI.2.1.2 OST eshte pergjegjese per programimin dhe realizimin e planit në nivelin e rrjetit te transmetimit dhe do të jete pergjegjese per programimin dhe realizimin e sherbimeve te meposhtme:

VI.2.1.3 Sherbimet Ndhimese - KESH - Gjen do t'i shese çdo vit OST sipas nje mareveshjeje vjetore shërbime ndihmëse nga njësitë ekzistuese hidroenergetike teknikisht të kualifikuara për sigurimin e këtyre shërbimeve me çmime të rregulluara të vendosura nga ERE.

VI.2.1.4 OST mund t'u kerkoje gjithashtu pjesemarrësve te tjere ne treg qe te gjenerojne ose furnizojnë me energji elektrike tregun shqiptar (PVE, PPE ose Tregtaret) per te siguruar sherbime ndihmese.

VI.2.1.5 Bazuar ne informacionin e Studimit Vjetor, OST, jo me vone se 1 dhjetori para Vitit ne Avance me të cilin lidhet informacioni, do te pergatise parashikimin e nevojave vjetore te energjise elektrike dhe do t'ia jape kete parashikim ERE-s dhe Pjesemarrësve te Tregut.

VI.2.1.6 OST mund t'u kerkoje gjithashtu Pjesemarrësve te tjere te Tregut të gjenerojnë ose furnizojnë me energji elektrike tregun shqiptar (PPE, PVE ose Tregtaret) qe sigurojne nje pjese te arsyeshme te Energjisë Balancuese.

VI.2.1.7 Sherbimi i Ndarjes se Kapacitetit te Interkonjeksionit – Bazuar në informacionin e studimit vjetor, OST do te përgatise parashikimin e ndarjes vjetore të kapacitetit te interkonjeksionit, kapacitetin neto te transferimit dhe kapacitetin e lire te transferimit jo me vone se 1 dhjetori i vitit aktual për vitin ne avance dhe do t'ia paraqese ate ERE-s dhe pjesemarrësve te tregut.

VI.2.1.8 OST do t'ia shese kapacitetin e interkonjeksionit pjesemarrësve te tregut siç pershkruhet në Rregullat e Tregut.

VI.2.1.9 Bazuar ne informacionin e studimit vjetor, OST do të pergatise jo me vone se 1 Dhjetori i vitit aktual per Vitin ne Avance, nje parashikim vjetor per gjenerimin e energjise dhe do t'ja paraqese ate ERE, OSSH dhe pjesemarrësve te tjere te tregut.

VI.2.1.10 KESH - Gjen duhet te siguroje sherbimet e meposhtme me renditjen dhe perparësite e mëposhtme :

- i. Sherbime Ndhimese per OST.
- ii. Shitjet e energjise per mbulimin e humbjeve te transmetimit.
- iii. Shitjet e energjise Furnizuesit Publik me Shumice.
- iv. Shitjet e energjise ne tregun konkurrues te energjise elektrike per aq sa lejohet.

VI.2.1.12 KESH – Gjen do te ofroje energjine elektrike dhe sherbimet e veta bazuar ne nje marreveshje vjetore per blerjen e energjise elektrike me çmime gjenerimi të rregulluara te bazuara ne kosto. Furnizuesi Publik me Shumice do te jete i detyruar ta bleje kete energji elektrike brenda kufirit te miratuar nga ERE.

VI.2.1.13 Furnizuesi Publik me Shumice mund te bleje energji elektrike shtese nga PPP, PVE, Tregtarët dhe Furnizuesit e Kualifikuar.

VI.2.2 Planifikimi Mujor

VI.2.2.1 Jo më vone se 10 dite para fillimit te nje muaji të caktuar gjatë Vitit në Avancë, OST-ja do të hartoje një plan mujor operimi per operimin e sistemit energjetik shqiptar bazuar ne informacionin mujor të perditësuar te siguruar nga pjesemarresit e tregut.

VI.2.2.2 Plami mujor i operimit do te permbaje per ate muaj:

- i. Kerkesen për energji dhe plotesimin nga gjenerimi lokal;
- ii. Profilet e pritshme tipike javore dhe ditore te kurbes se ngarkeses gjatë muajit per ditet e punes dhe pushimit, dhe kurbat tipike mujore të ngarkeses per te shtunat dhe te dielat;
- iii. Planin ditor dhe mujor të mbylljeve të programuara te njesive te gjenerimit;
- iv. Verifikimin e nivelit të ujit te liqenit te Fierzes
- v. Energjine e importuar te programuar
- vi. Planin mujor te mbylljeve të programuara të njesive gjeneruese
- vii. Planin per sherbimet ndihmese gjate muajit – Çdo njesi gjeneruese nga lista e gjeneruesve per sigurimin e sherbimeve ndihmese duhet t’i siguroje OST te dhënat e meposhtme:
 - a) kufirin e energjise rezerve te ofruar ne MW
 - b) gradientin e rritjes/renies se energjise në MW/min
- v.iii Vleresimin e operimeve të pritshme ne terma te qendrushmerise operative dhe sigurise se sistemit energjetik dhe masat e pritshme gjate muajit per forcimin e sigurise dhe qendrushmerise sipas nevojës.

VI.2.2.3 Per te ndihmuar OST ne pergatitjen e planit mujor të operimit, pjesemarresit e tregut qe marrin sherbime transmetimi do te pergatisin planin per perdorimin e rrjetit te transmetimit jo me vonë se 20 dite para fillimit të muajit në formen e deklaruar ne Kodin e Rrjetit.

VI.2.3 Planifikimi Javor

VI.2.3.1 OST do te hartoje nje Plan Javor nga ora 12:00 a.m. e Dites se fundit te Punes (e premte) qe i paraprin Javes ne Avance. Java do te nise te henen ne oren 00:00 dhe do te mbaroje te dielen ne oren 24:00. Plani Javor do te percaktoje sasine e energjise elektrike qe nevojitet nga KESH - Gjen per çdo ore te javes, per Sherbimet Ndhmese, Sherbimet Balancuese dhe furnizim shtese me energji bazuar ne informacionin me te fundit të dhene nga Pjesëmarresit e Tregut.

VI.2.3.2 OST do te pergatise çdo dite planin e njesive gjeneruese qe do te punojne ne kohe reale; kjo do të parashikohet dhe zbatohet plotesisht gjate programit ditor per çdo ore te dites.

VI.2.3.3 Plani Javor do te permbaje programin e energjise se importuar dhe burimeve te tjera te pritshme per dispeçerim ne baza te dispeçerimit ekonomik nga OST gjate javes per te plotesuar ngarkesen e parashikuar.

VI.3 Tregtimi i Kapaciteteve te Interkoneksioneve

VI.3.1 Pershkrim i Pergjithshem

VI.3.1.1 Kapaciteti i Interkoneksioneve nxiret ne ankande vjetor, mujor dhe ditor sic percaktohet ne Rregullat e Tregut.

VI.3.2 Percaktimi i Kapacitetit te Interkoneksioneve

VI.3.2.1 OST eshte pergjegjese per nivelin e disponueshem te kapaciteteve interkonektuese per tregun (import dhe eksport) si dhe per afatet kohore te disponibilitetit te tyre.

VI.3.3 Ankandet e Kapacitetit te Interkoneksioneve Vjetor dhe Mujor

VI.3.3.1 Bazuar ne Rregullat e tregut OST do te beje Ankandet e Kapacitetit te Interkoneksioneve.

VI.4 Tregu i Energjise Elektrike

VI.4.0.1 Tregu i energjise elektrike dhe te gjitha transaksionet e tij administrohen nga Operatori i Tregut i OST.

VI.4.0.2 Operatori i Tregut i OST do ti pajise (njoh) te gjitha pjesmarresit ne treg me protokollet dhe procedurat shoqeruese konform atyre te percaktuara ne Rregullat e Tregut.

VI.6 Sherbime Shtese te Balancimit

VI.6.1 Sherbimet ndihmese

VI.6.1.1 Te gjitha njesive gjeneruese u kerkohet te sigurojne sherbime ndihmese ne perputhje me kete Kod Rrjeti.

VI.6.2 Fuqia Reaktive

VI.6.2.1 Te gjitha njesive gjeneruese u kerkohet te sigurojne ne menyre te detyrueshme sherbimin e fuqise reaktive. OST do te perdore paisjet matese per te kontrolluar permbushjen e ketij detyrimi nga njesite gjeneruese.

VI.7 Implementimi

VI.7.1 Ne te gjitha rastet e mosplotesimit te standarteve te Kodit te Rrjetit, Palet paraqesin argumentet perkates per mosplotesimin e ketyre standarteve. Keto argumenta do te konsiderohen dhe trajtohen nga strukturat vendimmarrese qe parashikohen ne Kodin e Rrjetit dhe ne baze te Legjislacionit ne fuqi.

Shtojca A**Terma dhe perkufizimet per Kodin e Rrjetit**

TERMAT	Perkufizime
Kriteri n-1	<p>Kriteri i cili perdoret per verifikimin, planifikimin dhe projektimin e Sistemit Elektroenergjetik, qe plotesohet nese arrihen te permbushen kushtet e meposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ka nderprerje te furnizimit me Energji Elektrike kur ky kusht plotesohet, - Sistemi mbetet nje i tere dhe kalon ne nje regjim te qendrueshem me parametra normale, <p>Kriteri n-1 plotesohet kur Energjia Elektrike totale e gjeneruar ne nje zone te caktuar mund te transmetohet ne kushtet per te cilat njeri nga elementet nuk punon dhe perseri konsumatoret ushqehen nga elemente te tjere (d.m.th energjine e prodhuar nga gjeneruesit e dergojne tek konsumatoret elementet e tjere).</p>
Akses ne rrjet	E drejta e Perdoruesve per t'u krijuar mundesi per lidhjen me Sistemin e Transmetimit, dhe ne zbatim te Legjislacionit ne fuqi per sherbime te Rrjetit te Transmetimit.
Tarifat e Sherbimeve Ndhimese	Nje liste tarifash te miratuara nga ERE te propozuara nga i Licensuari qe siguron sherbimet ndihmese.
Aplikuesit	Person juridik, aktual apo i ardhshem si Perdorues potencial i Sistemit te Transmetimit qe aplikon per leje per tu lidhur,ose per te modifikuar lidhjen egzistuse me Sistemin e Transmetimit.
Aplikimet per Lidhje me Rrjetin e Transmetimit	Dokumente qe plotesohen nga Perdoruesit e perspektives per te kerkuar akses per tu lidhur me Sistemin e Transmetimit te Energjise Elektrike,ose nga Perdoruesit egzistues per te modifikuar lidhjet e tyre egzistuse. Keto dokumente behen ne perputhje me paragrafet e Kodit te Rrjetit, per te marre miratim lidhjeje nga OST.
Koha Mesatare Nderprerjes se Furnizimit (MTI) me Energji Elektrike	<p>Treguesi i performances se sistemit i cili llogaritet me formulen e meposhteme: $MTI = \frac{8760 \cdot EN}{EC}$ [min uta / vit]</p> <p>Ku: EN- eshte mos-furnizimi me Energji Elektrikr per shkak te nderprerjes te furnizimit nga Rrjeti i Transmetimit [MW/vit] EC- eshte konsumi neto ne Sistemin Elektroenergjetik (ne te cilin nuk perفشihet konsumi per nevoja vetiake) [MWh/vit].</p>
Mekanizmi i Balancimit	Nje mekanizem i operuar nga Operatori i Tregut te OST nepermjet te cilit pranohen oferta dhe propozime me qellim qe te arrihet ballancimi fizik i SEE.
Njesi Balancimi Unit	Nje njesi gjeneruese ose ndonje pjesemarres tjeter fizik i afte per te bere oferta dhe propozime per mekanizmin e balancimit.

Propozim	Nje propozim i bere nga nje pjesemarres i tregut, qe vendos nje cmim ne te cilin do te reduktohen nivelet e gjenerimit ose livrimet (interkonektoret) nese instruktohet per te vepruar ne kete menyre nga Operatori i Dispecerimit ne OST nepermjet pranimit te ketij propozimi.
Pika e Lidhjes	Pika e lidhjes fizike te nje Perdoruesi me Sistemin e Transmetimit.
Kapaciteti i Kontraktuar	Ne lidhje me nje njesi gjenerimi, siç eshte fuqia elektrike aktive qe injektohet nga njesite Gjeneruese ne Sistemin e Transmetimit ne piken e lidhjes, perjashtuar energjine e konsumuar ne njesine Gjeneruese per nevojat e veta. Ne lidhje me Perdoruesit e tjere eshte fuqia elektrike aktive qe injektohet nga Sistemi i Transmetimit ne sistemet/objektet e tyre ne piken e lidhjes.
Rezerva e Rregullimit Primar	Rezerva e Rregullimit primar te frekuences eshte rezerve qe me devijimin e frekuences nga vlera kufi (e lejuar) mund te vihet ne perdorim automatikisht per 30 sekonda dhe te jete ne gjendje te vazhdoje te operoje per nje kohe te pakten prej 15 minutash. Kjo realizohet nga Rregullatorët Automatike te Shpejtesise te (RASH) qe mbahen vazhdimisht ne sherbim.
Rezerva e Rregullimit Sekondar	Rezerva e Rregullimit sekondar frekuence/fuqi aktive eshte rezerve, e cila me devijimin e frekuences dhe/ose te balances se kembimit te fuqise nga vlera e lejuar dhe programuar, mund te vihet ne pune automatikisht brenda nje intervali jo me shume se 15 minuta. Rezerva e Rregullimit sekondar frekuence/fuqi aktive mbivendoset mbi rezerven e rregullimit primar.
Rezerva e Rregullimit Terciar	Rezerva e Rregullimit terciar i mbivendoset rezerves se Rregullimit primar, sekondar asaj rrotulluse per te vendosur balancen ne rastin e devijimeve te shfaqura nga programi i krijuar.
Rregjimi Kritik i Operimit	Rregjimi ne te cilin elemente te Sistemit Elektroenergjetik apo i tere Sistemi Elektroenergjetik operon me parametra te ndryshem nga parametrat e percaktuar ne standarte.
De-Sinkronizimi	Akti i shkeputjes se nje njesie Gjeneruese nga Sistemi i Transmetimit ne te cilin ka qene sinkronizuar.
Stakimi	Akti fizik i ndarjes se sistemeve/objekteve te Perdoruesve nga Sistemi i Transmetimit.
Kodi Dispecerimit	Kodi I Dispecerimit eshte pjese e Kodit te Rrjetit qe mbulon pergjegjesite e OST si Operator i Sistemit Dispecer per operimin ne kohe reale.
Procedurat e akimimit	Procedure e pershkruar ne menyre te detajuar ne Kod per zgjidhjen e ankesave ndermjet OST dhe Paleve.
Sistemi i Shperndarjes	Rrjetat e Shperndarjejes se Energjise Elektrike ne tension te mesem dhe te ulet (nen110kV), [35kV, 20kV, 10kV, 6kV dhe 0.4kV perfshi dhe transformatorët 110/TM]
Tokezimi	Nje menyre per sigurimin e lidhjes se elementeve me token nga nja paisje tokezimi.

Paisja e Tokezimit	Nje mjet per sigurimin e lidhjes ndermjet elementit dhe tokes, i cili duhet te jete me fuqi dhe aftesi konform standarteve.
Fuqia Elektrike e Plote (VA)	Fuqi Elektrike e plote quhet fuqia $S=P+jQ$. Moduli i saj llogaritet nga formula $S = (P^2+jQ^2)^{1/2}$ Shprehur ne njesi (Volt-Amper)(VA) ose e shumezime standarte si: 1000 VA = 1 kVA 1000 kVA = 1MVA 1000MVA=1GVA 1000GVA=1TVA= 10^{12} VA
Fuqia Elektrike Aktive (W)	Produkti i tensionit dhe rrymes dhe kosinusit te kendit ndermjet tyre. $P=(U \times I) \times \cos\phi$ Matet me njesine Vat (W) ose shumezime standarte : 1000W=1KW 1000KW=1MW 1000MW=1GW 1000GW=1TW= 10^{12} W
Fuqia Elektrike Reaktive (VAr)	Produkti i tensionit dhe rrymes dhe sinusit te kendit te fazes ndermjet tyre. $Q=(U \times I) \times \sin\phi$, matet me njesine volt – amper reaktiv(VAr) dhe shumezime standarte 1000 VAr = 1kVAr 1000 kVAr =1MVAr 1000MVAr=1GVAr 1000GVAr=1TVAr= 10^{12} VAr
Rajon i Sistemit Elektroenergjetik	Numri total i linjave dhe pajisjeve te tjera ndihmese ne nje zone te caktuar te Sistemit Elektroenergjetik.
Sherbime te Sistemit Elektroenergjetik	Sherbime qe realizohen nga OST sh.a. dhe Perdoruesit me qellim qe te mbahet niveli i sigurise gjate operimit te Sistemit Elektroenergjetik dhe cilesise se Energjise Elektrike te Gjeneruar, Transmetuar, Shperndare dhe Furnizuar. Parametrat e vendosur ne kete rast jane bazuar ne nje rregullore perkatese.
Testet e Sistemit Elektroenergjetik	Test i kryer nga OST sh.a. ose Perdorues i cili perfshin kushtet e simulimit ose kontrollin e zbatimit te rregullave dhe standarteve.
Energjia Elektrike Aktive (Wh)	Energjia Elektrike eshte fuqia aktive qe gjenerohet apo kalon ne nje qark elektrik gjate nje intervali kohe, duke qene integrali i caktuar i fuqise aktive me kufije kohe. Matet me njesi Vat-Ore ose shumezime standarte: 1000Wh=1KWh 1000KWh=1MWh 1000MWh=1GWh 1000GWh=1TWh= 10^{12} Wh

Energjia Elektrike Reaktive (VArh)	Energjia Elektrike reaktive eshte integrali i caktuar me kufije kohe i Fuqise reaktive matur ne njesi me volt-amper reaktive-ore ose shumezime standarte qe eshte; 1000 VArh = 1 kVArh 1000 kVArh = 1MVARh 1000MVARh=1GVArh 1000GVArh=1TVArh=10 ¹² VArh
Konsumatorët e Energjise Elektrike	Nje person apo subjekt juridik qe blen Energji Elektrike per te konsumuar per vetveten apo per procese te ndryshme qe ka ne aktivitetin e tij.
Tregu i Energjise Elektrike	Mareveshje tregtare per shit-blerjen e Energjise Elektrike me shumice e pakice ne Sistemin Elektroenergjetik, me qellim qe te sigurohet funizimi i qendrueshem i konsumatoreve me Energji Elektrike brenda teritorit te Republikës se Shqipërisë.
Rrjeti i Energjise Elektrike	Teresia e linjave, nenstacioneve si dhe linjat e interkonjeksionit te cilat perbejne Rrjetin e Energjise Elektrike.
Sistemi Elektroenergjetik(SEE)	Nje Sistem i nderlidhur qe perbehet nga Centrale Gjenerimi te Energjise Elektrike, linja, nenstacione dhe elemente te tjere per Transmetimin dhe Shperndarjen e Energjise Elektrike
Energjetizimi per Ristartimin dhe Operimin e Sistemit Elektroenergjetik	Procedurat e venies nen tension (me ngarkese) e linjave elektrike qe sapo kane filluar te punojne apo pas riparimeve te mundeshme te tyre, dhe funizimi me Energji Elektrike i njesive te Gjenerimit te cilat startimin e tyre e realizojne duke marre Energji Elektrike nga Sistemi i Transmetimit vendas apo nga Sistemet e vendeve fqinje.
Ngjarje - Çrregullim i Sistemit Elektroenergjetik	Statusi i operimit i cili rezulton pas humbjeve te disa elementeve te Rrjetit te Transmetimit apo humbjes se elementeve ne sistemet/objektet e Perdoruesve te cilet ndikojne ne devijimin e parametrave te Sistemit Elektroenergjetik nga vlerat e lejuara, ose qe mund te kete oshilacione te medha te ketyre vlerave, mund te shkaktoje deme tek konsumatorët dhe tek te tjerët qe jane fqinje te sinkronizuar me Sistemin tone Elektroenergjetik.
Ngjarje (kushtet e ngjarjes)	Kushtet e operimit, per nje instalim elektrik te caktuar qe mund te rezultojne me nje apo me shume difekte qe shkaktojne perkeqesim te operimit apo deri ne nderprerje te furnizimit me Energji Elektrike.
Viti Financiar	Periudha qe fillon nga 1 Janar deri ne 31 Dhjetor i nje viti.
Frekuenca	Numri i cikleve alternativ te rrymes per sekond ne te cilen funksionon Sistemi Elektroenergjetik. (matet me Hz)
Relete e Frekuences	Rele qe vepron kur vlera e frekuences devijon nga vlera e frekuences e taruar ne rele.
Ngjarje te medha te Sistemit Elektroenergjetik	Nje demtim i Sistemit Elektroenergjetik qe eshte shume i madh dhe qe shkakton nderprerje te furnizimit me Energji Elektrike ne nje zone te caktuar apo ne te gjithë Sistemin Elektroenergjetik.

Import - Eksporti	Levizja e Fluksit te Energjise Elektrike nga impiante ose instalime elektrike te nje vendi, ne impiante ose instalime elektrike te nje vendi tjeter.
Incidentet (Avari)	Incidenti (avaria) eshte fenomen qe ndodh per arsye te brendeshme apo te jashtme dhe qe sjell prishjen e parametrave te Energjise Elektrike ose ndalimin per nje kohe te caktuar te nje apo disa elementeve qe nga ana tjeter sjellin nderprerjen e furnizimit me Energji Elektrike.
Treguesi i Sigurise se Sistemit Elektroenergjetik	Aftesia e Sistemit Elektroenergjetik per sigurimin e furnizimit me Energjine Elektrike te konsumatoreve, sipas kushteve dhe standarteve te percaktuar.
Fuqia e Instaluar	Kapaciteti nominal i fuqise aktive qe mund te jape nje Central i Energjise Elektrike bazuar mbi dokumentacionin e prodhuesit (çertifikaten e prodhuesit), i cili eshte shkruar ne etiketen perkatese te prodhuesit.
Nderprerjet nga Avarite ne Sistemin Elektroenergjetik	Nderprerje e furnizimit me Energji Elektrike si rezultat i avarive te elementeve ne Sistemin Elektroenergjetik, (elementet mund te jene linja, transformator ne nje nenstacion, nje njesi gjeneruese etj).
Ishull i Sistemit Elektroenergjetik	Ishulli perfaqeson nje pjese ose disa pjese te Sistemit Elektroenergjetik qe eshte i ndare elektrikisht nga pjesa kryesore e Sistemit Elektroenergjetik.
KPMR	Komiteti i Mbrojtjes dhe Rivendosjes
Ngarkese	Ngarkese do te thote nje paisje ose konsumator i cili merr fuqi elektrike nga Sistemi Elektroenergjetik. Ngarkesa nuk duhet ngaterruar me Kerkesen e cila eshte sasia e matur e fuqise qe kerkon ose merr Ngarkesa.
Kurba e Ngarkeses	Ecuria e ngarkeses, gjate çdo ore (00 – 24 ore) per nje dite, apo nje periudhe tjeter per nje element te caktuar.
Mirembajtja	Koordinimi i te gjithë veprimeve teknike dhe organizative qe kryhen per elementet e Sistemit Elektroenergjetik gjate periudhes se mirembajtjes per te rifituar kapacitetet e tyre per te kryer funksionet per te cilat ato jane projektuar dhe prodhuar.
Incidentet (Avarite) Madhore	Lidhjet e shkurtra, shkeputjet e linjave, te cilet ndajne nje pjese te konsiderueshme te Sistemit Elektroenergjetik nga ai kryesor dhe bejne qe Sistemi Elektroenergjetik te kete nje deviacion te madh kundrejt parametrave standarte te vendosura.
Fuqia Maksimale	Maksimumi i mundshem i fuqise qe eshte ne gjendje te jape Centrali i Energjise Elektrike ne kushte te caktuara mekanike dhe elektrike te tij.

Menyra e mbulimit te ngarkeses (merit order)	Lista e njesive gjeneratuse qe dispeçerohen sipas nje rregulli dhe kohe te caktuar (centrale eletrike te te gjithë llojeve: TEC-e, HEC-e, e te tjere) ne rendin rrites (ne baze te grafikut te ngarkeses vendosen centralet me kosto minimale dhe keshtu me rradhe derisa per te mbuluar pikun e ngarkeses vendosen centralet me kosto me te larte), rend ky qe percaktohet mbi baze te çmimeve te ofruara ne bashkepunim me te gjithë Gjeneruesit, bazuar ne mundesite tyre.
Pikat e Matjes se Energjise Elektrike	Pika e lidhjes se aparateve mates nepermjet te cilave behet e mundur matja e Energjise Elektrike qe kalon ne ate element.
Diagrama e Zakonshme e Vendendodhjes	Skema te pergatitura per çdo pike Lidhje, te cilet perfshijne skemat e planimetrise, skemat elektrike, skemat e mbrojtjes, skemat e kontrollit ne vendin e lidhjes.
Skema Normale e Operimit	Skema normale e lidhjes se elementeve ne secilen nyje qe formon Sistemin Elektroenergjetik. Qendra Dispeçer modifikon skemen normale te operimit ne varesi te rrethanave.
Rregjimi Normal i Operimit	Rregjimi i operimit i cili ploteson kushtin e meposhtem: - Parametrat e operimit jane normale ne perputhje me standartet dhe normat ne fuqi.
Parametrat Normale per Operimin e Sistemit Elektroenergjetik	Parametrat e vendosur sipas standarteve per operim normal te Sistemit Elektroenergjetik te diktuar nga: a) Parametra teknike te cilesise per te realizuar Transmetimin e Energjise Elektrike, b) Standarte per cilesine e sherbimit te furnizimit me Energji Elektrike, c) Standarte per cilesine e shperndarjes se Energjise Elektrike. d) Standarte per cilesine e Energjise Elektrike te gjeneruar.
Normat	Standartet, kodet, rregullat, instruksionet, vendimet dhe te tjera dokumenta normative te vendosur nepermjet ligjeve, akteve nenligjore, dokumenteve te tjere zyrtare dhe kontratave.
Objektet e Sektorit Elektroenergjetik	Nje teresi e instalimeve, ndertesave dhe pajisjeve te ndryshme te cilat jane projektuar per te Gjeneruar, Transmetuar dhe Shperndare Energji Elektrike.
Oferte	Nje oferte e bere nga nje pjesemarres i tregut qe vendos nje cmim ne te cilin do te reduktohen nivelet e gjenerimit ose livrimet (interkonektoret) nese instruktohet per te vepruar ne kete menyre nga Operatori i Dispeçerimit ne OST nepermjet pranimit te kesaj Oferte.
Programi i Operimit (Regjimi)	Aktivitetet e Operatorit te Sistemit te Transmetimit qe konsistojne ne skedulimin per nje periudhe kohe te dhene, per te bere te mundur operimin normal te Sistemit Elektroenergjetik si dhe te ekuilibroje balancen gjenerim - ngarkese, dhe ne te njeten kohe te mbaje parametrat teknike ne cilesine e duhur.

Veprim Operativ	Veprimi qe ndermerret nga njesia marrese e Urdherit Operativ per zbatimin e urdherit operativ te leshuar nga Qendra Dispeçer si dhe çdo veprim i pa programuar i bere nga Palet qe ndikon ne funksionimin e Sistemit Elektroenergjetik.
Urdher Operativ	Urdher qe jepet nga Qendra Dispeçer i detyrueshem per tu zbatuar nga njesia e cila e merr urdherin, Keta urdhera jepen nepermjet telefonit, fonogrameve ,faksit, dhe me futjen ne pune te SCADA nepermjet mesazheve kompiuterik.
Urdher per Sinkronizim	Nje Urdher i Qendres Dispeçer dhene per Gjeneruesit qe te sinkronizojne njesite gjeneruese me Sistemin e Transmetimit.
Nderprerje	<ul style="list-style-type: none"> - Ne lidhje me njesine gjeneruese: nderprerje e pjeseshme ose totale ne mundesine e gjenerimit te nje njesie gjenerimi per mirembajtje ose si rezultat i demtimeve (avarive). - Ne lidhje me Sistemin e Transmetimit: nderprerje si rezultat i demtimeve te ndonje pjese te Sistemit te Transmetimit ose mirembajtjes. - Ne lidhje me Perdoruesit e tjere nderprerja e furnizimit me Energji Elektrike si rezultat i demtimit, mirembajtjes te ndonje pjese ose total sistemit/objektit te Perdoruesit ose gjate programit te kufizimeve.
Lajmerimi i Nderprerjes	Nje njoftim i paraqitur nga nje Perdorues duke u bazuar ne klauzolat perkatese te Kodit, qe njofton OST per nje nderprerje te pa planifikuar ose nje njoftim i leshuar nga OST tek Perdoruesit, qe njofton per nje nderprerje te pa planifikuar te Sistemit te Transmetimit , te cilat ndikojne ne furnizimin me Energji Elektrike te Perdoruesve.
Programimi i nderprerjeve	Programi i nderprerjeve pergatitet nga OST ne konsultim me Perdoruesit duke u bazuar ne Kodin e Rrjetit.
Diagrama e Pronesise	Nje diagram qe permban numrin dhe emertesen e pergatitur per çdo vendndodhje te lidhjeve qe tregon pronesine e elementeve per çdo Pale.
Operimi ne Paralel	Operimi ne paralel ka te beje me rastin kur nje sere njesish Gjeneruese jane ne pune dhe jane te lidhur nepermjet rrjetave elektrike, karakterizuar nga fakti se te gjithë elementet e Sistemit Elektroenergjetik qe jane ne operim kane te njeten frekuence dhe kane te njeten faze te rrotullimit sinkron.
Renje e Pjeseshme e Sistemit Elektroenergjetik	Renja e pjeseshme e Sistemit Elektroenergjetik eshte nje fenomen kur nje pjese ose disa pjese te Sistemit Elektroenergjetik ndahen elektrikisht midis tyre dhe sjellin nderprerjen e furnizimit me Energji Elektrike per konsumatorët e asaj zone.
Konsumi ne Pik (MW)	Maksimumi i vleres se ngarkeses ne MW te rregjistruar brenda nje periodhe te caktuar kohe.

Plani per Rivendosje i Sistemit Elektroenergjetik pas mbetjes per nje kohe te gjate pa tension	Masa teknike dhe organizative qe kane parasysh shmangien e zgjerimit te metejshem te difektit (avarise) ne Sistemin Elektroenergjetik duke kufizuar ne kete menyre pasojat qe mund te sjellin, si edhe rivendosjen e Sistemit Elektroenergjetik ne gjendjen normale te punes. Procedurat e rivendosjes ne gjendje pune pas renies se nje pjese apo te te gjithë sistemit.
Plani per mbrojtjen e Sistemit Elektroenergjetik perkundrejt Incidenteve (avarive) Madhore	Nje sere aktivitetestesh te parashikuara nepermjet te cileve OST ne bashkepunim me Perdoruesit planifikon ne periudha te ndryshme kohore (vjetore, tre mujore, mujore), per operimin normal te Sistemit Elektroenergjetik ne menyre qe te shmange avarite, per te realizuar balancen gjenerim - ngarkese dhe njekohesisht te mbikqyre cilesine e parametrave te Sistemit Elektroenergjetik sipas standarteve te caktuara.
Skema e Programuar per Operim	Skema elektrike e krijuar nga lidhja e elementeve te ndryshem te Sistemit Elektroenergjetik nga Qendra Dispeçer duke marre ne konsiderate situaten, parashikimin per thithjen e Energjise Elektrike qe mund te ndodhe dhe mundesite e Sistemit Elektroenergjetik.
Nderprerjet e Planifikuara	Nderprerje te cilat jane planifikuar dhe eshte rene dakort ndermjet OST dhe Perdoruesve. Nderprerje e planifikuar gjithashtu do te thote nderprerje e ndonje pjese te Sistemit te Transmetimit i cili mund te ndikoje ne furnizimin me Energji Elektrike te Perdoruesve.
Kodi i Planifikimit	Pjesa e Kodit te Rrjetit e cila merret me ceshtjet e Planifikimit
Faktori i Fuqise	Raporti i fuqise elektrike aktive (W) me fuqine elektrike te plote (VA) ($\cos\phi$). Vlera minimale e lejuar e $\cos\phi$ eshte 0.9 ($\cos\phi = 0.9$)
Impiant Gjenerimi	Çdo instalimi qe prodhon Energji Elektrike.
Skedulimi i Fuqise	Fuqia aktive qe programohet per t'u gjeneruar per mbulimin e kerkeses se parashikuar.
Sektori i Energjise Elektrike	Teresia e aktiviteteve te planifikimit, zhvillimit, ndertimit, shfrytezimit, mirembajtjes se instalimeve te veprave Gjeneruese, Transmetuese, Shperndarese ,sistemeve/ objekteve te Konsumatoreve te Kualifikuar, Furnizuesve te Energjise Elektrike si dhe Linjat e Interkonjeksionit per import - eksportin dhe shkembimet me vendet fqinje.
Gjeneruesit e Energjise Elektrike te kualifikuar	Prodhues i nje apo disa lloj sistemesh gjeneruese te cilet ne baze te teknologjive te vecanta qe perdorin per Gjenerimin e Energjise Elektrike jane klasifikuar si te kualifikuar ne baze te legjislacionit ne fuqi.
Propabiliteti i mos Mbulimit te Ngarkeses	Propabiliteti i mos mbulimit te pikut te ngarkeses ne Sistemin Elektroenergjetik me Energji Elektrike, pra kemi nje prishje te balances gjenerim – ngarkese.
Mbrojtja	Masa per parandalimin e kushteve jo normale ne Sistemin Elektroenergjetik, zbulimin e difekteve dhe aktivizimin e alarmeve dhe dhenjeve te sinjaleve, deri ne shkeputjen e elementit te difektuar.
Kushte Operimi te Sigurta	Situata operimi qe plotesohet kriteri (n – 1) si dhe kriteret e qendrusherise dinamike dhe statike.

SCADA	Sistemi i Kontrollit dhe Perftimit i te Dhenave
Lidhje e Shkurter	Lidhje e shkurter vjen si pasoje e demtimeve te ndryshme e cila elementet i lidh midis dy pikave me potenciale te ndryshem.
S'takim	Gjendja e nje elementi kur ai eshte i s'takuar (jo ne pune)
Rezerva Rrotulluese	Rezerva rrotulluese mbivendoset mbi rezerven e rregullimit primar dhe sekondar dhe vendosjes se balances ne rastin e devijimit te shfaqur nga programi.
Data e Fillimit te nderprerjes	Data ne te cilen fillon nje nderprerje e planifikuar.
Ora e Fillimit te nderprerjes	Ora ne te cilen fillon nje nderprerje e planifikuar.
Aftesia per Ristartim	Aftesia e nje njesie gjeneruese te rifilloje punen pas nje renje pa ndihmen e Sistemit Elektroenergjetik.
Kompensator Statik	Nje paisje elektrike e dizenuar per te gjeneruar dhe per te absorbuar energjine reactive .
Qendrushmeria Statike (perkundrejt incidenteve te vogla)	Aftesia e Sistemit Elektroenergjetik per te mbajtur gjendjen normale te punes apo kur shmangia nga ky rregjim eshte shume e vogel brenda normave. Aftesia e Sistemit Elektroenergjetik per tu kthyer shpejt ne gjendjen e punes ne rregjim normal pasi ka pasur nje apo disa shmangie qe e kane çuar ate jashte parametrave standart te percaktuar.
Qendrushmeria Statike ne Element	Fuqia maksimale aktive e llogaritur e transferuar ne nje element te caktuar te Sistemit Elektroenergjetik per te cilin sigurohet qendrushmeria statike.
Rezerva e Qendrushmerise Statike ne nje element	Diferenca ndermjet kufirit te stabilitetit statik te elementit dhe ngarkeses reale te ketij elementi.
Kerkesa Statutore per Kontrollin e Frekuences	Ne perputhje me rregullat dhe standartet e Energjise Elektrike ne Shqiperi, Frekuenca e furnizimit te rrymes elektrike alternative nuk duhet te ndryshoje me teper se vlerat e lejuara te ndryshimit nga vlera nominale e frekuences, e cila eshte 50Hz .
Furnizues	Nje person i licensuar per te furnizuar me energji elektrike konsumatorët sipas legjislacionit ne fuqi.
Humbjet teknike te Eergjise Eektrike	Humbjet teknike te nje elementi te rrjetit te cilat jane te barabarta me diferencen e Energjise Elektrike qe futet ne kete element me Energjine Elektrike qe del nga ky element
Leje Teknike per Lidhje	Dokument qe leshohet nga OST i ndjekur nga nje analize e aplikuesit, i cili ben nje kerkese per tu lidhur me Sistemin e Transmetimit te Energjise Elektrike. Specifikimet perfshijne kushtet dhe standartet per tu lidhur me Sistemin e Transmetimit .
Rezerva e Rregullimit Terciar	Rezerva e Rregullimit terciar i mbivendoset rezerves se Rregullimit primar, sekondar asaj rrotulluse per te vendosur balancen ne rastin e devijimeve te shfaqura nga programi i krijuar.

Programi i Testit	<p>Nje program i pergatitur nga OST per administrimin e testeve i cili do te perfshije:</p> <ol style="list-style-type: none"> Procedurat qe adaptohen per kryerjen e testeve ku perfshihet dhe koha e stakimit dhe minutazhin e propozuar per kete kohe; Menyren se si do te mbahet testi; Listen e pjestareve te stafit qe do te perfshihen ne kryerjen e testit te Sistemit Elektroenergjetik perfshi ata qe do te jene pergjegjes per sigurine ne vendndodhjen e pikave te lidhjes/Centraleve te Fuqise; dhe Çeshtje te tjera qe OST i konsideron prioritare perfshi çeshtjet e sygjera nga Perdoruesit dhe te pranuar nga OST.
Renje e Plote e Sistemit Elektroenergjetik	Eshte fenomen qe ndodh per arsye te brendeshme apo te jashtme dhe qe sjell ndalimin per nje kohe te caktuar te nje apo disa elementeve qe nga ana tjetere sjellin nderprerjen e furnizimit me Energji Elektrike ne gjithe Sistemin Elektroenergjetik.
Stacion Transformimi (Nenstacion)	Instalimi elektrik, funksioni i te cilit eshte te transferoje Energji Elektrike ndermjet dy rrjetave me tensione te ndryshme.
Rrjeti i Transmetimit	<p>Sistemi i Transmetimit te Energjise Elektrike perbehet nga bashkesi linjash elektrike te tensionit te larte (110kV,150kV, 220kV,400kV), stacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetere, funksioni i te cilave perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar.</p> <p>Çdo aset qe perfshin komunikimin, mbrojtjen, kontrollin, sherbimet ndihmese, truallin, ndertesat dhe asete te tjera ndihmese, elektrike ose jo, te cilat nevojiten per funksionimin e duhur te instalimeve te veçanta te Sistemit te Transmetimit, jane elemente perberese te Sistemit te Transmetimit.</p>
Marreveshjet per akses ne rrjetin e Transmetimit	Dokumenti i nenshkruar bashkerisht ndermjet OST dhe aplikuesit per te pasur akses ne rrjet nepermjet licences perkatese. Nen pergjegjesine e perbashket ata supozojne te kene konfidencialitet te te dhenave dhe informacionit.
Tregusi i Sherbimit te Rrjetit te Transmetimit	Nje parameter i sherbimit te Sistemit te Transmetimit, qe vlereson Kohen Mesatare te Nderprerjes se Furnizimit (MTI), qe do te thote kohezgjatja mesatare e nderprerjes se furnizimit nga Sistemi i Transmetimit.
Mbingarkesa e Sistemit te Transmetimit	Situat qe ndodh gjate operimit, kur fluksi i rrymave ndermjet dy nyjeve ose zonave te Sistemit te Transmetimit eshte mbi normat dhe standartet e qendrueshmerise dinamike dhe statike te Sistemit te Transmetimit.
Sistemi i Transmetimit ne Interkonjeksion me Sistemet e Transmetimit te vendeve qinje	Sistemi i Transmetimit punon i lidhur ne paralel nepermjet linjave te interkonjeksionit me Sistemet e Transmetimit te vendeve fqinje.
Sherbime te Transmetimit	Sherbime qe sigurojne Transmetimin e Energjise Elektrike ndermjet dy apo me shume pikave te Rrjetit te Transmetimit sipas parametrave te cilesise.

Tarifat e Transmetimit	Tarifa te miratuara nga ERE, qe i Liçensuari eshte i detyruar te zbatoi per Sherbimet e Transmetimit te Energjise Elektrike ne Sistemin e Transmetimit.
Lajmerim Rreziku	Njoftim i leshuar nga Qendra Dispeçer tek Perdoruesit qe paralajmeron Perdoruesin se ka deshtuar ne zbatimin e urdherave te Qendres Dispeçer te cilet jane detyrimisht per t'u zbatuar nga Perdoruesit.